

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË

Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit

KATALOG I MJETEVE JURIDIKE

I.	<i>Hyrje</i>	4
1.	E drejta për mjet juridik efikas	4
2.	Mohimi i paligjshëm i mjetit juridik	4
3.	Mjetet juridike të cilat janë në përgjithësi të zbatueshme	5
4.	Organizimi i katalogut	6
II.	<i>Drejtesia penale</i>	7
A.	Arrestimi policor	7
1.	Arrestimi i paligjshëm nga policia	7
2.	Kompensimi për paraburgimin apo arrestimet e paligjshme ose paraburgimet e paarsyeshme	7
3.	Shkelja e të drejtës për informim të menjëherëshëm për arsyet e arrestimit në gjuhën që ai/ajo e kupton	8
4.	Shkelja e të drejtës për t'u dërguar menjëherë para gjyqtarit	8
5.	Shkelja e të drejtës për heshtje	9
6.	Shkelja e të drejtës për ndihmën pa pagesë të përkthyesit nëse ai/ajo nuk e kupton/flet gjuhën e organeve për zbatimin e ligjit	9
7.	Shkelja e të drejtës për ndihmën e avokatit mbrojtës	9
8.	Shkelja e të drejtës për të njoftuar familjen apo personin tjetër të përshtatshëm përkitazi me arrestin	10
9.	Shkelja e të drejtës së personit të paraburgosur që të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe respekt për dinjitetin e tij/saj	10
10.	Shkelja e të drejtës për ekzaminim dhe trajtim mjekësor	11
B.	Paraburgimi jashtë gjyqësor	11
1.	Paraburgimi jashtë gjyqësor nga KFOR-i	11
2.	Urdhërat ekzekutiv për paraburgim të PSSP-së	12
C.	Hetimet para dhe pas ngritjes së aktakuzës	12
1.	Paraburgimi i paligjshëm	12
2.	Shkelja e të drejtës për kushte njerëzore dhe liria nga tortura gjatë paraburgimit	13
3.	Shkelja e të drejtës për avokat gjatë fazës paraprake të procedurës penale	13
4.	Shkelja e të drejtës së mbrojtjes për t'i ekzaminuar dëshmitë gjatë fazës paraprake /E drejta për të prezentuar mbrojtjen	14
5.	E drejta për gjykim brenda kohës së arsyeshme ose lirim nga paraburgimi	15
6.	Paraburgimi pa të drejtë komunikimi	16
D.	Gjykimi & Rigjykimi	16
1.	Shkelja e të drejtës për gjykim nga një tribunal kompetent, i pavarur dhe i paanshëm i themeluar me ligj	16
2.	Shkelja e të drejtës për gjykim publik	17
3.	Shkelja e prezumimit të pafajësisë	18
4.	Shtyerja për të dëshmuar apo pranuar fajin/shkelja e të drejtës për heshtje	18
5.	Zbatimi retroaktiv i ligjeve penale dhe rreziku i dyfishtë	18
6.	Shkelja e të drejtës për gjykim pa vonesë të padrejtë apo lirim	19
7.	Shkelja e të drejtës për të mbrojtur vetën personalisht apo nëpërmjet të avokatit mbrojtës	19
	Barazia e palëve në procedurë/E drejta për të zgjedhur avokatin mbrojtës/E drejta për ndihmë juridike pa pagesë/E drejta për komunikim konfidencial me avokatin/Qasja në përfaqësim ligjor efektiv	19
8.	Shkelja e të drejtës për t'u gjykuar në prani të të tjerëve	20

9.	Shkelja e të drejtës për përkatësi dhe interpret pa pagesë	20
10.	Shkelja e parimit oftë sistemit të ndarë të drejtësisë për të mitur	21
11.	Shkelja e parimit për sistem të ndarë të drejtësisë për të mitur	21
12.	Shkelja e të drejtës për ankesë kundër aktgjykimit	21
III.	<i>Policia e UNMIK-ut, SHPK-ja, TMK-ja dhe KFOR-i. Shkelja e kodit të mirësjelljes apo ligjit penal</i>	23
A.	Policia e UNMIK-ut	23
1.	Policia e UNMIK-ut– Shkelja e kodit të mirësjelljes– mjeti administrativ	23
2.	Policia e UNMIK-ut– Shkelja e kodit të mirësjelljes apo ligjit penal– mjeti juridik	23
B.	Shërbimi Policor i Kosovës.....	24
1.	KPS - Shkelja e kodit të mirësjelljes dhe/apo ligjit penal – mjeti juridik	25
C.	Trupat e Mbrojtjes së Kosovës	25
1.	Trupat e Mbrojtjes së Kosovës (TMK) – Shkelja e kodit të mirësjelljes– mjeti administrativ	25
2.	Trupat Mbrojtëse të Kosovës – Shkelja e kodit/dhe ose/ligjit penal – mjet juridik.....	26
D.	KFOR-i	28
1.	KFOR-i – Shkelja e Kodit penal ushtarak të shtetit përkatës– mjeti administrativ dhe ai juridik.....	28
2.	KFOR-i – kërkesat/paditë për kompenzim.....	28
IV.	<i>Mosdiskriminimi.....</i>	30
A.	Mjetet e përgjithshme I.....	30
C.	<i>Ligji kundër diskriminimit</i>	32
D.	<i>Kërkesat/ankesat për praktikat diskriminuese në punësimin publik.....</i>	32
E.	Kërkesat/ankesat për praktikat diskriminuese në punësimin publik sipas LKD	33
F.	Kërkesat/ankesat kundër praktikave diskriminuese të punësimin në nivel komunal.....	33
G.	Kërkesat/ankesat nga nëpunësit civil kundër vendimit diskriminues të Këshillit Disiplinor	34
H.	Kërkesat/paditë për diskriminim të përdorimit të gjuhës amtare gjatë qasjes në shërbimet publike.....	34
I.	Kërkesat/paditë kundër diskriminimit të shkaktuar nga zyrtarët e arsimit gjatë qasjes në arsim.....	35
J.	Kërkesat/paditë kundër diskriminimit sipas LKD, të shkaktuar nga zyrtarët e arsimit gjatë qasjes në arsim	36
K.	Kërkesat/ankesat kundër sanksioneve arbitrare të bëra nga mësuesit dhe personeli arsimor.....	36
L.	Kërkesat/paditë për diskriminim gjatë qasjes në kujdesin shëndetësor	36
M.	Kërkesat/paditë për diskriminim gjatë qasjes në kujdesin shëndetësor sipas Ligjit të Kosovës për Shëndetësi	37
O.	Ankesat kundër diskriminimit lidhur me qasjen në ndihmën (mirëqenien) sociale.....	38
IV.	<i>Viktimat e krimit.....</i>	39
A.	Mjetet juridike në.....	39
	disponim për palën e dëmtuar.....	39
1.	Viktima e krimit/pala e dëmtuar – propozimi për ndjekje penale, padia private dhe subsidiare.....	39
2.	Viktima/Pala e dëmtuar, dëmtimi apo humbja e pasurisë.	40
3.	Siguria e palës së dëmtuar.....	41
4.	Pala e dëmtuar në kundërvajtje.....	42
5.	Viktimat e dhunës në familje	43
B.	Mjetet juridike speciale për viktimat e trafikimit.....	45
1.	Ndihma për viktimat e trafikimit	45

2.	Viktimat e trafikimit – kërkesa për shpërblimin e dëmit/kthimit të sendit.....	45
6.	Të drejtat e viktimës (palës së dëmtuar) në përgjithësi	45
VI.	Çështjet pronësore juridike	47
A.	Çështjet e.....	47
	përgjithshme	47
	pronësore	47
1.	Heqja e pabazë e të	47
	drejtave pronësore	47
a)	Ndërprerja e pabazuar e hipotekës	48
2.	Pengimi i pabazë i të drejtave pronësore	48
b)	Përmes dëmtimit të sendit	49
d)	Përmes aplikimit të pabazë të procedurës së servitutit	50
C.	Regjistrimi i patundshmërive / Kadastrri	50
3.	Mohimi i pabazë i qasjes në shënimet kadastrale/të dhënat e regjistrit.....	53
4.	Matja dhe klasifikimi (kategorizimi) i gabuar i tokës	53
5.	Dëmi i shkaktuar për	54
	shkak të matjes	54
	gjeodezike	54
D.	Bartja e pronës dhe eksproprijimi (shpronësimi)	56
a)	Për shkak të mosrespektimit të të drejtës së privilegjuar (përparësisë së blerjes)	57
E.	Mbrojtja e ambientit	61
F.	Refuzimi i pabazë i pëlqimit mjedisor	63
G.	Planifikimi hapsinor	64
D.	Ndërtimi mbi tokë.....	65
2.	Refuzimi i pabazë i lejes për ndërtim apo legalizim të (objektit) të ndërtimit (parimet e përgjithshme)	65
G,	Çështjet pronësore banesore	67
	Siç është vendosur me Rreg. UNMIK-ut 2001/17 dhe aprovuar nga administratori komunal.	71
b)	Fituar pas 24 marsit 1999 dhe kur bartësit e të drejtës pronësore nuk e kanë pronën në posedim dhe nuk ka tjetërsuar pronën me shprehjen e lirë të vullnetit.....	73
	Gjithashtu e njohur si okupim i kundërligjshëm i pronës banesore.....	73
c)	Përmes vendimit administrativ të "Drejtorisë" për dëbim, apo dhënjen e lejes së përkohshme për strehim	73
d)	Përmes vendimit të "komisionit" sipas të cilit bartësi i të drejtës është palë e tretë.	74
6.	Refuzimi për shtyerjen e pagimit të tatimit mbi pronën.....	85

KATALOG I MJETEVE JURIDIKE

I. Hyrie

Mbrojtja dhe promovimi i qëndrueshëm i të drejtave të njeriut ka për qëllim të inkurajojë, përkrah dhe lehtësojë shfrytëzimin e mjeteve juridike efektive të nevojshme për adresimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Kjo kërkon një përqëndrim më të madh në vetë mjetin juridik të nevojshëm për adresimin e shkeljes dhe sigurimin e kompenzimit për atë shkelje, në krahasim me mbrojtjen tradicionale të të drejtave të njeriut e cila më shumë përqëndrohet në vetë shkeljen. Mjetet e tilla jo vetëm që kërkojnë nga instrumentet e ndryshme për të drejtat e njeriut mirëpo ato janë gjithashtu në gjendje të parandalojnë padrejtësinë dhe shpërdorimin e pushtetit duke ofruar një korrigjim apo shqyrtim të bërë për gabimet e shkaktuara nga ana e autoriteteve.

Autoriteti i cili shqyrton një shkelje duhet të jetë në gjendje të aplikojë në mënyrë të saktë ligjet përkatëse dhe standardet për të drejtat e njeriut. Për më tepër, duke u bazuar në shqyrtimet e tilla autoritetet duhet të jenë në gjendje të marrin një vendim i cili është obligativ dhe i ekzekutueshëm në kuadër të autoriteteve të cilat janë objekt i shqyrtimit. Në bazë të këtij formulimi ankesat e parashtruara pranë Ombudspersonit nuk paraqesin mjet juridik për shkak se vendimet e Ombudspersonit nuk kanë karakter obligativ për autoritetet.

Puna e mëtutjeshme përkritazi me mjetet e tilla juridike pasqyron një fokus të shtuar të Departamentit për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit në realizimin e qëndrueshëm të të drejtave të njeriut. Ky katalog përbën hapin e parë në procesin e mjeteve juridike e cila ka për qëllim identifikimin e mjeteve juridike të zbatueshme apo mungesën e tyre për secilën të drejtë të njeriut e cila mund të jetë në rrezik.

Ky katalog përqëndrohet në shkeljet kontestuese të të drejtave të njeriut të cilat janë të garantuara me ligjin vendës apo me instrumentet ndërkombëtare të cilat janë të zbatueshme në Kosovë.

1. E drejta për mjet juridik efikas

E Drejta për mjet juridik efikas pranë një autoriteti kombëtar për shkeljet e të drejtave të njeriut të parapara me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj).

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka theksuar se kur një individ pohon se është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut të paraparë me Konventë, duhet të ekzistojë një mjet juridik pranë ndonjë organi vendës me qëllim që kërkesa e bërë të adresohet dhe si

kompenzim të sigurohet dëmshpërblimi për shkeljen përkatëse.¹

Efekti i nenit 13 është që t'i mundësojë organit kompetent për t'u marrur me substancën e ankesës së bërë dhe si rezultat ofron një lehtësim të dukshëm në këtë proces. Së këndejmi, efikasiteti i mjetit të tillë nuk varet nga mundësia e rezultatit të favorshëm për parashtruesin e kërkesës. Për më tepër, kjo nuk kërkon ndonjë formë të veçantë të mjetit juridik; shteteve u lejohej të veprojnë në bazë të pushtetit të tyre diskrecional për t'ju përmbajtur detyrimeve që dalin nga kjo dispozitë.² Sa i përket mjeteve përkatëse juridike, Gjykata, veçanërisht në rastin *Soering* konsideroi se procedurat për shqyrtim gjyqësor mund të jenë një mjet juridik efikas për ankesën e parashtruar.³

Autoriteti të cilit i referohet neni 13 nuk ka nevojë të jetë autoritet gjyqësor, dhe pushtetin dhe garancat të cilat ajo i ofron janë të rëndësishme për të përcaktuar se a është një mjet juridik efikas apo jo. Në rastet kur nuk ekzistojnë kurrfarë mjeti juridik i cili plotëson kërkesën për efikasitet, mjetet juridike shpesh të cilat paralexoen me ligjin vendës dhe i shtohen mjetit juridik të sipërpërmendur mund të bëjnë një gjë të tillë.⁴

Sidoqoftë, ky katalog nuk mëton të jetë një masë për matjen e shkallës së efikasitetit të mjeteve juridike të cilat janë në dispozicion në Kosovë. Katalogu nuk mëton të analizojë se a i kanë plotësuar mjetet juridike në fjalë kërkesat e parapara me nenin 13 të KEDNj-së. Për më tepër nuk mëton të adresojë se kur dhe ku kërkohet një mjet juridik me qëllim të adresimit të një shkeljeje.

Ky katalog nuk është i kufizuar vetëm në të drejtat e parapara me KEDNj-në. Ajo ka për qëllim të përfshijë mjetet juridike të cilat janë të domosdoshme për adresimin e shkeljeve, mjete këto të cilat janë në dispozicion në bazë të ligjeve të zbatueshme dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

2. Mohimi i paligjshëm i mjetit juridik

E drejta për të parashtruar një mjet juridik është e mbrojtur edhe me nenin 51 të Ligjit Penal të Kosovës, e cila parasheh ndëshkim për çdo person i cili i parandalon të tjerët në ushtrimin e kësaj të drejte. Neni 51 thekson:

¹ Silver kundër Mbretërisë së Bashkuar, Vendimi i Gjykatës më 25 mars 1983, paragrafi 113.

² Vilvajarah dhe të tjerët, Vendimi i Gjykatës i 30 tetorit 1991, pp. 37-38.

³ vendimi i 7 korrikut 1989, pp. 27-28.

⁴ Rasti Leander, Vendimi i 26marsit 1987, pp. 29-30

“(1) Çdo person i cili gjatë përmbushjes së detyrimeve së tij të punës, parandalon të tjerët nga shfrytëzimi i të drejtës për parashtrim të ankesës apo ndonjë mjet juridik tjetër siç është kundërshtimi, kërkesa apo përfaqësimi, do të dënohen me deri në një vjet burg.

(2) Nëse një shkelle e tillë e cila është e referuar në paragrafin 1 të këtij neni kryhet nga një person zyrtar nëpërmjet të keqpërdorimit të pozitës së tij zyrtare, atëherë ai person zyrtar do të jetë objekt i dënimit deri në tre vjet burgim.”

Nuk posedojmë me shënime adekuate se a janë bërë ankesa për shkeljet të cilat paralexoen me nenin 51 kundër ndonjë personi në Kosovë.

3. Mjetet juridike të cilat janë në përgjithësi të zbatueshme

Katalogu paraqet një listë të mjeteve juridike për shkeljet e veçanta të të drejtave të njeriut. Përpos mjeteve juridike të posaçme të cilat janë të përfshira në këtë katalog ekzistojnë një sërë mjeteve tjera të cilat janë në dispozicion për ata persona të drejtat e të cilëve janë të cenuara. Mjetet juridike të përgjithshme zbatohen nëse nuk ekziston ndonjë mjet tjetër i posaçëm i cili paralexoe me ligjin e zbatueshëm.

Ankesa kundër vendimit gjyqësor (rastet penale)

E drejta për shqyrtimin e vendimit për shpalljen e fajësisë dhe dënimit të shqiptuar nga një gjykatë e instancës më të lartë paralexoe edhe me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilat janë të zbatueshme në Kosovë - nenet 14(5) të Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Politike dhe Civile (MNDPC) dhe neni 2 i Protokollit Nr. 7 të KEDNJ-së – dhe nga ligji vendës.

Neni 398 i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK) thekson se ankesa kundër aktgjyqimit të shkallës së parë duhet të paraqitet në afat prej 15 ditësh nga datat e dorëzimit. Neni 399 i KPPPK përcakton palët të cilat mund të parashtrorin ankesë.

Si rregull gjykata e apelit mund të shqyrtojë vetëm çështjet kontestuese në aktgjykimin e shkallës së parë. Sidoqoftë, neni 415 i KPPPK parashikon për gjykatën e shkallës së dytë t'i shqyrtojë çështjet ex officio nëse garancionet e caktuara procedurale të KPPPK shkelen ose nëse në dëm të të akuzuarit është bërë shkelje penale.

I pandehuri ka të drejtë të parashtrorë ankesë në çfarëdo baze kundër vendimit të gjykatës, duke përfshirë edhe kërkesat për dëmshpërblim (për dallim nga prokurori publik). I pandehuri dhe avokati i tij/saj kanë të drejta individuale për ankesë ndërsa ankesa e të pandehurit nuk e përjashton ankesën e

parashtruar nga mbrojtësi. Avokati mbrojtës duhet të marrë pëlqimin e të pandehurit për të parashtruar ankesë në emër të tij.

Sidoqoftë, në rastet që përfshijnë të pandehurit e mitur, ligji i zbatueshëm vendës (neni 75 (2) i Ligjit Penal për të Mitur i Kosovës LPMK) parashihet që avokati mbrojtës mund të parashtrorë ankesë edhe kundër dëshirës së klientit të tij. Duhet të ceket se bashkëshorti/ja e të akuzuarit, i afërmi në vijë të drejtë të gjakut, prindi adoptues, vëllau, motra, prindi strehues munden gjithashtu të parashtrorin ankesë në të mirë të të akuzuarit. Sikur avokati mbrojtës, edhe personat e sipërpërmendur mund të parashtrorë ankesë në emër të të pandehurit të mitur edhe përkundër mungesës së dëshirës së tij për një gjë të tillë. Si një mbrojtës i ligjshëm dhe përfaqësues i interesit publik, edhe prokurori publik mund të parashtrorë ankesë kundër vendimit gjyqësor në dobi të të pandehurit.

Sa i përket palës së dëmtuar duhet të bëhet një dallim ndërmjet të asaj se a e ka marrë apo jo pala e dëmtuar përsipër paraqitjen e padisë (si paditës subsidiar ose paditës privat nga nenet 54 dhe 62 të KPPPK). Në rast të ndjekjes penale, pala e dëmtuar mund të kundërshtojë aktgjykimin vetëm në lidhje me vendimin për sanksionim për veprat e kryera kundër jetës ose trupit, kundër integritetit seksual ose për veprat e rrezikimit të trafikut publik përfshirë edhe kundër vendimit për shpenzimet procedurale. Kur prokurori nuk bën ankesë ose tërhiqet, pala e dëmtuar nuk mund ta marrë pozitën e prokurorit. Por kur pala e dëmtuar vepron (ose ka vepruar c. neni 399 (3) në cilësi të paditësit subsidiar ose privat, ai/ajo mund të paraqes ankesë në të gjitha bazat mbi të cilat mund të kontestohet aktgjykimin (neni 399 (1), 402 të KPPPK).

Pala e dëmtuar ka të drejtë gjithashtu të paraqesë kërkesën pasurore juridike në procedurë penale nëse është e autorizuar ta bëjë të njëjtën gjë pranë gjykatës civile⁵.

Ankesa kundër vendimit gjyqësor (rastet civile)

Pala mund të ankohet kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të kopjes së vendimit të gjykatës^{6, 7}.

⁵ Neni 108 (1) i Ligjit të Procedurës Kontestimore

⁶ neni 348 i Ligjit të Procedurës Kontestimore Gazeta Zyrtare 4/77

⁷ Gjykata civile kompetente e shkallës së parë mund të jetë qoftë gjykata komunale apo ajo e qarkut varësisht nga lloji i ankesës (lexo neni 26-2 dhe 29-2 të ligjit mbi gjykatat e rregullta të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1978).

Gjykata e shkallës së dytë vendos mbi ankesat e parashtruara kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë (ibid.) Gjykata e shkallës së dytë mund të jetë gjykata e qarkut (lexo neni 29-1 të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta të Krahinës Socialiste

Gjykata e shkallës së dytë vendos mbi ankesat e parashtruara kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë.⁸

Nëse edhe më tej pala është e pakëndaqur ajo mund të kërkojë revizionin e vendimit të shkallës së dytë brenda 30 ditëve nga pranimi i kopjes së vendimit⁹. Revizioni shqyrtohet nga Gjykata Supreme.

Ankesa e përgjithshme administrative:

Pala mund të parashtojë ankesë apo kërkojë mjetin përmirësues kundër vendimit apo veprimin administrativ. Në parim, pala mund të shtjerrë mjetet ankimore procedurale administrative të cilat janë të zbatueshme. Nëse nuk arrihet plotësimi i kërkesave nëpërmjet të mjeveve të tilla, atëherë mund të parashtrohet padia administrative pranë gjykatës kompetente nëse pala konsideron se të drejtat apo interesat e tij/saj janë shkelur nga ndonjë akt administrativ (neni 2, Ligji mbi Konfliktin Administrativ, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 4/77). Një padi e tillë mund të parashtrohet brenda 30 ditëve nga dita kur akti administrativ në fjalë është ekzekutuar.

Përgjithësimi i mëtejme i mjeveve ankimore procedurale dhe administrative është tejet i vështirë. Mjeti juridik administrativ dhe procedural në dispozicion varet nga niveli qeveritar në të cilën është nxjerrë akti administrativ, sikurse edhe nga dispozitat përkatëse të ligjeve përkatëse të cilët e rregullojnë procedurën në fjalë.

Sidoqoftë, mund të bëhen disa observime të përgjithshme. Ligji i Procedurës Administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 1986, Nr. 47) mbetet i zbatueshëm përderisa nuk bie në kundërshtim me nenin 5, të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave përkitazi me vendimet administrative të të pruar nga ndonjë organ komunal.

Në bazë të kësaj Rregullore, personi mund të paraqesë ankesë kundër vendimit administrativ komunal nëse ai/ajo pohon se të drejtat e tij/saj janë shkelur me atë vendim. Ankesat mund t'i paraqiten me shkrim kryeshefit ekzekutiv apo të dorëzohen personalisht në zyrën e kryeshefit ekzekutiv brenda 1 muaji nga dita kur parashtruesi i kërkesës është njoftuar për vendimin në fjalë. Nëse parashtruesi i kërkesës

nuk është i kënaqur me përgjigjen e kryeshefit ekzekutiv, ankesa mund t'i adresohet autoritetit qëndror, i cili do të vendos mbi ligjshmërinë e vendimit. Kjo ankesë e shkallës së dytë duhet të dorëzohet nëpërmjet Drejtoratit për çështje administrative, i cili është i caktuar për të koordinuar me procesin e shpërndarjes së ankesave të tilla. Vendimi i "autoritetit qëndror" përkatës duhet të nxjerret brenda dy muajve (neni 247, Ligji i Procedurës Administrative). Rregullorja dhe ristrukturimi i organeve qeverisëse ka shkaktuar huti në përcaktimin e "autoritetit qëndror" nëpërmjet të të cilit do të ushtrohet e drejta për mjet administrativ efikas. Pasi që të shterren mjetet e tilla, ankesa (padija administrative) mund të parashtrohet pranë Dhomës Administrative të Gjykatës Supreme.

Kur një vendim apo akt administrativ buron nga organi i instancës më të lartë, procedurat e parapara me Ligjin e Procedurës Administrative zbatohen në mënyrë të plotë përpos nëse ligjet e posaçme nuk janë të zbatueshme në këtë drejtim.

4. Organizimi i katalogut

Katalogu përbëhet nga pesë pjesë kryesore: drejtësia penale, çështjet e sigurisë, mosdiskriminimi, viktimat e krimit dhe çështjet pronësore. Secila pjesë përmban edhe nënseksionet e saj të cilat përfshijnë çështje të ndryshme specifike. Çështja e cila gjendet në kolonën e majtë përshkruan natyrën e shkeljes për shembull "arrestimi i paligjshëm nga policia". Kolona e djathtë thekson se ligji i zbatueshëm përkitazi me shkeljet përkatëse, si dhe dëshmitë të cilat ju mund t'i paraqitni nëse dëshironi të parashtroni kërkesën tuaj dhe së fundi flet edhe për mjetin juridik që mund ta shfrytëzoni për shkeljen e përshkruar.

Autonome të Kosovës, 1978), apo Gjykata Supreme (lexo nenin 31 të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1978).

⁷ Gjykata e shkallës së dytë mund të jetë gjykata e qarkut (lexo nenin 29-1 të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1978), apo Gjykata Supreme (lexo nenin 31 të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1978).

⁸ Neni 382 i Ligjit të Procedurës Kontestimore

⁹ neni 383 i Ligjit të Procedurës Kontestimore

II. Drejtësia penale

A. Arresti policor

1. Arrestimi i paligjshëm nga policia

E drejta për të kundërshtuar ligjshmërinë e arrestimit (nenet 5 KEDNj & 9(4) MNDPC)

Ligji në fuqi

- Neni 212 (6) i KPPPK-së (thekson në pjesën përkatëse):

“Personi i arrestuar ka të drejtë të kundërshtojë vendimin nga paragrafi 5 i këtij neni te gjyqtari i procedurës paraprake. Policia dhe prokurori publik detyrohen të sigurojnë që ankesa t’i jetë dërguar gjyqtarit të procedurës paraprake. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit. Gjyqtari i procedurës paraprake vendos për ankesë brenda njëzet e katër orëve nga momenti i arrestimit.

- Neni 286 (2) i KPPK-së i paraburgosuri ose mbrojtësi i tij në çdo kohë mund t’i ankohen gjyqtarit të procedurës paraprake ose kryetarit të trupit gjykues që të vendosë mbi ligjshmërinë e paraburgimit.

Dëshmitë

Të dhënat mbi arrestimin dhe paraburgimin, lista e të paraburgosurve në qendrat dhe objektet e paraburgimit.

Përshkrimi i mjetit juridik

Neni 212 (6) prashikon të drejtën e ankimit për personin e ndaluar/arrestuar dhe të mbrojtësit të tij/saj pranë gjyqtarit në procedurë paraprake. Ky gjyqtarë duhet të bjen vendim brenda 48 orëve nga dita e pranimit të ankesës. Ankesa e personit të ndaluar/arrestuar dhe e mbrojtësit të tij/saj kundër vendimit policor mbi arrestimin/ndalimin nuk e pengon ekzekutimin e vendimit. Ankesa kundër vendimit të paligjshëm nga policia gjithashtu mund të përflexoet në ankesën kundër vendimit të parë për paraburgim në procedurën paraprake.

Neni 286 (2) i KPPPK-së

Meknizmi *habeas corpus*:

Në çdo kohë gjatë procedurës penale, i burgosuri ose avokati i tij/saj mund të kërkojnë nga gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i trupit gjykues të vendosin lidhur me ligjshmërinë e paraburgimit/ndalimit. Kjo kërkesë duhet të konstatojë *prima facie* rastin në të cilin bazat për paraburgim nuk ekzistojnë më për shkak të ndryshimit të rrethanave ose se paraburgimi është i paligjshëm për disa shkaqe tjera. Në këto raste gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i trupit gjykues urdhëron lirimin e menjëhershëm të të paraburgosurit nëse konstatohet se bazat për mbajtjen e tij/saj nuk ekzistojnë më ose se periudha e caktuar për paraburgim ka skaduar, se periudha e caktuar për paraburgim me vendim gjyqësor i tejkalon afatet ligjore ose se paraburgimi është i paligjshëm për shkaqe tjera.

Ligji në fuqi

Ligji në fuqi

- Neni 535 i KPPPK:

Neni 536 i KPPPK lexon: “Kur kërkesa për kompensim dëmi nuk miratohet ose kur organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore dhe i dëmtuari nuk arrijnë marrëveshje brenda tre muajsh nga dita e paraqitjes së kërkesës, i dëmtuari mund të paraqesë padinë për kompensim dëmi në gjykatën kompetente. Nëse arrihet marrëveshje vetëm për një pjesë të kërkesës, i dëmtuari mund të paraqesë padi për pjesën tjetër të kërkesës.”

Dëshmitë

Të dhënat mbi arrestimin dhe paraburgimin, lista e të paraburgosurve në qendrat dhe objektet e paraburgimit.

Përshkrimi i mjetit juridik

Kërkesa për kompensim duhet të parashtrahet nga personi që e gëzon këtë të drejtë apo avokati i tij/saj pranë komisionit për kompensim i cili përbëhet nga tre gjyqtarë të gjykatës

2. Kompensimi për paraburgimin apo arrestimet e paligjshme ose paraburgimet e paarsyeshme

Neni 16 i KPPPK-së lexon:

Çdo person i cili është dënuar, arrestuar, ndaluar ose paraburgosur në mënyrë të paligjshme ka të drejtë në rehabilitim të plotë, shpërblim të drejtë nga mjetet buxhetore dhe në të drejta të tjera të parapara me ligj.

Neni 534 I KPPPK

Neni 538 I KPPPK

supreme. Personi nuk do të kompenzohet për dëmin nëse arrestimi i tij është bërë si rezultat i veprimeve të palejuara të tij. Kërkesa duhet t'i adresohet drejtorit të Departamentit të administratës gjyqësore. E drejta për kompenzim do të skadojë pas tre vjetësh kur hyn në fuqi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë për lirim të pandehurit ose nga dita kur bëhet i plotëfuqishëm aktvendimi i shkallës së parë me të cilin hudhen akuzat ose ndërpritet procedura. Nëse personi lirohet pas vendosjes mbi ankesën nga gjykata e shkallës më të lartë, e drejta e shpërblimit të dëmit skadon tre vjet pas pranimit të vendimit të asaj gjykate.

Kërkesa nuk duhet të dorëzohet derisa nuk bihet vendimi i formës së prerë mbi lirim të parashtruesit të kërkesës. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dosjeve përkatëse, komisioni mund ta ftojë parashtruesin e kërkesës të marrë pjesë në seancën dëgjuese, apo thjeshtë i ofron parashtruesit të kërkesës një shumë të caktuar të kompenzimit. Nëse parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me ofertën (pjesërisht apo plotësisht) apo nëse komisioni nuk bie vendim mbi kërkesën e parashtruar brenda afatit prej 3 muajve nga dita e parashtrimit të saj, ai/ajo mund të incicojë procedurë ligjore pranë gjykatës kompetente (neni 536(1, 3) i KPPPKsë.

Qarkorja e drejtësisë 2001/1 mbi vendimin për formimin e Komisionit për kompensim të personave të akuzuar, denuar ose burgosur gabimisht.

Ligji në fuqi

3. Shkelja e të drejtës për informim të menjëherëshëm për arsyet e arrestimit në gjuhën që ai/ajo e kupton

(Rregullorja e UNMIK-ut
Rregullorja Nr. 2001/28
mbi të drejtat e personave të arrestuar nga organet për zbatimin e ligjit (neni 2.1.a), nenet 9(2) MNDPC, 5(2) KEDNj, 40(2)(b)(ii) të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve (Fëmiut) Neni 14 i KPPPK Neni 214 (1) (3) KPPPK

- Neni 83(1) i KPPPK-së lexon:

“Paditë private, aktakuzat, propozimkuzat, propozimet për ndjekje, mjetet juridike dhe deklaratat e njoftimit tjera paraqiten me shkrim ose gojarisht në procesverbal.”

Nuk ka dispozitë konkrete. Mirëpo, mjeti juridik i inkorporuar në mënyrë indirekte në nenet 212 (6) dhe 286 (2) KPPPK . Lexo Kreun II, Drejtësia Penale, paraburgimi i paligjshëm nga policia, A1.

Dëshmitë:

Të dhënat e policisë mbi arrestimin dhe paraburgimin, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të arrestuar

Përshkrimi i mjetit juridik:

- Propozimi i mbrojtjes para gjyqtarit të procedurës paraprake. Mund të bëhet gojarisht gjatë seancës për caktimin e paraburgimit ose mund të përflexoet në ankesën kundër ndalimit/arrestimit policor ose kundër vendimit për paraburgim në procedurën paraprake, A1.

Mekanizmi *habeas corpus* është i zbatueshëm. Lexo Kreun II, Drejtësia Penale, paraburgimi i paligjshëm nga policia, A1.

Ligji në fuqi:

Nuk ka dispozitë ligjore konkrete.

4. Shkelja e të drejtës për t'u dërguar menjëherë para gjyqtarit

(9(3) MNDPC, 5(1c),(3) KEDNj) neni 211 i KPPPK-së

Mjeti juridik është inkorporuar në mënyrë indirekte përmes nenit 212 (6) dhe 286 (2) të KPPPK. Lexo Kreun II, Drejtësia Penale, paraburgimi i paligjshëm nga policia, A1.

Dëshmitë:

Të dhënat e policisë mbi arrestimin dhe paraburgimin, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të arrestuar

Përshkrimi i mjetit juridik:

- Propozimi i mbrojtjes para gjyqtarit të procedurës paraprake (neni 83 (1) KPPPK. Lexo Kreun II, Drejtësia Penale, paraburgimi i paligjshëm nga policia, A1.

Mund të përflexoet në ankesën kundër ndalimit/arrestimit policor ose kundër vendimit të parë për paraburgim të marrë në procedurën paraprake. Lexo Kreun II, Drejtësia Penale, paraburgimi i paligjshëm nga policia, A1

- 5. Shkelja e të drejtës për heshtje**
Rregullorja e UNMIK-ut Regullorja Nr. 2001/28 mbi të drejtat e personave të arrestuar nga organet për zbatimin e ligjit (neni 2.1.b, 2.2, 2.3, 6.1.e), neni 214(1, 2,) i KPPPKsë
- Liqi në fuqi:**
Nuk ka dispozitë konkrete ligjore
- Mjeti juridik është inkorporuar në mënyrë indirekte përmes nenit 212 (6) dhe 286 (2) të KPPPK. Lexo Kreun II, Drejtësia Penale, paraburgimi i paligjshëm nga policia, A1.
- Dëshmitë:**
Të dhënat e policisë mbi arrestimin dhe paraburgimin, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të arrestuar
- Përshkrimi i mjetit juridik:**
- Propozimi i mbrojtjes para gjyqtarit të procedurës paraprake (neni 83 (1) KPPPK. Lexo Kreun II, Drejtësia Penale, paraburgimi i paligjshëm nga policia, A1.
- Mund të përflexoet në ankesën kundër ndalimit/arrestimit policor ose kundër vendimit të parë për paraburim të marrë në procedurën paraprake. Lexo Kreun II, Drejtësia Penale, paraburgimi i paligjshëm nga policia, A1
- Mekanizmi *habeas corpus* është i zbatueshëm. Lexo Kreun II, Drejtësia Penale, paraburgimi i paligjshëm nga policia, A1.
- 6. Shkelja e të drejtës për ndihmën pa pagesë të përkthyesit nëse ai/ajo nuk e kupton/flet gjuhën e organeve për zbatimin e ligjit**
(Neni 214 (1)(3) i KPPPK-së, Rregullorja e UNMIK-ut Regullorja Nr. 2001/28 mbi të drejtat e personave të arrestuar nga organet për zbatimin e ligjit (neni 2.1c), Parimi 14 i Grupit të parimeve
- Liqi në fuqi:**
Nuk ka dispozitë konkrete ligjore
- Dëshmitë:**
Të dhënat e policisë mbi arrestimin dhe paraburgimin, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të arrestuar
- Përshkrimi i mjetit juridik:**
Propozimi i mbrojtjes para gjyqtarit të procedurës paraprake (neni 83 (1) KPPPK. Lexo Kreun II, Drejtësia Penale, paraburgimi i paligjshëm nga policia, A1
- Mund të përflexoet në ankesën kundër ndalimit/arrestimit policor ose kundër vendimit të parë për paraburim të marrë në procedurën paraprake. Lexo Kreun II, Drejtësia Penale, paraburgimi i paligjshëm nga policia, A1
- Mekanizmi *habeas corpus* është i zbatueshëm. Lexo Kreun II, Drejtësia Penale, paraburgimi i paligjshëm nga policia, A1.
- 7. Shkelja e të drejtës për ndihmën e avokatit mbrojtës**
Shkelja e të drejtës për ndihmën e avokatit mbrojtës sipas zgjedhjes së tij/saj, apo e drejta për t'ju ofruar avokati në rast se nuk mundet të paguajë për ndihmën e ofruar juridike, të drejtës për komunikim konfidencial, të drejtës për prani të avokatit mbrojtës gjatë intervistave të cilat i kryejnë me të organet për zbatimin e ligjit (neni 3), Urdhëresa Administrative Nr. 2001/15 për zbatimin e Rregullores Nr. 2001/28, Qarkorja e UNMIK-ut për drejtësi 2000/17,
- Liqi në fuqi:**
Neni 74 (3) i KPPPK lexon në pjesën përkatëse:
“Nëse policia ose prokurori publik refuzon kërkesën e të pandehurit për t'i caktuar mbrojtës me shpenzime publike, i pandehuri mund t'i ankohet gjyqtarit të procedurës paraprake”
- KPPPK. Lexo Kreun II, Drejtësia Penale, paraburgimi i paligjshëm nga policia, A1.
- Dëshmitë:**
Të dhënat e policisë mbi arrestimin dhe paraburgimin, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të arrestuar
- Përshkrimi i mjetit juridik:**
Propozimi i mbrojtjes para gjyqtarit të procedurës paraprake (neni 83 (1) KPPPK. Lexo Kreun II, Drejtësia Penale, paraburgimi i paligjshëm nga policia, A1
- Mund të përflexoet në ankesën kundër ndalimit/arrestimit policor ose kundër vendimit të parë për paraburim të marrë në procedurën paraprake. Lexo Kreun II, Drejtësia Penale, paraburgimi i paligjshëm nga policia, A1
- Mekanizmi *habeas corpus* është i zbatueshëm. Lexo Kreun II, Drejtësia Penale, paraburgimi i paligjshëm nga policia, A1.

Parimet 1, 8 dhe 22 të
Parimeve Themelore mbi
Rolin e Avokatëve,
Rregulli 93 i Rregullave
Evropiane për Burgjet,
Neni 6 (3b, c) KEDNj-së)
neni 214 (1) (4) i KPPPK

8. Shkelja e të drejtës për të njoftuar familjen apo personin tjetër të përshtatshëm përkitazi me arrestin

Përfshirë këtu anëtarin e familjes; ndonjë person tjetër të përshtatshëm sipas zgjedhjes së tij/saj; Qendra për Punë

Sociale nëse personi i arrestuar shfaq shenja të sëmundjes mentale; Zyra e Ndërmjetësimit, posti konzular, misioni diplomatik i shtetit, organizata kompetente; prindërit apo kujdestari nëse personi i arrestuar nuk ka arritur moshën 18 vjeçare (Neni 200 KPPPK-së, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/28 mbi të drejtat e personave të arrestuar nga organet për zbatimin e ligjit (neni 2.1e, f dhe 2.2.4), Rregulli 92 të Rregullave Standarde Minimale, Parimi 16 (2) të Trupit të Parimeve, Rregulli 10(1) të Rregullave të Pekingut, Rregulli 22 i Rregullave të KB-ve për mbrojtjen e të miturve të të privuar nga liria)

Neni 214(1)(5) dhe 215 i KPPPK

9. Shkelja e të drejtës së personit të paraburgosur që të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe respekt për dinjitetin e tij/saj.

(Neni 10(1) MNDPC, 3 KEDNj) neni 155(1) dhe 288 i KPPPK

Ligji në fuqi:

Nuk ka dispozitë konkrete ligjore

Dëshmitë:

Të dhënat e policisë mbi arrestimin dhe paraburgimin, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të arrestuar

Përshkrimi i mjetit juridik:

Nuk ekziston ndonjë mjet juridik, përpos ankesave kundër policëve të SHPK-së dhe të UNMIK-ut. Rregullorja e UNMIK-ut 2001/28 nuk përmban kurrfarë mjeteve juridike për personat e arrestuar.

Lexo ankesat kundër organeve për zbatimin e ligjit Kreu III, policia e UNMIK-ut, SHPK, TMK dhe KFOR. Shkelja e kodit të sjelljes ose ligjit penal, A dhe B dhe Kreu II, drejtësia penale. Shkelja e të drejtës së personit të burgosur që të trajtohet me humanitet dhe respekt për dinjitetin e tij/saj, A.9.

Ligji në fuqi::

Nuk ka dispozitë konkrete ligjore. Mirëpo ligji në përgjithësi e konsideron ankesën e të burgosurit si mjet juridik.

Neni 206 dhe 297 i KPPPK

Neni 212 (6) i KPPPK lexon: "personi i arrestuar ka të drejtën e ankimit (ndaj paraburgimit...) pranë gjyqtarit në procedurë paraprake".

Neni 235 "Nëse marrja në pyetje e të pandehurit është zbatuar me shkelje të dispozitave nga neni(...) 234 paragrafi 2 i këtij Kodi, deklaratimet e të pandehurit janë të papranueshme".

Neni 155(3) i KPPPK –" Kur intervistimi ose marrja në pyetje është zbatuar në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni, procesverbali i intervistimit ose marrjes së tillë në pyetje është i papranueshëm.

Dëshmitë:

Të dhënat e policisë mbi arrestimin dhe paraburgimin, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të arrestuar, raportet mjekësore në rastet e abuzimit fizik.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Propozimi i mbrojtjes para gjyqtarit të procedurës paraprake. Nuk ekziston ndonjë mjet i vërtetë juridik. Propozimi i mbrojtjes është një mjet juridik i paqartë mirëpo si minimum mund të ofrojë prova se çështja ngritur në këtë fazë, nëse avokati mbrojtës gjatë seancës kryesore do të përpiqet të ndalojë prezentimin e dëshmimeve të fituara me shtrëngim. Lexo mjetin juridik C.2 si mëposhtë.

I paraburgosuri apo avokati i tij mbrojtës mund të parashtrijë ankesë kundër ndonjë polici të SHPK-së dhe UNMIK-ut. Lexo ankesat kundër organeve për zbatimin e ligjit Kreu III, policia e UNMIK-ut, SHPK, TMK dhe KFOR. Shkelja e kodit të sjelljes ose ligjit penal, A dhe B dhe Kreu II, drejtësia penale.

Personi kundër të cilit janë marrë masat e parapara nga nenet 201, 202, 204 ose 205 të KPPPK, gëzon të drejtën e paraqitjes së ankesës para prokurorit publik kompetent në afat prej tre ditësh. Prokurori publik me atë rast pa vonesë do të vërtetojë bazat e ankesës dhe nëse vërtetohet se veprimet apo masat e ndërmarra paraqesin shkelje të ligjit penal ose kodit të sjelljes të zbatueshëm për polici ose shkelje të detyrës zyrtare, ai ose ajo do të veprojë në pajtim me ligjin dhe do ta informojë personin i cili e ka paraqitur ankesën (neni 206 (2,3) i KPPPK.

Shënim: masat e përshkruara në nenet e lartpërmendura kanë për qëllim gjetjen e kryesit, parandalimin e tij ose bashkëpunëtorët që të fshehen ose arratisen, të zbulohen dhe ruhen gjurmët dhe dëshmitë tjera të veprës penale dhe sendeve të cilat mund të shërbejnë si prova dhe të mbledhen të gjitha të dhënat që mund të përdoren në procedurë penale. Këto masa përfshijnë: mbledhjen e informatave nga personat; kontrollimin e përkohshëm të mjeteve, pasagjerëve dhe bagazhit të tyre, kufizimi i lëvizjes nëpër vende të caktuara; masat e vërtetimit të identitetit të personave dhe sendeve; organizimi i kërkimeve për gjetjen e personave ose objekteve përmes qarkores; bastitja e ndërtesave dhe lokaleve të caktuara publike në praninë e personave përgjegjës dhe kontrollimi i dokumentacionit që i përket atyre; sekuestrimi i sendeve të caktuara sipas KPPPK ose të cilat mund të shërbejnë si prova në procedurë penale; kontrollimi fizik i palës së dëmtuar, etj.

Ligji në fuqi:

Nuk ka dispozitë konkrete ligjore

10. Shkelja e të drejtës për ekzaminim dhe trajtim mjekësor

(Rregullorja e UNMIK-ut 2001/28 mbi të drejtat e personave të arrestuar nga organet për zbatimin e ligjit

(nenet 2.1.g; 5; 6.1.h), Parimi 24 i grupit të parimeve) neni 216 i KPPPK

Neni 212 (6) i KPPPK lexon: "personi i arrestuar ka të drejtën e ankimit (ndaj paraburgimit...) pranë gjyqtarit në procedurë paraprake".

Dëshmitë:

Të dhënat e policisë mbi arrestimin dhe paraburgimin, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të arrestuar.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Propozimi i mbrojtjes para gjyqtarit të procedurës paraprake. Lexo Kreu II, drejtësia penale, shkelja e të drejtës së personit të burgosur që të trajtohet me humanitet dhe respekt për dinjitetin e tij/saj, A.9

Ligji në fuqi:

Neni 7(k) i Direktivës për paraburgim të KFOR-it

"Të paraburgosurit mund të ankohen kundër paraburgimit të tyre"

B. Paraburgimi jashtë gjyqësor

1. Paraburgimi jashtë gjyqësor nga KFOR-i

E drejta për të kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit (nenet 5 KEDNj & 9(4) MNDPC) Neni 286 (2) i KPPPK

Neni 286 (2) i KPPPK lexon: "I paraburgosuri ose mbrojtësi i tij në çdo kohë mund t'i ankohen gjyqtarit të procedurës paraprake ose kryetarit të trupit gjykues që të vendosë mbi ligjshmërinë e paraburgimit."

Dëshmitë:

Formulari i Urdhëresës 42 të KFOR-it, vendimet e mëpastajshme në lidhje me paraburgimin

Përshkrimi i mjetit juridik:

- Nuk ka mekanizma ose afate detaje në Direktivën e KFOR-it.
- Avokati mbrojtës mund të paraqesë kërkesë/ankesë pranë gjykatës për ushtrimin e mekanizmit *habeas corpus*. Lexo Kreu II, drejtësia penale, paraburgimi i

paligjshëm policor, A1.

2. Urdhërat ekzekutiv për paraburgim të PSSP-së
E drejta për të kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit (Neni 5 KEDNj & 9(4) MNDPC)

Shënim: Mjeti juridik i paraparë me Rregulloren 2001/18 nuk është më i zbatueshme për shkak se fushëveprimi i tij ishte i kufizuar për një periudhë kohore prej tre muajve dhe për raste individuale (rasti Nish Ekspres). Sidoqoftë, pushteti i PSSP-së për të dhënë urdhër ekzekutiv për paraburgim nuk është anuluar në mënyrë përjashtimore dhe së këndejmi nevoja për të pasur një mjet juridik efikas në këtë drejtim mbetet edhe mëtej.

Ligji në fuqi

- Neni 4.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/18, për themelimin e një komisioni për shqyrtimin e paraburgimeve jashtëgjyqësore të bazuara në urdhëra ekzekutiv.

“Komisioni i shqyrton rastet e paraburgimeve jashtëgjyqësore të bazuara në urdhëra ekzekutiv. Shqyrtimi mund të inicohet me propozimin e vet Komisionit ose me kërkesën e personit të paraburgosur në bazë të një urdhëri të tillë ekzekutiv ose me kërkesën e mbrojtësit të tij apo saj.”

Neni 286 (2) i KPPPK lexon: “I paraburgosuri ose mbrojtësi i tij në çdo kohë mund t'i ankohen gjyqtarit të procedurës paraprake ose kryetarit të trupit gjykues që të vendosë mbi ligjshmërinë e paraburgimit.”

Dëshmitë:

Urdhëri ekzekutiv të PSSP-së

Përshkrimi i mjetit juridik:

- Ankesa e personit të paraburgosur apo avokatit të tij/saj mbrojtës parashtuar Komisionit për shqyrtim të paraburgimit i cili është përgjegjës për shqyrtimin e urdhërave ekzekutiv. KSHP-ja do të merr vendim sa më shpejtë që është e mundur mirëpo jo më vonë se 7 ditë nga dita e pranimit të ankesës. Nuk ekziston ndonjë organ i pavarur në bazë të nenit 6 të KEDNj-së.

Mekanizmi *habeas corpus* është i zbatueshëm. Lexo Kreun II, Drejtësia Penale, paraburgimi i paligjshëm nga policia, A1.

C. Hetimet para dhe pas ngritjes së aktakuzës

1. Paraburgimi i paligjshëm

E drejta për të kundërshtuar paraburgimin/njoftimi për bazat e paraburgimit (Neni 9(4) MNDPC; Neni 5(4) KEDNj; Parimet 11(2), 32 & 39 të Trupit të Parimeve, nenet 151(13), KPPPK-së) Neni 151 (13) KPPPK

Ligji në fuqi:

- Neni 283(3) KPPPK-së: “Secila palë mund të paraqesë ankesë brenda njëzet e katër orëve nga koha e dorëzimit të aktvendimit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit. Nëse ankohet vetëm njëra palë, gjykata ia dërgon ankesën palës tjetër e cila argumentet e veta mund t'ia paraqesë gjykatës brenda njëzet e katër orëve nga dorëzimi i ankesës. Për ankesë vendoset brenda dyzet e tetëorëve nga paraqitja e saj.”

Neni 285 (5) KPPPK: “Ndaj çdo aktvendi mbi vazhdimin e paraburgimit mund të ushtrohet ankesë.(...)”

Neni 287 (1) KPPPK: “Pas ngritjes së aktakuzës dhe deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, paraburgimi mund të caktohet ose të hiqet vetëm me aktvendim të trupit gjykues ose kur trupi gjykues nuk është në seancë, kjo mund të caktohet nga kryetarit i trupit gjykues i cili së pari ndëgjon mendimin e prokurorit publik kur procedura është filluar me kërkesën e tij dhe mendimin e të pandehurit ose mbrojtësit. Kundër aktvendimit palët kanë të drejtë ankese (...).”

Neni 287 (2) – “Pasi të kalojnë dy muaj nga aktvendimi i fundit për paraburgim, trupi gjykues ose kur trupi gjykues nuk është në seancë, kryetari i trupit gjykues edhe pa propozimin e palëve shqyrton nëse ende ekzistojnë arsyet për paraburgim dhe merr aktvendim për zgjatjen ose heqjen e paraburgimit. Kundër aktvendimit palët kanë të drejtë ankese (...).”

Dëshmitë:

Të dhënat e policisë dhe të hetimeve, aktvendimi mbi paraburgimin dhe zgjatjet e mëpastajshme, kërkesa dhe aktvendimi për të zhvilluar hetimet, aktakuza apo tërheqja e akuzave, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të akuzuar, lista e personave të paraburgosur të qendrës dhe objekteve të paraburgimit.

Përshkrimi i mjetit juridik:

- Propozimi i mbrojtjes para gjyqtarit të procedurës paraprake. Këto kërkesa/propozime përbëhen nga parashtrirat gojore në lidhje me bazat për paraburgim para gjyqtarit të procedurës paraprake ose trupit gjykues. Lexo Kreun II, Drejtësia penale, shkelja e të drejtës për informim të shpejtë për shkaqet e arrestimit, në gjuhën të cilën i arrestuari e kupton, A3

Ankesa kundër vendimit për paraburgim dhe zgjatjet e mëpastajshme të tij parashtrohet nga personi i arrestuar/paraburgosur apo/dhe avokati i tij/saj mbrojtës. Ankesa kundër vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake (për zgjatjen e paraburgimit për edhe një muaj pas arrestimit) paraqitet para trupit gjykues të shkallës së parë. Ankesat kundër vendimeve të mëvonshme për paraburgim (të dhëna nga trupi gjykues) parashtrohen para kolegjit të gjyqtarëve. Të dyja ankesat do të parashtrohen brenda afatit prej 24 orëve nga momenti i dhënjes së vendimit. Të dyja këto kolegje të gjyqtarëve duhet të marrin vendim brenda afatit prej 48 orëve. Ankesa nuk ndalon ekzekutimin e vendimit.

Në rastet kur paraburgimi shpallet i paligjshëm, personi i paraburgosur mund të paraqesë kërkesën për komensim. Lexo Kreun II, Drejtësia penale, kompensimi për paraburgimet joligjore ose arrestimet dhe paraburgimet pa justifikim, A,2

- 2. Shkelja e të drejtës për kushte njerëzore dhe liria nga tortura gjatë paraburgimit**
Nenet; 7 & 10 MNDPC;
neni 3 KEDNJ; 2(2)
Konventa mbi Torturën)
Neni 155 dhe 288 i KPPPK-së

Ligji në fuqi:

Neni 212 (6) i KPPPK.

“personi i arrestuar ka të drejtën e ankimit (ndaj paraburgimit...) pranë gjyqtarit në procedurë paraprake”.

Neni 235 i KPPPK:

“Nëse marrja në pyetje e të pandehurit është zbatuar me shkelje të dispozitave nga neni 155, paragrafi 1, (...) i këtij Kodi, deklaratimet e të pandehurit janë të papranueshme.”

Dëshmitë:

Raporti hetues, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të arrestuar, raportet mjekësore në rastet e abuzimit fizik.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Ankesa kundër policëve të SHPK-së dhe UNMIK-ut. Lexo Kreun III, ankesat kundër Organe për zbatimin e ligjit, shkelja e kodit të sjelljes, A dhe B.

Propozimi i mbrojtjes i ushtruar para gjyqtarit në procedurë paraprake. Nuk është mjet i qartë juridik. Propozimi i mbrojtjes mund të ofrojë së paku të provojë se çështja është ngritur në këtë fazë, nëse mbrojtësi ka për qëllim që në seancën kryesore t'i kundërshtojë dëshmitë e siguruar me forcë. Lexo Kreun II, Drejtësia penale, Shkelja e të drejtës së personit të arrestuar për trajtim njerëzor dhe respekt për dinjitetin e tij/saj, A.9 dhe dëshmia nën shtrëngim ose pranimi i fajësisë/ shkelja e të drejtës për heshtje, D.4 (në kërkesën për kundërshtimin e provave të siguruar me forcë)

Ligji në fuqi:

- Neni 314 (2) i KPPPK-së

“(gjyqtari çmon se e drejta e të pandehurit në mbrojtës është respektuar dhe se të dy palët kanë përmbushur detyrimin lidhur me zbulimin e provave.”

- Neni 235 i KPPPK-së :

- 3. Shkelja e të drejtës për avokat gjatë fazës paraprake të procedurës penale**

(Parimi 1 i Parimeve themelore mbi rolin e avokatëve; Parimi 17(1) i Trupit të Parimeve)

Neni 69 i KPPPK-së

E drejta për kohë dhe mjete adekuate për të përgatitur mbrojtjen (Nenet 12 dhe 321 (3) të KPPPK-së,

Qasja në avokat gjatë paraburgimit (neni 69 i KPPPK-së, Parimi 7 i Trupit të Parimeve mbi rolin e avokatëve)

Komunikimet konfidenciale (Parimi 18(1) i Trupit të Parimeve; Parimi 22 i Parimeve themelore mbi rolin e avokatëve); nenet 77(2) dhe 213 (3) KPPPK

E drejta për avokat falas (neni 74 i KPPPK-së; Parimi 17(2) i Trupit të; Qarkorja e UNMIK-ut 2000/17; Neni 6(3c) KEDNJ, Parimi 6 Parimeve mbi rolin e avokatëve)
Të drejtat speciale për të miturit (neni 40 i Kodit penal për të mitur)

4. Shkelja e të drejtës së mbrojtjes për t'i ekzaminuar dëshmitë gjatë fazës paraprake /E drejta për të prezentuar mbrojtjen

E drejta e mbrojtjes për t'i ekzaminuar dëshmitarët të cilët dëshmojnë kundër të akuzuarit dhe prezentimi i dëshmitarëve të mbrojtjes të fituar gjatë hetimeve të procedurës paraprake.

E drejta për ekzaminimin e shkresave të lëndës /E drejta për të poseduar me një kopje të tyre. Parimi 21 i Parimeve themelore mbi rolin

“Nëse marrja në pyetje e të pandehurit është zbatuar me shkelje të dispozitave nga neni (...), neni 231, paragrafët 2 dhe 3 (...) i këtij Kodi, deklarimet e të pandehurit janë të papranueshme”.

-Neni 153 I KPPPK-së:

“Provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu.”

-Neni 403(1)(8) I KPPPK (bazat e aneksës):

“Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse: (...) aktgjykimi bazohet në prove të papranueshme”.

Dëshmitë:

Të dhënat e heutesisë, deklaratat e dëshmitarëve dhe të akuzuarve, vendimet gjyqësore.

Përshkrimi i mjetit juridik:

- Kërkesa e parashtruar gjyqtarit të procedurës paraprake. Çështja lidhur me pranimin e provës mund të ngritet nga pala në kohën kur prova l paraqitet gjykatës dhe në rast të veçantë në seancën për konfirmimin e aktakuzës. Përjashtimisht, mund të ngritet më vonë, nëse çështjet nuk i janë bërë të njohura palës në kohën kur prova është paraqitur, ose ekzistojnë rrethana të tjera të justifikueshme. Gjykata mund të kërkojë që çështja të paraqitet me shkrim. Në mungesë të kërkesës së palës, gjykata duhet të vendosë mbi pranimin e provës sipas detyrës zyrtare kurdoherë që gjatë procedurës lind dyshimi mbi ligjshmërinë e provës (neni 154 i KPPPK)

- Mbrojtja mund të kundërshtojë pranueshmërinë e deklaratave të dhëna gjatë fazës paraprake në seancën kryesore, citat i neni 6 të KEDNJ-së dhe neni 235 i KPPPK

Mund të përflexoet në ankesën kundër aktgjyqimit. Ankesa kundër aktgjyqimit duhet të bëhet nga vetë personi i akuzuar dhe avokati mbrojtës i tij/saj brenda afatit prej 15 ditëve (8 ditë kur i pandehuri është i mitur) nga dita e pranimit të procesverbalit të aktgjyqimit. (neni 398(1) i KPPPK dhe neni 75 i (KPM-ur)

Kërkesën për rishikimin e procedurës penale mund ta bëjë i akuzuari ose mbrojtësi i tij. Vendoset nga trupi gjyqësor i shkallës së parë i cili e ka gjykuar rastin. Mund të paraqitet edhe pasi presoni i dënuar ta ketë vuajtur denimin (nenet 442 (4), 443(2) të KPPPKsë)

Liqi në fuqi:

- Neni 239 (2) i KPPPK-së “(...)Nëse prokurori publik refuzon kërkesën për marrjen e provës, ai merr vendim të arsyetuar dhe njofton të dëmtuarin ose të pandehurin. I dëmtuari ose i pandehuri mund të ankohen te gjyqtari i procedurës paraprake ndaj vendimit të tillë.”

- Neni 142 (3) në pjesët përkatëse: “(...)Prokurori publik mund t'i refuzojë mbrojtësit shikimin, kopjimin ose fotografimin e shkresave të caktuara, të librave, dokumenteve, fotografive dhe objekteve të tjera materiale në zotërim, ruajtje ose nën kontroll të tij, nëse ka gjasa reale se shikimi, kopjimi ose fotografimi mund të rrezikojë qëllimin e hetimit, jetën ose shëndetin e njerëzve. Në rast të tillë, mbrojtësi mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake të lejojë shikimin, kopjimin ose fotokopjimin. Vendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake është përfundimtar.”

-Neni 173 (3):

“(...)Ankesa kundër urdhrat për anonimitet dhe përdorimi i metodave për të parandaluar zbulimin e identitetit ndaj publikut, të dëmtuarit, dëshmitarëve, mbrojtësit dhe të pandehurit mund t'i paraqitet kolegjit prej tre gjyqtarësh kur urdhri është dhënë nga gjyqtari i procedurës paraprake. Në të kundërtën, mund të ushtrohet ankesë vetëm kundër aktgjyqimit.

Neni 263 I KPPPKsë

avokatëve; Neni 14(3)(d) MNDPC; Neni 6(3)(d) KEDNJ; Regulloret e UNMIK-ut 2001/20, 2001/21, 2002/1, 2002/2) Nenet 1.3 (a),(b),(c) të UA 2002/25

E drejta e mbrojtjes të jetë prezente gjatë të gjitha marrjeve në pyetje nga policia neni 218 (1) KPPPK

E drejta e mbrojtjes të shiqojë, ekzaminojë dhe fotokopjojë dhe fotografojë shkresat dhe materialin e lëndës në çdo fazë të procedurës neni 142 (1) i KPPPK

E drejta e të akuzuarit dhe mbrojtësit që të merr në pyetje dëshmitarët neni 165(1) KPPPK

E drejta e mbrojtjes të jetë prezente gjatë seancave të mbyllura dëgjimore për dëshmitarët anonim të propozuara nga ajo neni 171 (2) i KPPPK

E drejta e mbrojtjes të jetë prezente gjatë seancave të mbyllura dëgjimore për dëshmitarët anonim JO të ftuar nga ajo neni 172 i KPPPK

E drejta e mbrojtjes të ketë qasje në materialin e lëndës për çështjet që kanë të bëjnë me masat teknike dhe të vëzhgimit, nën kushtet e parapare me dispozitat e parapara me ligj neni 263 (4) i KPPPKsë

5. **E drejta për gjykim brenda kohës së arsyeshme ose lirim nga paraburgimi**
Neni 5(3) KEDNJ; Neni 9(3) MNDPC)
Nenet 5 dhe 25 të KPPPKsë

Dëshmitë:

Vendimet e gjykatës, raportet e hetimeve, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të akuzuar

Përshkrimi i mjetit juridik:

Nëse prokurori publik refuzon shikimin e shkresave, i dëmtuari mund t'i paraqesë ankesë gjyqtarit të procedurës paraprake. Vendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake është përfundimtar. Mirëpo, nëse gjyqtari i procedurës paraprake refuzon shikimin e shkresave me të cilat disponongjykata, atëherë mund të paraqitet ankesë në kolegjin prej tre gjyqtarësh (neni 143 (3,4) I KPPPK-së).

Përlexoet në ankesën kundër aktgjykimit. Lexo Kreu II, Drejtësia penale, shkelja e të drejtës për avokat gjatë fazës paraprake, C,3.

Nuk ka mjet specifik juridik kundër refizimit të marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe paraqitjes së tyre. Mjeti juridik i përfshirë: kundërshtimet me shkrim ndaj aktakuzës ose pranueshmërisë së provave në rastin heqjes dorë nga konfirmimi i aktakuzës (neni 309/3 (3)); ankesa kundër vendimit mbi arrestin ose paraburgimit; ankesa kundër aktgjykimit. Lexo Kreun II, drejtësia penale, paraburgimi i paligjshëm i policisë, A 1 dhe shkelja e të drejtës për kushte njerëzore në burg dhe liria nga të torturuarit gjatë paraburgimit, C 2.

Ankesa kundër anonimitetit që i drejtohet kolegjit prej tre gjyqtarëve, nëse ky vendim (urdhër) është dhënë nga gjyqtari i procedurës paraprake (neni 173 (3) KPPPK

Ankesa pranë kolegjit për rishqyrtim të hetimeve dhe vëzhgimeve, kundër materialeve të pranuar me zbatimin e udhërit për masat teknike të vëzhgimit dhe hetimit të fshehtë, objekt i të cilave ka qenë vet i pandehuri (neni 263 (1) KPPPK.

Ligji në fuqi:

- Neni 284 (4) i KPPPK-së:

“Kur aktakuza nuk ngritet para kalimit të afatit të paraparë në paragrafin (...), i paraburgosuri lirohet.”

-Neni 285 (5) në pjesën përkatëse:

“Ndaj çdo aktvendimi mbi vazhdimin e paraburgimit mund të ushtrohet ankesë.

Dëshmitë:

Vendimet mbi paraburgimin dhe zgjatjen e tij, raportet e hetimeve, lista e personave të paraburgosur në qendrat dhe objektet e paraburgimit.

Përshkrimi i mjetit juridik:

- Ankesë me shkrim kryetarit të gjykatës.
 - Propozimi për lirim (me kaucionl)/propozimi për lirim nëse aktakuza nuk ngritet brenda 12 muajsh nga caktimi i paraburgimit mund t'i parashtrahet kolegjit të gjykatës së shkallës së parë. Lexo Kreun II drejtësia penale, paraburgimi i paligjshëm C 1, KPPPK parashikon gjobat dhe mukndësinë e masave dicitinore kundër avokatit mbrojtës, përfaqësuesit ligjor, palës së dëmtuar, paditësit subsidiar ose privat për veprimet të cilat qëllimisht e zvarrisin procedurën penale (neni 146 i KPPPK)
- Kërkesa për këto dënime mund të bëhet nga gjyqtari/kryetari i kolegjit ose nga pala e prekur në proceurë. Nuk ka dispozita të qarta dhe specifike që e rregullojnë këtë procedurë.

6. Paraburgimi pa të drejtë komunikimi

E drejta për të gëzuar qasje në botën jashtë burgut: familjen, zyrën e ndërmjetësimit, misionin diplomatik dhe konzullar të një shteti, organizatës kompetente ndërkombëtare; doktorët (Parimet 15, 16 & 19 të Trupit të Parimeve; Rregulla 92 e Rregullave Standarde Minimale; Neni 7 MNDPC; Neni 3 KEDNJ, Neni 294 (1,2,3,4) i KPPPK

Ligji në fuqi:

Neni 294(5) KPPPK-së:

“Kur gjyqtari i procedurës paraprake refuzon vizitën në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni ose e ndalon komunikimin në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, i paraburgosuri mund të kërkojë nga kolegji prej tre gjyqtarësh t'i jepet leje e tillë.”

Neni 294 (4) i KPPPKsë

E drejta e ankesë, neni 398 (1) i KPPPKsë

“Kundër aktgjykimit të marrë në shkallë të parë, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbdhjetë ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit.”

Dëshmitë:

Deklarata e të paraburgosurit; shënimet e qendrës së paraburgimit; deklaratat e dëshmitarëve

Përshkrimi i mjetit juridik:

Në rast se gjyqtari i procedurës paraprake e ndalon komunikimin ose e refuzon vizitën, i paraburgosuri/mbrojtja mund të kërkojë nga kolegji prej tre gjyqtarësh t'i jepet leja e tillë 294 (5) KPPPK.

Kufizimet e vizitave ose dërgim-pranimit të letrave ndaj të paraburgosurit mund të shqiptohen në rastet e shkeljeve dicitinore, ndërsa këto vendime mund të kundërshtohen me ankesë pranë kolegjit prej tre gjyqtarësh brenda afatit prej 24 orësh nga pranimi i kufizimit (neni 294 (4)).

- Ankesa pranë Departamentit të Drejtësisë, kërkesa kryetarit të gjykatës. Nuk ekziston ndonjë bazë e posaçme ligjore për ankesat që parashtrahen pranë Departamentit të Drejtësisë mirëpo praktika e sugjeron një gjë të tillë.

- Neni 1.1 Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64: (mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/34):

Githashtu lexo Kreun II, drejtësia penale, shkelja e të drejtës për avokat gjatë fazës së paraburgimit, C 3 dhe shkeljet e të drejtave të personave të paraburgosur që të trajtohen njerëzisht dhe me respekt për dinjitetin e tij/saj A 9.

D. Gjykimi & Rigjykimi

1. Shkelja e të drejtës për gjykim nga një tribunal kompetent, i pavarur dhe i paanshëm i themeluar me ligj

Ligji mbi Gjykatat e Rregullta (1978), Ligji mbi Prokurorinë Publike (1976), Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64, 1999/7, 2000/57, 2001/8,

Ligji në fuqi:

- Neni 42 i KPPPK-së e rregullon përjashtimin e gjyqtarëve. Dispozitat për përjashtimin e gjyqtarëve dhe të gjyqtarëve laikë zbatohen përshtatshëmrisht edhe ndaj prokurorëve publikë dhe personave të autorizuar që përfaqësojnë prokurorin publik në procedurë sipas ligjit mbi prokurorinë publike, personave të autorizuar të policisë, procesmbajtësve, përkthyesve, specialistëve dhe ekspertëve, nëse nuk është paraparë ndryshe (neni 45)
- Akesa e përgjithshme, neni 389 (1) i KPPPK

Lexo Kreun II, drejtësia penale, shkelja e të drejtës për avokat në fazën paraprake, C 3

Dëshmitë:

Nenet 44-47 të Rregullores së brendshme të gjykatave 6/1 KEDNJ, 14/1 MNDPC, neni 10 i Deklaratës Universale, 40/2b(iii) i Konventës për të Drejtat e Fëmijës, 10 nga Udhëzimet mbi rolin e prokurorit, Parimet themelore mbi pavarësinë e gjyqësisë) Neni 2 dhe 8 i KPPPK

Shënimet e policisë dhe hetimeve, aktakuza, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të akuzuar, procesverbali i gjykimit, aktgjykimi i shkruar.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Përjashtimin e gjyqtarit mund ta kërkojnë edhe palët.

Pala detyrohet të kërkojë përjashtimin e gjyqtarit ose të gjyqtarit laik sapo të mësojë për ekzistimin e arsyeve për përjashtim më së largu deri para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, ndërsa në rast të përjashtimit për arsyet e parapara në nenin 40, paragrafi 3 i këtij Kodi përjashtimin e kërkon para fillimit të shqyrtimit gjyqësor (neni 42 (2) I KPPPK Kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit të gjykatës më të lartë pala mund ta bëjë në ankesë ose në përgjigje të ankesës (neni 42 (3)). Kërkesa e tillë i drejtohet kryetarit të gjykatës përkatëse ose prokurorit më të lartë publik (nenet 43 (1) dhe 45 të KPPPK.

Pala mund të kërkojë përjashtimin e gjyqtarit ose të gjyqtarit laik që e trajton çështjen apo të gjyqtarit të gjykatës më të lartë vetëm nëse e identifikon me emër nëneni 42 (4). Pala detyrohet që në kërkesë të shënojë rrethanat me të cilat e mbështet pretendimin për ekzistimin e bazës ligjore për përjashtim. Shkaqet e paraqitura në kërkesën e mëparshme për përjashtim e cila është refuzuar nuk mund të paraqiten përsëri në kërkesë (neni 42 (5) të KPPPK.

Kolegji i gjyqtarëve, krytari i trupit gjykues ose gjyqtari i procedurës paraprake, vendos për përjashtimin e procesmbajtësit, përkthyesit, specialistit dhe ekspertit. Në qoftë se personi i autorizuar i policisë zbaton veprime hetimore në bazë të këtij Kodi, për përjashtimin e tij vendos prokurori publik kompetent. Po qe se me rastin e ndërmarrjes së këtyre veprimeve merr pjesë procesmbajtësi, për përjashtimin e tij vendos personi zyrtar i cili ndërmerr veprimet (neni 45 i KPPPK)

Kërkesa për caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar dhe/apo ndërrimi i vendit të gjykimit parashtrohet nga ana e personit të akuzuar apo avokati i tij/saj mbrojtës DD-së në çfarëdo faze të procedurës penale. Vendi i ri i gjykimit së bashku me kolegjin nuk do të caktohen derisa të mos ketë filluar seanca gjyqësore apo seanca e kolegjit të apelit. Sidoqoftë, një kolegji i tillë mund të themelohet për një shqyrtim të mëpastajshëm apo mjet juridik të jashtëzakonshëm (Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 mbi caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar dhe ndërrimin e vendit.

Nëse vendimi mbi përjashtimin është dhënë pas ngritjes së aktakuzës; kjo mund të kontestohet vetëm përmes ankesës kundër aktgjykimit, për shkak se në Kod nuk ka dispozitë të posaçme për këtë çështje.

Lexo Kreun II, drejtësia penale, shkëlja e të drejtës për avokat gjatë fazës paraprake, C 3

Kërkesa për rihapjen e procedurës penale të cilën e paraqet i akuzuari ose mbrojtësi i tij. Mbi të vendosë trupi gjykues i shkallës së parë që e ka shqyrtuar rastin. Mund të paraqitet edhe pasi i denuari ta ketë vuajtur dënimin (neni 442 (4), 443 (2) të KPPPK.

- Nëse personi beson se gjyqtari, prokurori ose gjyqtari porot ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme, ai/ajo mund të paraqesin ankesë pranë Shërbimit të Inspektionit Gjyqësor (SHIGJ). SHIGJ i heton aktivitetet e personave që punojnë në sistemin gjyqësor dhe bën rekomandimet për drejtorin e Departamentit të Drejtësisë (Urdhëresa administrative 2001/4 për zbatimin e Rregullores 2000/15 mbi themelimin e Departamentit Administrativ të Drejtësisë). Në bazë të kërkesës së Departamentit të Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës është përgjegjës për dëgjimin e të gjitha rasteve të dyshimeve për sjellje të gabuar (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/8, neni 7).

2. Shkelja e të drejtës për gjykim publik

Përjashtimet e pranueshme të publikut nga gjykimi janë (të miturit, mbrojtja e viktimave). 6(1) KEDNJ, dhe neni 10 I Deklaratës Universale, dhe 14(1) e MNDPC-së)

Ligji në fuqi:

Nuk ka dispozitë konkrete ligjore

E drejta e ankesës, neni 398 (1) i KPPPK

Dëshmitë:

Deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të akuzuar, procesverbali i gjykimit, aktgjykimi me shkrim.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Neni 328 dhe 329 i KPPPKsë

Nuk ka mjet të posaçëm juridik për shkeljen e të drejtës për gjykim publik. Mund të jetë bazë për ankesë kundër aktgjykimit.

Lexo Kreun II, drejtësia penale, shkelja e të drejtës për avokat në fazën paraprake, C 3

Palët mund të kërkojnë seancën e mbyllur nëse besojnë se masat e tilla janë të arsyetueshme.

3. Shkelja e prezumimit të pafajësisë

(p.sh. atribuimi i fajësisë personit të akuzuar nëpërmjet të dhënies së uniformës së të burgosurit apo vënies së prangave)
6/2 KEDNJ, 11 I
Deklaratës Universale, 14/2 MNDPC, 40/2b(I) I
Konventës mbi të Drejtat e Fëmiut)
Neni 1(2) dhe 3 i KPPPK

Liqi në fuqi:

Nuk ka dispozitë konkrete ligjore.

E drejta e ankesës, neni 398 (1) i KPPPK

Dëshmitë:

Shkresat e policisë dhe hetimeve, aktakuza, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të akuzuar, procesverbali, aktgjykimi me shkrim.

Përshkrimi i mjetit juridik:

- Propozimi i mbrojtjes në pritje të gjykimit apo rigjykimit. Lexo Kreun II, drejtësia penale, paraburgimi policor i kundërligjshëm, A !

Nuk ekziston ndonjë mjet juridik i posaçëm kundër prezumimit të pafajësisë, por mund të shërbejë si bazë për ankesën e përgjithshme kundër aktgjykimit.

Lexo Kreun II, drejtësia penale, shkelja e të drejtës për avokat në fazën paraprake, C 3

4. Shtyerja për të dëshmuar apo pranuar fajin/shkelja e të drejtës për heshtje

6 KEDNJ, 14/3g
MNDPC, 40/2b(iv) mbi Konventën për të Drejtat e Fëmiut, Udhëzimi 16 i Udhëzimeve mbi Rolin e Prokurorëve, Nenet 12, 15 & 16 të Deklaratës kundër Torturës, Trupi i Parimeve)
Neni 214 (2)(2) KPPPK
Neni 231 (2)(2) KPPPK

Liqi në fuqi:

Nuk ka dispozitë konkrete ligjore.

E drejta e ankesës, neni 398 (1) i KPPPK

Dëshmitë:

Shkresat e policisë dhe hetimeve, aktakuza, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të akuzuar, shënimet e gjykimit, aktgjykimi me shkrim.

Përshkrimi i mjetit juridik:

- Propozimi i mbrojtjes për përjashtimin e dëshmitarëve të fituara si rezultat i torturës, trajtimit të vrazhdë, johuman dhe degradues & shtrëngimet tjera. Nuk ekziston ndonjë autoritet i pavarur ligjor i cili do të vendoste mbi propozimin përkatës mirëpo një opcion tjetër në këtë drejtim është zbatimi i standardeve ndërkombëtare.

- Nuk ekziston ndonjë mjet juridik në rast të shkeljes së të drejtës për heshtje, mirëpo mund të jetë bazë për ankesë kundër aktgjykimit. Lexo Kreun II, drejtësia penale, shkelja e të drejtës për avokat në fazën paraprake, C 3

5. Zbatimi retroaktiv i ligjeve penale dhe rreziku i dyfishtë

(14/7 & 15/1 MNDPC, 7 KEDNJ, 4 i Protokollit 7 të KEDNJ-së, 11/2 i Deklaratës Univerzale)
Neni 2 i KPPPK
Neni 404 (3) KPPPK
Neni 442 (1, 4) KPPPK

Liqi në fuqi:

E drejta e ankesës, neni 398 (1) i KPPPK

Neni 443 (1) i KPPPK thotë:

“Rishikimin e procedurës penale mund ta kërkojnë palët dhe mbrojtësi. Pas vdekjes së të dënuarit, rishikimin mund ta kërkojë prokurori publik, bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor, farefisi në vijë direkte deri në shkallë të parë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllau, motra ose prindi birësues i të dënuarit.

Dëshmitë:

Shkresat e policisë dhe hetimeve, aktakuza, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të akuzuar, shënimet e gjykimit, aktgjykimi me shkrim.

Përshkrimi i mjetit juridik:

- Propozimi i mbrojtjes në pritje apo gjatë gjykimit. Lexo Kreun II, drejtësia penale, shkelja

e të drejtës për informim të menjëhershëm për arsyet e arrestimit në gjuhën që ai/ajo e kupton A 3.

- Nuk ekziston asnjë mjet juridik përkitazi me zbatimin retroaktiv të ligjit penal. Sidoqoftë, zbatimi retroaktiv mund të jetë bazë për ankesë të aktgjykimit. Lexo Kreun II, drejtësia penale, shkëlja e të drejtës për avokat në fazën paraprake, C 3
Procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet vetëm nëse: personi për të njëjtën vepër është gjykuar disa herë ose kur disa persona janë dënuar për vepër të njëjtë të cilën ka mund ta kryejë vetëm një person ose disa prej tyre (neni 442 (1)(2) KPPPK).

Rishikimin e procedurës penale mund ta kërkojnë palët dhe mbrojtësi (neni 443 (1) KPPPK).

6. Shkelja e të drejtës për gjykim pa vonesë të padrejtë apo lirim

Neni 5 i KPPPK
14/3c MNDPC, 5/1c, 5/3, 6/1 KEDNJ-së, 40/2b(iii)
I Konventës për të Drejtat e Fëmijës, Rregulli 17 I Rregullave të KB-ve për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria), neni 37 i Ligjit penal për të mitur

Ligji në fuqi:

Nuk ekziston ndonjë dispozitë e veçantë. KPPPK parashikon alternativa plotësuese, përveç paraburgimit, për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë: arresti shtëpiak (neni 278 i KPPPK); paraqitja në stacionin policor (neni 273 KPPPK); premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin.

Dëshmitë:

Deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të akuzuar, dosjet e hetimit, vendimet mbi paraburgimin dhe zgjatjet e tij të mëvonshme, borxhi detyrues apo dhënia në peng e pronës së paluajtshme si dorëzani e dorës së dytë për kaucion.

Përshkrimi i mjetit juridik:

- Pala mbrojtëse mund të paraqes propozim para kolegjit të gjykatësve apo lirim në pritje të gjykimin apo propozimit për lirim me kaucion apo peng(neni 274 KPPPK). Thelbi i propozimit duhet të bazohet në standardet ndërkomëbare, në veçanti në nenin 6 KEDNJ.

Ankesa kundër vendimeve për paraburgim të urdhëruara nga trupi gjykues.

7. Shkelja e të drejtës për të mbrojtur vetën personalisht apo nëpërmjet të avokatit mbrojtës

Barazia e palëve në procedurë/E drejta për të zgjedhur avokatin mbrojtës/E drejta për ndihmë juridike pa pagesë/E drejta për komunikim konfidencial me avokatin/Qasja në përfaqësim ligjor efektiv
Nenet 6/3b,c,d KEDNJ, 14/3d MNDPC, 40/2b(ii) i Konventës për të Drejtat e Fëmijës, Parimet themelore mbi rolin e avokatëve)

Neni 12 (2) i KPPPK

E drejta e mbrojtësit që të ketë në disponim materialet dhe kopjet nga dosja e lëndës në

Ligji në fuqi:

- Neni 75(4) KPPPK-së:

“Në bazë të kërkesës së të pandehurit ose me pëlqimin e tij, kryetari i gjykatës mund të shkarkojë mbrojtësin e caktuar i cili nuk e ushtron si duhet detyrën. Në vend të mbrojtësit të shkarkuar, kryetari i gjykatës cakton një mbrojtës të pavarur me përvojë dhe kompetent në pajtim me natyrën e veprës penale”.

- Neni 239 i KPPPK-së:

“(1) Gjatë hetimit, i dëmtuari ose i pandehuri mund të kërkojë nga prokurorit publik marrjen e ndonjë prove konkrete.

(2) (...) Nëse prokurori publik refuzon kërkesën për marrjen e provës, ai merr vendim të arsyetuar dhe njofton të dëmtuarin ose të pandehurin. I dëmtuari ose i pandehuri mund të ankohen te gjyqtari i procedurës paraprake ndaj vendimit të tillë.”

-Neni 322 i KPPPK-së

“(1) Palët, mbrojtësi dhe i dëmtuari edhe pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor mund të kërkojnë që në shqyrtim gjyqësor të thirren dëshmitarë dhe ekspertë të rinj ose të mblidhen prova të reja. Kërkesa e palëve duhet të jetë e arsyetuar dhe të shënojë se cilat fakte duhet provuar dhe me cilat prova të propozuara.

(2) Kur kryetari i trupit gjykues refuzon propozimin për mblidhjen e provave të reja, propozimi i tillë mund të përsëritet gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Neni 376 (3) i KPPPK:

“Kur ndryshohet aktakuza, i akuzuari ose mbrojtësi mund të propozojnë ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor për përgatitjen e mbrojtjes. Trupi gjykues mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor për përgatitjen e mbrojtjes kur thelbi i akakuzës është ndryshuar ose është zgjeruar.”

posedim të prokurorit publik, (neni 307 (1) KPPPK,

E drejta e mbrojtjes të jetë e pranishme në seancën për konfirmim të aktakuzës (neni 309 (2)

E drejta e mbrojtjes të paraqesë pikëpamjet e veta lidhur me pranimin e të pandehurit (neni 315 (2))

- Neni 285 KPPPK-së:

Dëshmitë:

Shkresat e policisë dhe hetimeve, aktakuza, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të akuzuar, shënimet e gjyqimit, aktgjykimi me shkrim

Përshkrimi i mjetit juridik:

Kundërshtim i veçantë kundër vendimit për mohimin e lejes për shiqimin dhe kopjimin e shkresave të ndryshme penale nëse ka gjasa reale se shikimi, kopjimi ose fotografimi mund të rrezikojë qëllimin e hetimit, jetën ose shëndetin e njerëzve. Në raste të tilla mbrojtësi mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake të lejojë shikimin, kopjimin ose fotokopjimin e dokumentacionit gjyqësor (neni 142 (3,4).

Kërkesë e personit të akuzuar parashtruar kryetarit të gjykatës për të shkarkuar avokatin e emëruar mbrojtës për mos kryerjen e detyrave të tij si duhet dhe për të emëruar një tjetër (neni 75 (4) KPPPK.

Propozim i mbrojtjes me të cilën kërkohet të shtyhet gjykimi me qëllim të përgatitjes së mbrojtjes, kërkimi i analizave mjeko-ligjore dhe prezentimi i dëshmimeve të reja përkrahëse; marrja adekuate në pyetje e dëshmitarëve & të pandehurit; për të dhënë vërejtje për dëshmitë e papranueshme; për të bërë vërejtje ndaj proceverbalit; për të kundërshtuar vendimin e kryetarit të kolegjit për refuzimin e lejimit të pyetjeve të caktuara;

Ankimi I posaçëm kundër vendimit të kolegjit mbi veçimin e shkresave, për shkak të papranueshmërisë së tyre.

Pala e dëmtuar dhe i pandehuri mund të ankohen kundër vendimit të prokurorit për marrjen e provave të caktuara, te gjyqtari në procedurë paraprake (neni 239 (2) KPPPK).

8. Shkelja e të drejtës për t'u gjykuar në prani të të tjerëve

(përfshirë gjykimin në mungesë)
Regullorja e UNMIK-ut 2001/1,
Nenet 14/3d MNDPC, 6 KEDNJ
Neni 12 (2) i KPPPK
Neni 472 i KPPPK

Ligji në fuqi:

E drejta e ankesës, neni 398 (1) i KPPPK
Neni 403 (1)(3) KPPPK:

“Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse: mbahet seanca kryesore pa personat prania e të cilëve kërkohet me ligj (...)”

Neni 415 (1)(2) I KPPPK

“Gjykata e shakllës së dytë e shqyrton pjesën e aktgjykimi i cili kundërshtohet me ankesë. Krahas kësaj, kur parashtrrohe ankesa, shqyrtimin e saj e bën gjykata sipas detyrës zyrtare (...).

2) nëse seanca kryesore është mbajtur në kundërshtim me dispozitat e këtij kodi, dhe zhvilluar pa praninë e të akuzuarit”.

Dëshmitë:

Shkresat e policisë dhe hetimeve, aktakuza, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të akuzuar, procesverbalit, aktgjykimi me shkrim.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Akesa. Lexo Kreun II, drejtësia penale, shkelja e të drejtës për avokat gjatë gjatë procedurës paraprake, C3 propozimi për rihapjen e procedurës penale i bërë nga i akuzuari ose avokati. Shqyrtohet nga i njëjti kolegji në shkallë të parë i cili e ka gjykuar rastin. Mund të ngritet edhe pasi personi i denuar ta ketë vuajtur dënimin (nenet 442 (4), 443(2) të KPPPK.

9. Shkelja e të drejtës për përkthyes dhe interpret pa pagesë

Reg. UNMIK 2000/46,
Neni 6/3a,e KEDNJ,
14/3f MNDPC, 40/2b(vi)
Konventës për të Drejtat

Ligji në fuqi:

Nuk ka dispozitë konkrete.

E drejta e ankesës, neni 398 (1) i KPPPK

Neni 403 (1)(3) KPPPK:

“Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse: (...)

e Fëmijës,
Neni 15 i KPPPK

3) (...) të akuzuarit (...) pa marrë parasyshë kërkesën e tij, I është mohuar e drejta për përdorimin e gjuhës amëtare gjatë gjykimit dhe të përcjellë rrjedhën e gjykimit në gjuhën amëtare (neni 15 I këtij kodi).

Dëshmitë:

Shkresat e policisë dhe hetimeve, aktakuza, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të akuzuar, procesverbal, aktgjykimi me shkrim.

10. Shkelja e parimit oftë sistemit të ndarë të drejtësisë për të mitur
(Nenet 454/2, 457, 458, 463, 487 KPPPK-së, 40/2b i Konventës për të Drejtat e Fëmijës, 14/4 MNDPC)

Përshkrimi i mjetit juridik:

- Propozimi i mbrojtjes në pritje të gjykimit apo rigjykimit. Lexo Kreun II, drejtësia penale, arrestimi i paligjshëm policor, A1

Nuk ka mjet të veçantë përveç ankesës kundër aktgjykimit. Lexo Kreun II, drejtësia penale, shkelja e të drejtës për avokat gjatë gjatë procedurës paraprake, C3

Bazë për rihapjen e procedurës penale. propozimi për rihapjen e procedurës penale i bërë nga i akuzuari ose avokati. Shqyrtohet nga i njëjti kolegji në shkallë të parë i cili e ka gjykuar rastin. Mund të ngritet edhe pasi personi i denuar ta ketë vuajtur dënimin (nenet 442 (4), 443(2) të KPPPK).

11. Shkelja e parimit për sistem të ndarë të drejtësisë për të mitur
Neni 40 (2) b i Konventës për mbrojtjen e fëmijës;
Neni 14 (4) i MNDPC
Neni 3 (1) dhe 4 i LPM

Liqi në fuqi:

Nuk ka dispozitë konkrete.
E drejta e ankesës, neni 398 (1) i KPPPK

Dëshmitë:

Shkresat e policisë dhe hetimeve, aktakuza, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të akuzuar, procesverbal, aktgjykimi me shkrim

Përshkrimi i mjetit juridik:

Propozimi i mbrojtjes, i bërë gojarisht ose me shkrim para trupit gjykues me prova të cilat e dokumentojnë moshën e të pandehurit. Lexo Kreun II, drejtësia penale, arrestimi i paligjshëm policor, A1

Nuk ka mjet të posaçëm juridik përveç ankesës së përgjithshme kundër aktgjykimit. Lexo Kreun II, drejtësia penale, shkelja e të drejtës për avokat gjatë gjatë procedurës paraprake, C3 dhe shkeljes së të drejtës së personit për t'u trajtuar njerëzisht dhe me respekt për dinjitetin e tij/saj, A9.

12. Shkelja e të drejtës për ankesë kundër aktgjykimit
Duke përfshirë këtu dështimin e gjyqit për të njoftuar palët për të drejtën për ankesë dhe dështimin për të dorëzuar kopjen e aktgjykimit të shkruar.
Neni 2 i Protokollit 7 KEDNJ, 14/5 MNDPC
Neni 394 (1) dhe 395 (4) i KPPPK-së.

Liqi në fuqi:

Nuk ka dispozitë konkrete.
E drejta e ankesës, neni 398 (1) i KPPPK

Neni 175 (1) i Kodit të Përkohshëm Penal thotë:

“Kushdo që me përdorimin e dhunës ose kanosjes serioze e pengon personin tjetër që të paraqesë ankesën ose për të shfrytëzuar çfarëdo mjeti tjetër juridik dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit”

Dëshmitë:

Procesverbal i seancës kryesore. Dyshimet për vepër penale si më lart.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Ankesa. Lexo Kreun II, drejtësia penale, shkelja e të drejtës për avokat gjatë gjatë procedurës paraprake, C3

Ankesa e përgjithme para policisë/prokurorisë. Lexo Kreun V, viktimat e krimit.

III. Policia e UNMIK-ut, SHPK-ja, TMK-ja dhe KFOR-i. Shkelja e kodit të mirësjelljes apo ligjit penal

A. Policia e UNMIK-ut

1. Policia e UNMIK-ut– Shkelja e kodit të mirësjelljes– mjetei administrativ

Përfshin sjelljen e pahijshme, thyerjet e politikave, rregulloreve apo procedurave.

Ligji në fuqi:

Doracakut i politikave dhe procedurave (DPP) pjesa 3, neni 2.2.1.

“Të gjitha shkeljet e pohuara të rregullave dhe rregulloreve duhet të dokumentohen në Raportin Preliminar (RP) nga eprori i drejtpërdrejt i policit përkatës.”

Vërejtje–Nuk ekzistojnë procedura eksplicite të cilat paralexohen për qytetarët të cilët parashtrojnë ankese duke u bazuar në shkeljet e kodit të mirësjelljes. Sidoqoftë, mundësia e hetimit të një ankese të tillë, është implicite në pjesët e caktuara të DPP-së siç është paraqitur në vazhdim, dhe në procedurat hetimore dhe disiplinore të cilat pasojnë pas dorëzimit të raportit preliminar.

Dëshmitë:

DPP pjesa 3, neni 2.2.2: “RP-ja do të përfshijë analiza në lidhje me çka, kur, ku dhe si ka ndodhur një incident, identitetin e anëtarit të stafit të përfshirë në atë rast dhe raportin për ankuesin, dëshmitarin apo viktimën.”

Përshkrimi i mjetit juridik:

Raporti preliminar duhet të përcjelljet nëpër zinxhirin komandues brenda 24 orëve Eprorit përkatës të policit të caktuar dhe Zyrtarit Rajonal për Hetime të Brendshme. Eprori përgjegjës duhet të njoftojë Zëvendësin e Komisionerit të Policisë për Administratë (ZKP/A) brenda 24 orëve pas shkeljes së pohuar.

Zyrtari Rajonal për Hetime të Brendshme do të kontaktojë mëpastaj Shefin e Njesisë për Hetime të Brendshme në Selinë e Misionit të Kombeve të Bashkuara dhe nën direktivat dhe kontrollin e tij/saj do të fillojë hetimet.

Pas përfundimit të hetimeve, shkresat e lëndës, përfshirë këtu edhe një përmbledhje me shkrim të rezultateve të hetimeve, do t'i dorëzohen ZPK/A. ZPK/A mëpastaj do të merr vendim përkitazi me masat e disiplinore të cilat duhet të ndërmerren.

Nëse konsiderohet si e domosdoshme, ZPK/A emëron Komitetin e Hetimeve i cili përbëhet nga kryesuesi, katër anëtarë të tjerë dhe një sekretar pa të drejtë vote. Komiteti në fjalë do të vie deri tek konkludimi përkatës duke u bazuar në vendimin e marrë me shumicë votash dhe do të ofrojë një raport me shtim mbi këto gjetje brenda 10 ditësh.

Në rast të shkeljes së bazuar, ZPK/A do të këshillojë Eprorin përgjegjës për masat disiplinore të cilat duhet të shqiptohen. Eprori përgjegjës do të implementojë mëpastaj atë vendim disiplinor.

Polici i akuzuar i UNMIK-ut mund të ankohet kundër vendimit për shqiptimin e masave disiplinore nga ZPK/A duke paraqitur ankese me shkrim Komisionerit të Policisë brenda 5 ditëve nga dita e pranimi të masës disiplinore. Pas shqyrtimit të rastit disiplinor, Komisioneri do të merr vendim i cili do të jetë plotëfuqishëm.

2. Policia e UNMIK-ut– Shkelja e kodit të mirësjelljes apo ligjit penal– mjetei juridik

Ligji në fuqi:

Ligjet e zbatueshme penale në Kosovë së bashku me Doracakun për Politika dhe Procedura pjesa 3 neni 2.10.

“Kjo politikë pranon që polici i UNMIK-ut mund të paraburgoset për qëllime të hetimeve nëse dyshohet se polici në fjalë ka kryer vepër penale (jo keqsjellje).

Duhet të kuptohet në mënyrë të qartë se imuniteti të cilin e gëzojnë policët e UNMIK-ut është i kufizuar në nivel organizativ dhe polici i Civpolit nuk është i mbrojtur nga arrestimi apo paraburgimi nëse ai/ajo ka kryer vepër penale.”

Dëshmitë:

Dosjet mjekësore në rast të abuzimit fizik, dëshmitarët

Përshkrimi i mjetit juridik:

Të gjitha hetimet penale mbi policët e UNMIK-ut do të kryhen nga Njësia Qëndrore për Hetime Penale (NjQHP) dhe i përcjellen prokurorit përkatës ndërkombëtar.

Nëse prokurori ndërkombëtar vendos që të mos iniciojë ndjekjen penale, Komisioneri I policisë apo personi i përcaktuar do të iniciojnë hetimet e brendshme.

Nëse prokurori ndërkombëtar vendos që të vazhdojë me ndjekjen penale, Komisioneri I Policisë apo personi I përcaktuar do t'i drejtohen NjQHP-së për të krijuar një Njësi të Hetimeve me qëllim të ofrimit të ndihmës për gjyqtarin hetues.

Megjithatë, gjatë marrjes së vendimit për të vazhduar me ndjekjen penale, prokurori ndërkombëtar paraqet menjëherë kërkesën për heqjen e imunitetit Këshilltarit Juridik të PSSP-së. Njësia e Hetimeve nuk do t'i qaset në mënyrë të drejtpërdrejt të dyshimit për marrje të deklaratës përderisa të mos kthehet vendimi për heqjen e imunitetit nga selia e KB-ve në Nju Jork.

B. Shërbimi Policor i Kosovës

KPS - Shkelja e kodit të mirësjelljes – mjeti administrativ –
Përfshin sjelljen e pahijshme, thyerjet e politikave, rregulloreve apo procedurave.

Ligji në fuqi:

Doracak i Politikave të SHPK-së P-1.30 (II):

“Veprimet disiplinore do të ndërmerren për të korigjuar sjelljen e pahijshme.”

Doracak i Politikave të SHPK-së P-4.16(III)(D)(3):

“Komandanti i policisë apo eprori i SHPK-së do të intervistojnë qytetarët për të përcaktuar nivelin e ankesës së tij/saj. Nëse ankesa paraqet keqkuptim ndërmjet të qytetarit dhe policit, komandanti i policisë dhe eprori i SHPK-së do t'i shpjegojnë qytetarit procedurat e policisë. Nëse qytetari është i kënaqur me shpjegim, përpilimi i raportit preliminar nuk është i nevojshëm.”

Doracak i Politikave të SHPK-së P-4.16(III)(D)(3a):

“Nëse qytetari ankohet për keqsjellje të policit, përdorim të panevojshëm apo pajustificuar të forcës fizike, shfrytëzimin e forcës vdekjepruese, shkeljet e të drejtave të njeriut, aktivitetin kriminal apo korrupsionin e policisë, komandantin e stacionit apo eprorin e SHPK-së i cili do të intervistojë qytetarin përkatës për të konstatuar faktet bazike në lidhje me rastin. Komandanti i stacionit apo eprori i SHPK-së do të plotësojnë Formularin për Ankim të Qytetarëve dhe do t'ja përcjell Njesisë Rajonale për Standarde Profesionale e cila gjendet në selitë rajonale.”

Dëshmitë:

Dosjet mjekësore në rast të abuzimit fizik, dëshmitarët.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Ekzistojnë dy mekanizma për raportimin e pohimeve për keqsjelljet që kryhen nga policët e SHPK-së: *raportet e brendshme të policisë dhe ankesat e qytetarëve*. Qëllimi i dy llojeve të formave raportuese është sigurimi i integritetit dhe sjelljes profesionale të Shërbimit Policor të Kosovës dhe të ofrojë një mekanizëm standard dhe uniform me qëllim të raportimit adekuat dhe hetimit të këtyre rasteve. Termi "pohim" nënkupton se ekzistojnë baza apo besim se një oficer mund të ketë shkelur ndonjë politikë, procedurë apo rregull apo rregullore të SHPK-së. Pohimet nuk janë dëshmi pozitive mbi keqsjelljen dhe zakonisht përdoren si bazë për veprim disiplinor derisa të kryhen hetimet në mënyrë të plotë nga një autoritet përkatës. Policët e SHPK-së supozohet se kanë vepruar në pajtim me detyrat e tyre përpos nëse faktet dhe dëshmitë përkrahëse nuk indikojnë ndryshe. Është detyrë dhe përgjegjësi e eprorëve të përcjellin sjelljet dhe aktivitetet e policëve të SHPK-së dhe të marrin veprime disiplinore sipas nevojës dhe nëse për këtë jipet urdhëri përkatës.

Komandanti i stacionit dhe Eprori i SHPK-së do të intervistojë qytetarin që të përcaktojë kontekstin e ankesës së tij/saj. Nëse ankesa paraqet një keqkuptim ndërmjet të qytetarit dhe policit, komandanti i policisë apo eprori i SHPK-së do t'ja shpjegojnë qytetarit procedurat në bazë të të cilave vepron policia. Nëse qytetari është i kënaqur me shpjegim, përpilimi i raportit preliminar nuk është i domosdoshëm.

Nëse qytetari ankohet për një keqsjellje të policisë, përdorim të forcës fizike të panevojshme dhe të paarsyetuar, përdorim të forcës vdekjepruese, shkeljen e të drejtave të njeriut, aktivitetin kriminal, apo korrupsionin policor, komandanti i stacionit apo eprori i SHPK-së do të intervistojë qytetarin për të konstatuar faktet bazike të ankesës. Komandanti i stacionit apo eprori i SHPK-së do të kompletojnë "Formularin për Ankim të Qytetarëve" dhe t'ja përcjell Njesisë Rajonale për Standarde Profesionale e cila gjendet në selinë e policisë rajonale. Formulari për Ankim i Qytetarëve do të jetë një metodë kryesore e cila do të zbatohet për parashtrimin e ankesave kundër policëve të SHPK-së.

Memorandumet, letrat me shkrim, e-mail, apo thirrjet telefonike janë të diskutuar dhe zakonisht nuk duhet të përdoren për iniciimin e ankesave kundër policëve të SHPK-së.

Pas vendimit për të kryer hetimet për dyshimet për keqsjellje të mundshme, qoftë në nivel të komandimit lokal, apo nga Njësia për Standarde Profesionale, Autoriteti Përgjegjës (lexo P-130 III, Zëvendësi i Komisionerit të Policisë për Operacione dhe/apo Komandanti i SHPK-së, komandanti përkatës rajonal apo i caktuari i tij mund të këshillojnë policin e akuzuar, me shkrim, për faktin se ai/ajo është objekt i hetimeve dhe përfshijnë deklaratën e pohimeve të bëra kundër atij polici, përderisa në rastet të cilat kërkojnë hetime atypëraty, atëherë njoftimi i policit nuk do të bëhet fare. Pas përfundimit të hetimeve penale, Autoriteti Përgjegjës do të ketë 72 orë kohë për të ofruar këshillat e nevojshme.

Ligji në fuqi:

1. KPS - Shkelja e kodit të mirësjelljes dhe/apo ligjit penal – mjete juridik

Ligjet penale të zbatueshme në Kosovë në lidhje me: Doracakun e Politikave të SHPK-së, nenet P-1.35

Doracaku i Politikave të SHPK-së nenet P-4.16(III)(B)(3)

“a. Hetimet nga NJSP-ja do të inicohen kur të kenë përfunduar hetimet penale kundër policit të SHPK-së dhe kur nuk është caktuar kurrfarë ndjekje penale kundër tij. Në situatat kur autoriteti publik mund të kërkojë ndjekje penale, Shefi i Njesisë për Standarde Profesionale, mund të urdhërojë apo jap udhëzime për ndaljen e hetimeve të NJSP-së derisa të mos zgjedhet rasti penal.”

Nenet e Doracakut të Politikave të SHPK-së dhe (III)(D)(3).

Lexo mëlartë dhe (3) b: “Të gjitha ankesat për keqsjellje të rënda të policisë, përdorimi i forcës së panevojshme dhe të paarsyetuar fizike, përdorimi i forcës vdekjepruese, shkeljet e të drejtave të njeriut, aktiviteti kriminal apo korrupcioni i policisë duhet t'i referohet menjëherë njësisë rajonale të NJSP-së. Hetuesi i NJSP-së do të kontaktojë zyrën qendrore të NJSP-së ... për pranimin e ankesave të qytetarëve dhe iniciimin e procesit të hetimeve.”

Dëshmitë:

Dosjet mjekësore në rast të abuzimit fizik, dëshmitarët

Përshkrimi i mjetit juridik:

Lexo mëlartë mbi mjetin administrativ të SHPK-së. Të gjitha ankesat për keqsjellje të rënda të policisë, përdorimi i forcës së panevojshme dhe të paarsyetuar fizike, përdorimi i forcës vdekjepruese, shkeljet e të drejtave të njeriut, aktiviteti kriminal apo korrupcioni i policisë duhet t'i referohet menjëherë njësisë rajonale të NJSP-së. Hetuesi i NJSP-së do të kontaktojë mëpastaj zyrën qendrore të NJSP-së nëpërmjet të faksit, e-mailit, telefonit për pranimin e ankesës së qytetarit dhe iniciimin e procesit të hetimeve.

C. Trupat e Mbrojtjes së Kosovës

Ligji në fuqi:

Kodi Disiplinor i Trupave të Mbrojtjes së Kosovës neni 5.3

1. Trupat e Mbrojtjes së Kosovës (TMK) – Shkelja e kodit të mirësjelljes– mjete administrativ

Çdo pjesëtar i publikut apo i ndonjë agjencie tjetër, përfshirë këtu edhe TMK-në, mund të parashtojë ankesa për cilindo pjesëtar të TMK-së. Ankesat do të ofrojnë informata të përshkruara në Shtojcën B, dhe raporti i tyre mund t'i dorëzohet qoftë shtabit të përgjithshëm të TMK-së, policisë së UNMIK-ut, oficerëve të policisë rajonale të UNMIK-ut, Komitetit të Përbashkët Implementues të Brigadës Shumëkombëshe apo edhe Komitetit të Përbashkët Implementues të Komandës së KFOR-it.

Vërejtje: Nuk ekziston ndonjë dispozitë me të cilën paralexoet që parashtruesi i ankesës të njoftohet për rezultatet e hetimeve të brendshme.

Dëshmitë:

Parashtruesi i ankesës duhet të plotësojë formularin standard për ankesa duke dhënë emrat e pjesëtarëve të TMK-së të përfshirë në atë rast, informtatat identifikuese për ata

pjesëtar dhe përshkrimin e incidentit, përfshirë këtu edhe datën, kohën dhe vendin. Është opsionale për parashtruesin e ankesës që të jap edhe emrin e tij/saj dhe informatat kontaktuese të tij/saj.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Ankesat mund t'i dorëzohen shtabit të përgjithshëm të TMK-së, policisë së UNMIK-ut, KPI të BSHK-ve apo KPI i Komandës së KFOR-it.

Për shkelje të lehta të kodit të mirësjelljes të TMK-së, komandanti i Grupit të Punës Rajonal apo komandanti i TMK-së do të urdhërojnë fillimin e hetimeve kundër ndonjë pjesëtari të TMK-së. Komandantët e TMK-së deri në GPR/Njësitë Qëndrore mund të merren me vepra të cilat konsiderohen si të lehta për nga natyra. KPI i BSHK-ve dhe ai i komandës së KFOR-it do të njoftohen gjithashtu për këto shkelje.

Për vepra të rënda të mospërbushjes së obligimeve, komandanti i TMK-së do t'ja përcjell ankesën KPI të KFOR-it. Nga komandanti i TMK-së mund të kërkohet, nën direktivat e Komitetit të Përbashkët Ekzekutiv të Sigurisë për të suspenduar pjesëtarin përkatës të TMK-së.

KPI-të e BSHK-ve do të përcjellin menjëherë raportet mbi incidentet e shkaktuara KPI-së së komandës së KFOR-it. Çdo BSHK është përgjegjëse për koordinimin e hetimeve në lidhje me veprat e rënda të mospërbushjes së detyrimeve të punës në kuadër të fushës së tyre të përgjegjësisë. KPI i komandës së KFOR-it do t'i ofrojë JSEC-ut rekomandime mbi veprimet që duhet ndërmarrë kundër pjesëtarit përkatës të TMK-së dhe ketimet të cilat duhet zhvilluar. Ky rekomandim do të përpilohet së bashku me zyrtarët e UNMIK-ut të cilët janë përgjegjës për çështjet që kanë të bëjnë me TMK-në.

Vetëm JSEC mund të merr vendime përkritazi me veprimet disiplinore për veprat e rënda të mospërbushjes së detyrimeve nga ndonjë pjesëtar i TMK-së.

BSHK-të do t'i përcjellin detajet për çfarëdo akti i cili përbën vepër të rëndë qoftë penale ashtu edhe civile, policisë së UNMIK-ut.

Masat disiplinore duhet të ndërmerren kur gjykata e jurisdikcionit kompetent e shpall fajtor një pjesëtar të TMK-së për një vepër të caktuar penale. Krahas sanksioneve të shqiptuara nga gjykata, JSEC do të ndërmerr masa disiplinore për këto vepra penale. As komandanti i TMK-së e as komandantët e zonave nuk janë të autorizuar të ndëmarrin masa disiplinore sa l përket veprave penale të kryera nga pjesëtarë të TMK-së.

2. Trupat Mbrojtëse të Kosovës – Shkelja e kodit/dhe ose/ligjit penal – mjet juridik

Ligji në fuqi:

Ligjet penale të zbatueshme në Kosovë së bashku me kodin Disiplinor të TMK-së neni 5.4:

“Një ankesë e cila pohon se një pjesëtar i TMK-së ka kryer vepër penale do t'i përcillet nga komandanti i TMK-së policisë së UNMIK-ut për hetime...”

Kur një pjesëtar i TMK-së dyshohet të ketë kryer vepër penale apo një vepër të rëndë të mospërbushjes së detyrimeve, nga komandanti i TMK-së do të kërkohet që, nën udhëzimet e JSEC të suspendojë atë pjesëtar të TMK-së menjëherë. Inspektorati i TMK-së nuk do të ndërmerr hetime vetanake, mirëpo do t'ja përcjell ankesën në fjalë policisë së UNMIK-ut.”

Dëshmitë:

Dosjet mjekësore në rast të abuzimit fizik, dëshmitarët

Përshkrimi i mjetit juridik:

Çdo pjesëtar i publikut apo i ndonjë agjencie tjetër, përfshirë këtu edhe TMK-në, mund të parashtrorë ankesa për cilindo pjesëtar të TMK-së. Ankesat mund t'i dorëzohen shtabit të përgjithshëm të TMK-së, policisë së UNMIK-ut, oficerëve të policisë rajonale të UNMIK-ut, Komitetit të Përbashkët Implementues të Brigadës Shumëkombëshe apo edhe Komitetit të Përbashkët Implementues të Komandës së KFOR-it.

Pohimet në lidhje me veprat penale të kryera nga pjesëtarë të TMK-së do t'i përcillen komandantit të TMK-së policisë së UNMIK-ut për hetime në pajtim me procedurat e rëndomta policore.

Policia e UNMIK-ut do të njoftojë KPI-të përkatëse të BSHK-ve dhe KPI-në e komandës

së KFOR-it përkitazi me arrestimin e një pjesëtari të TMK-së dhe do të referojë nga një vendimeve gjyqësore, përfshirë këtu edhe vendimin për lirim, KPI-së së komandës së KFOR-it.

Procedurat e rëndomta penale zbatohen vetëm kur një pjesëtar i TMK-së dyshohet apo akuzohet për kryerjen e një vepre penale.

D. KFOR-i

1. KFOR-i – Shkelja e Kodit penal ushtarak të shtetit përkatës– mjetei administrativ dhe ai juridik

Ligji në fuqi:

KFOR-i gëzon imunitet ndaj ndjekjes penale vendëse në bazë të Reg. UNMIK 2000/47 mbi statusin, privilegjet, dhe imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe personelit të tyre Kosovë.

2.4 Personel i KFOR-it ... është i liruar nga jurisdiksioni para gjykatave në Kosovë në lidhje me çfarëdo veprimi administrativ, civil apo kriminal të kryer nga ata në territorin e Kosovës. Personeli i tillë do t'i nënshtrohet jurisdiksionit ekskluziv të shteteve të tyre përkatëse prej të cilave dërgohen, dhe i liruar nga çfarëdo formë e arrestit apo e paraburgimit, përveç nga personat të cilët vepronë në emër të shteteve të tyre përkatëse të cilat i dërgojnë. Nëse gabimisht arrestohen, ata menjëherë duhet t'i dorëzohen autoriteteve të KFOR-it.

Vërejtje: Gabimet e vogla disiplinore (uniforma e rrudhosur, etj.) zgjidhen në vetë bazën e KFOR-it nga oficeri komandues. (Nuk është e zbatueshme për civilët që punojnë pranë KFOR-it).

Dëshmitë:

N/A

Përshkrimi i mjetit juridik:

Nuk ekziston asnjë informatë zyrtare mbi këtë proces. Një numër I shembujve praktikë janë të njohur mirëpo nuk japin indikacione të qarta se çfarë veprime duhet ndërmarrur nën rrethana të tilla. Shembujt e tillë janë të paraqitur si në vazhdim:

Një ushtar i KFOR-it hyn në një dyqan në Malishevë dhe vjedh disa çokollara. Pronari i dyqanit nuk kishte mjet përmirësues në dispozicion dhe ndaj ushtarit në fjalë nuk janë marrë kurrfarë masash disiplinore.

Një oficer i KFOR-it e thyen një dyqan që shesin rroba për nuse dhe e vesh fustanin e nusërisë përderisa është në gjendje të dehur. Pronari i dyqanit nuk kishte mjet përmirësues në dispozicion dhe ndaj oficerit në fjalë nuk janë marrë kurrfarë masash disiplinore.

Një ushtar i KFOR-it e dhunon dhe e vret një vajzë 12 vjeçare. Ushtari dërgohet në Gjermani për gjykim ushtarak, ku shpallet fajtor dhe dënohet me 15 vjet burg.

Një ushtar i KFOR-it bën ndeshje me xhipin e tij të KFOR-it me një veturë civile përderisa është i dehur. Personi civil kompenzohet për dëmin i cili është shkaktuar. Ushtarit i merret grada ushtarake, mirëpo nuk i nënshtrohet procedurave gjyqësore në gjyqin ushtarak.

2. KFOR-i – Kërkesat/paditë për kompenzim.

Kërkesat për vdekje, lëndim personal dhe dëmtim, shkatërrim apo ekspropriim të pronës së paluajtshme dhe asaj të luajtshme

Ligji në fuqi:

KFOR-i gëzon imunitet ndaj ndjekjes penale vendëse në bazë të Reg. UNMIK 2000/47. Sidoqoftë, neni 7 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 thotë: "Kërkesat e palës së tretë për humbjen apo dëmtimin dhe për lëndimet personale, sëmundjen apo vdekjen, e cila shkaktohet ose drejtëpërdrejtë i atribuohet KFOR-it, UNMIK-ut apo personelit të tyre përkatës dhe që nuk shkaktohen nga "domosdoshmëritë operacionale" të asnjërës prej pranive ndërkombëtare, zgjidhen nga Komisioni i Kërkesave i themeluar nga KFOR-i dhe UNMIK-u, në mënyrën e cila do të rregullohet"

KOMKFOR-i ka nxjerrur një draft të politikave për kërkesat që parashtrihen kundër KFOR-it në Kosovë (PKK). PKK-ja ka karakter obligativ vetëm për trupat e KFOR-it të cilat shërbejnë në kuadër të selisë së komandës së KFOR-it.

Në bazë të nenit 6, çdo shtet kontribues me trupa është përgjegjës të shqyrtojë kërkesat të cilat parashtrihen kundër aktivitetëve të trupave të saj, në pajtim me rregullat e tyre të kërkesave, rregulloreve dhe procedurave." Shtojca B e PKK-së përmban procesin këshilldhënës të cilit duhet t'i përmbahen ShKT-të.

E drejta për ankesë:

Neni 7 i PKK-së parasheh krijimin e Komisionit për Ankesa dhe Parashtrësia të Kosovës i cili "është një sistem vullnetar për parashtrimin e ankesave, vendimet e të cilit nuk janë obligative dhe të gjitha ato ShKT të cilat dëshirojnë të marrin pjesë në këtë sistem mund ta bëjnë këtë". Shtojca C elaboron mbi pushtetin e KAPK-së. "Nëse parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me vendimin e oficerit për kërkesa pranë selisë së komandës së KFOR-it, ai mund të ankohet pranë KAPK-së nëse ka të drejtë për ankesë". Nuk është e qartë se nën çfarë rrethana parashtruesi i kërkesës nuk do të ketë të drejtë për ankesë. Me qëllim të ndryshimit të vendimit të ShKT-së apo komandës së KFOR-it tre zyrtarë të KAPK-së duhet të bëjnë vendim unanim. Së fundi, "vendimi i KAPK-së duhet të ketë karakter bindës mirëpo nuk mundet të jetë i formës së prerë, për shkak se nuk kemi një politikë të aprovuar për kërkesat në Kosovë – e cila gjithashtu është e aprovuar nga qeveria e ShKT-së apo NATO SHAPE. Pa aprovimin e një politike të tillë nga ana e qeverive të ShKT-së, vendimet e KAPK-së nuk do të kenë karakter obligativ për ShKT-të apo komandën e KFOR-it.

Dëshmitë:

Oficeri për kërkesa do të punojë me parashtruesin e kërkesave për të siguruar që të gjitha informatat e nevojshme janë pranuar. (Shtojca A neni 4)

Raporti i policisë

Dy vlerësime mbi riparim/rregullimin e dëmit

Dëshmia mbi pronësinë

Kopja e dokumentacionit të sigurimit

Fotografitë/diagramet e dëmit të shkaktuar

Deklaratat e dëshmitarëve

Dosjet mjekësore, faturat/llogaritë

Shënimet kadastrale për tokat të cilat dëshmojnë pronësinë mbi tokën

Dëshmi mbi shfrytëzimin e tokës nga KFOR-i

Çdo dokument do të përkthehet në gjuhën angleze dhe gjuha e zyrës për kërkesa do të jetë gjuha angleze.

.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Kur të pranohet ankesa, asistenti i zyrës për ankesa do të regjistrojë kërkesën në bazën e shënimeve të cilës i jipet edhe numri gjegjës.

Zyra për Kërkesa e KFOR-it (ZKK) është përgjegjëse për hetimin dhe shqyrtimin e të gjitha kërkesave të parashtruara kundër komandës së KFOR-it. Kur oficeri për kërkesa të ketë mbledhur të gjitha informatat e nevojshme, Oficeri për kërkesa shqyrton kërkesat për të përcaktuar se a është në pajtim me kërkesat e parapara me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/47 neni 7 (në fakt për të përcaktuar juridikcionin e lëndës).

"Për të vërtetuar kërkesën, parashtruesi i kërkesës duhet të vërtetojë baraspeshën e probabilitetit (51%), për secilin element të kërkesës, se a ka pasur për detyrë KFOR-i të përkujdeset, a kemi të bëjmë me shkelje të kësaj detyre, a ka ndodhur dëmtimi, dhe si rezultat i çfarë veprimeve apo mosveprimeve është shkaktuar dëmi përkatës. Nëse veprimi apo mosveprimi është shkaktuar nga "domosdoshmëria operationale", komanda e KFOR-it lirohet nga përgjegjësia." (Shtojca A neni 5)

Nëse oficeri për kërkesa përcakton se personeli i komandës së KFOR-it është i përfshirë në këtë dëm (gabim), oficeri për kërkesa do t'i rekomandojë J8-shës (sektorit për ekonomi dhe financa) të paguajë kërkesën. (Shtojca A neni 6).

Oficeri për kërkesa do të punojë me profesionistët ligjor vendës për të qartësuar çfarëdo udhëzimesh apo kufizimesh vendore që kanë të bëjnë me shqyrtimin e ankesave. (Shtojca A neni 7)

Nëse parashtruesi i kërkesës pajtohet me shumën përkatëse, atëherë ai nënshkruan një dokument të marrëveshjes në mënyrë të plotë, që i mundëson OK-së të sigurojë J8-shës ta paguajë dëmtshpërblimin. (Shtojca A neni 8). Nëse parashtruesi i kërkesës e refuzon ofertën, ankohet pranë KAPK-së dhe humb kontestin, atëherë oferta e OK-së revokohet. Nëse vendimi i KAPK-së nuk refuzon në mënyrë unanime ankesën, oferta për arritjen e marrëveshjes mbetet e hapur. (Shtojca C neni 12).

Nëse kërkesa refuzohet, fletërefuzimi duhet të theksojë bazat ligjore për refuzim të

kërkesës në fjalë. (Shtojca A neni 9)

Ankesat

Lexo ligjin e zbatueshëm – E drejta për ankesë.

KAPK-ja përbëhet nga tre oficerë gjyqësorë, një nga ShKT-ja e cila është objekt i ankesës dhe dy këshilltarë juridik të komandës së KFOR-it apo nga ndonjë person i deleguar nga OK-ja. (Shtojca C neni 1).

Të gjitha palët do të njoftohen 30 ditë para dëgjimit të ankesës. Të gjitha palët mund të paraqesin prova shtesë deri në dhjetë ditë para mbajtjes së dëgjimit. Parashtruesi i kërkesës dhe ShKT-ja apo komanda e KFOR-it të gjithë kanë nga 15 minuta të paraqesin provat dhe argumentet e tyre ligjore. KAPK-ja ka 30 minuta kohë për t'i marrë në pyetje të dyja palët dhe vendimi me shkrim i kumtohet palëve brenda 15 ditëve. (Shtojca C neni 3-8).

Nëse KAPK-ja udhëzon kryerjen e pagesës, ajo duhet të bëhet brenda 30 ditëve. (Shtojca C neni 13).

IV. Mosdiskriminimi

A. Mjetet e përgjithshme I.

Parimi i mosdiskriminimit
Neni 13 i KEDNJ
Neni 26 i MNDCP

Ligji në fuqi:

Neni 35, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave
Udhëzimet e rëndësishme të komunave
Kreu 9, neni 4, paragrafi 9.4.2, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë.
Ligji mbi procedurën administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 47/86)
Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 4/77)
Neni 31, Ligji mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78)

Dëshmitë:

Dëshminë se kërkesa i është parashtruar autoritetit përkatës, siç është letra e kërkesës dhe refuzimit nga organi i caktuar administrativ. Standardet mbi dëshmitë të parapara me nenet 159-201, Ligji mbi procedurën administrative.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45 dhe ligji i zbatueshëm parasheh këto mjete juridike:

- a. Ankesat i dorëzohen me shkrim kryeshefit ekzekutiv, ose personalisht zyrës së kryeshefit ekzekutiv, brenda afatit prej një muaji pasi paraqitësi i ankesës të ketë mësuar për vendimin për refuzim. Komunitat mund të kenë gjithashtu procedura të posaçme; barra bie mbi parashtruesin e kërkesës për të bërë hetimet. Nga kryeshefi ekzekutiv kërkohet të jap përgjegjen e tij ndaj kësaj kërkesë brenda një muaji (neni 35(1-2), Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45).
- b. Nëse nuk është i kënaqur me përgjegjen e kryeshefit ekzekutiv, parashtruesi i ankesës mund t'i drejtohet Pushtetit Qendror, i cili e shqyrton ankesën dhe vendos për ligjshmërinë e atij vendimi (neni 35(3)). Për momentin, të gjitha këto ankesa mund të parashtrohen në dhe të koordinohen nga Drejtorati për Çështje Administrative, i cili duhet përcjellë ankesën tek "pushteti qendror përkatës" për çështje substanciale. Për momentin është e paqartë kush paraqet pushtet qendror. Pushteti Qendror duhet të marrë vendim brenda një muaji ditësh nga koha e pranimit të ankesës në lidhje me vendimin (neni 35(4), Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45).
- c. Ankesa kundër vendimit të shkallës së dytë mund të bëhet në gjykatën supreme (Neni 31, Ligji mbi Gjykatat e rregullta). Afati kohor për iniciimin e padisë administrative është 30 ditë nga e dorëzimit të aktit administrativ apo 60 ditë nga dorëzimi i aktit administrativ mirëpo nëse pala nuk e ka pranuar atë akt (Neni 23, Ligji mbi konfliktet administrative).
- d. Një ankesë apo kërkesë shtesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm të aktvendimit mund të parashtrohet kundër aktvendimit me padi administrative (Neni 19-20, 45-50,

Ligji mbi Konfliktet administrative), ose duhet t'i dorëzohet gjykatës kompetente brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të vendimit i cili kundërshtohet (Neni 46, Ligji mbi Konfliktet administrative)

Lexo kapitullin VI, Çështjet pronëso-ro-juridik, pjesa B.2, mohimi I padrejt I qasjes në informatat kadastrale, për përshkrim të shfrytëzimit tjetër të këtij mjeti përmirësues.

Koment: Nëse parashtruesi i kërkesës ka shterrur të gjitha procedurat e brendshme ankimore (p.sh ankesa që i parashtrohet Kryeshefit Ekzekutiv), atëherë rasti mund t'i referohet autoritetit qëndror: p.sh varet se a kemi të bëjmë me departamente të UNMIK-ut apo ministri të IPVQ-ve.

B. Mjetet e përgjithshme II

II. Ligji në fuqi:

Neni 23, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave
Udhëzimet e rëndësishme të komunave
Kreu 9, neni 4, paragrafi 9.4.2, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë.
Ligji mbi procedurën administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 47/86)
Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 4/77)
Neni 31, Ligji mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78)
Udhëzimi administrativ 2003/002, i lëshuar nga Zyra e ZPSSP-së për administratë civile

Dëshmitë:

Dëshminë se kërkesa i është parashtruar autoritetit përkatës, siç është letra e kërkesës dhe refuzimit nga organi i caktuar administrativ. Standardet mbi dëshmitë të parapara me nenet 159-201, Ligji mbi procedurën administrative.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Nëse Komitetit për komunitete konsideron se është vepruar, ose është propozuar veprimi nga ose në emër të Kuvendit Komunal, i cili veprim ka shkelur ose mund të shkelë të drejtat e komunitetit ose pjesëtarit të komunitetit ose i cili veprim mund të paragjykojë interesat e komunitetit, menjëherë çështjen do t'ia bartë Komitetit për ndërmjetësim (neni 23 i Rregullores 2000/45).

Komiteti për ndërmjetësim duhet t'i shqyrtojë të gjitha çështjet e ngritura nga Komiteti për komunitete. Duhet të zhvillojë hetimet e nevojshme për të konstatuar nëse të drejtat e komuniteteve ose pjesëtarëve të tyre janë shkelur ose mund të shkelen, ose nëse është ndërmarrë ose propozuar veprimi i cili i paragjykon ose mund të paragjykojë interesat e komuniteteve. Çështjen do ta zgjidhë përmes ndërmjetësimit. Komiteti i ndërmjetësimit brenda 28 ditëve e dorëzon raportin për secilin këshilltarë të Kuvendit Komunal, me rekomandimet për atë se si ky komitet mendon se duhet zgjidhur çështja (neni 23. 7 i Rregullores 2000/45).

Kuvendi Komunal e shqyrton secilin raport që i dorëzohet nga Komiteti për ndërmjetësim dhe vendosë për veprimet, që duhet ndërmarrë në raport me çështjen (neni 23.8 i Rregullores 2000/45).

Nëse Kuvendi Komunal nuk ndërmerr asnjë veprim brenda 21 ditësh prej dorëzimit të raportit nga Komiteti për ndërmjetësim apo nëse Komiteti për komunitete nuk është i kënaqur me vendimin e marrë nga Kuvendi Komunal, çështjen ia bartë autoriteteve qëndrore për rishikim. Nuk është e qartë se çka paraqet autoritet qëndror (neni 23.9 i Rregullores 2000/45).

Në rastet e pushimeve nga puna, individët e prekur mund t'i bëjnë ankesë me shkrim Komitetit për komunitete, duke vënë arsyet për shkarkim, brenda një jave nga vendimi i dhënë. (neni 5.7 i UA 2003/002) Nuk është dhënë afati për përgjigje ndaj ankesë, por nëse ankuesi nuk është i kënaqur përgjigjën e Komitetit, ai/ajo mund të t'ia kalojë çështjen zëvendësit të PSSP-së për administratë civile i cili e shqyrton ankesën dhe i rekomandon PSSP-së masat për t'i shqyrtuar.

Vërejtje: Skema e paraqitur më lart, është një përzierje e mekanizmave politikë dhe mjeteve juridike. Duket se së paku në disa raste kjo mund të përdoret si mjet juridik për shkeljet e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve të pakicave.

C. Ligji kundër diskriminimit

Ligji në fuqi:

Ligji kundër diskriminimit (LKD)

"Shënim: LKD është shpallur me 20 gusht 2004."

Dëshmitë:

Dëshmitë për diskriminim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (përfshirë rastet e ngacmimit, viktimizimit dhe segregimit) të bazuar në gjini, seks, moshë, gjendje martesore, gjuhë, paaftësi fizike ose mentale, orientim seksual, anim ose bindje politike, prejardhje etnike, kombësie ose përkatësie fetare, racë, pozitë sociale, pasuri, lindje ose ndonjë pozitë tjetër.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Sipas LKD, personi i cili pohon se ka qenë i diskriminuar drejtpërdrejtë ose tërthorazi, mund të ngrisë padi kundër diskriminimit pranë organeve administrative dhe gjyqësore kompetente, dhe të cilat kanë kompetencë për çështjet konkrete të paraqitura në padi. Lexo Kreun IV, mos diskriminimi, A, mjeti i përgjithshëm juridik, përshkrimi i mjetit juridik.

Nëse paditësi nuk është i kënaqur me vendimin ose mos marrjen e vendimit në procedurë administrative, i njëjti mund ta ngritë çështjen pranë gjykatës kompetente sipas ligjit në fuqi (neni 7.3 i LKD)

Barra e të provuarit në rastet e diskriminimit bie në të paditurin i cili duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit për trajtim të barabartë. Mirëpo, paditëse edhe më tej ka të drejtë t'i paraqesë provat për mbështetjen e padisë së tij për rastin e diskriminimit (neni 8.1-8.2 i LKD).

Paditësi mund të shfrytëzojë edhe procedurën e ndërmjetësimit dhe pajtimin pa paragjykuar të drejtën e tij të ankesës pranë organeve përkatëse administrative ose gjykatës kompetente në çdo kohë. Më tej, me pajtimin paditësit ose të paditurit, shoqatat, organizatat ose subjektet tjera juridike mund të përkrahin shfrytëzimin e procedurës administrative ose gjyqësore duke vepruar në emër të tyre (neni 7.4-7.6 i LKD)

D. Kërkesat/ankesat për praktikat diskriminuuese në punësimin publik

Përfshin kërkesat për diskriminim në praktikat e punësimit të zbatuara si në nivel qendror ashtu edhe atë komunal të cilat janë parashtruar nga punëtorët e organeve qendrore dhe komunale kundër zyrtarëve të këtyre organeve në fjalë.

Parimet udhëheqëse të shërbimit civil të parapara me REG/UNMIK/2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë, neni 2(1)(g).

I. Ligji në fuqi:

Neni 11(1), Rregullorja e UNMIK-ut 2001/36,

"Nëpunësi civil i cili është dëmtuar me një vendim të organit të punësimit, duke i shkelur parimet e parashtruara në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje, mund t'i ankohet Këshillit për një vendim të tillë në pajtim me dispozitat e këtij neni. Çdo apelim i tillë duhet të shqyrtohet nga një juri prej tre anëtarësh të Këshillit, të cilët në emër të Këshillit e shqyrtojnë ankesën që u është drejtuar atyre.

* Këshilli i pavarur mbikëqyrës për Kosovë.

Ligji mbi Procedurën Administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 47/86)

Udhëzimet komunale në fuqi

Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 4/77)

Neni 31, Ligji mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78)

Dëshmitë:

Dëshmi mbi kërkesën e parashtruar organit përkatës i cili nuk i'u është përmbajtur detyrimeve të veta, siç është fletëkërkesa apo refuzimi nga ana e organit administrativ. Standardet mbi dëshmitë siç paralexoen nga nenet 159-201, Ligji mbi procedurën administrative.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë mjetet juridike nëpërmjet të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe pastaj nëpërmjet gjykatave.

Këshilli i shqyrton dhe merr vendim për ankesat kundër vendimeve të organit të punësimit. Para apelimit në Këshill, nëpunësi i dëmtuar civil apo kandidati duhet t'i ketë shterrur procedurat e brendshme të apelimit të organit përkatës të punësimit, përveç nëse Këshilli e arsyeton këtë kusht për shkak të frikës së arsyeshme të hakmarrjes, dështimit të organit të punësimit për të zgjidhur ankesën e tillë interne brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, ose për ndonjë shkak tjetër të arsyeshëm (neni 11 (2) I Rreg. të UNMIK-ut 2001/36).

Vërjetje: Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, që emërohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në konsultim me Kryeministrin. Anëtarët e Këshillit zgjedhen në bazë të aftësisë, ndershmërisë dhe përkushtimit të tyre për të krijuar një shërbim civil politikisht të panashëm në Kosovë, që bazohet në merita dhe që pasqyrohet karakterin shumetnik të Kosovës. Për këtë qëllim, së paku tre (3) anëtarë të tij emërohen nga komuniteti shqiptar i Kosovës dhe së paku dy (2) anëtarë nga komunitetet joshqiptare në Kosovë (Kapitulli III, nenet 8.1 dhe 8.2).

Struktura e KPMK-së nuk është implementuar ende nga ana e Ministrisë së Shërbimeve Publike siç parashihet me nenin 9 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/36. (që nga maji 2004, vetëm dy anëtarë kosovarë dhe një ndërkombëtarë janë emëruar. Edhe katër anëtarë tjerë kosovarë kanë mbetur të emërohen në pajtim me nenin 8 të kësaj rregulloreje.

Përderisa të mos themelohet KPMK-ja, apo pasi të themelohet dhe pasi të shterren të gjitha mjetet juridike që burojnë nga ky këshill, kërkesa për diskriminim mund të parashtrohet pranë gjykatës supreme (Lexo Kreun IV, mos diskriminimi A I, Mjeti i përgjithshëm juridik, përkushtimi i mjetit juridik c)).

Një ankesë apo kërkesë shtesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm të aktvendimit mund të parashtrohet kundër aktvendimit në procedurë administrative (Lexo Kreun IV, mos diskriminimi A I, Mjeti i përgjithshëm juridik, përkushtimi i mjetit juridik d)

E. Kërkesat/ankesat për praktikat diskriminuuese në punësimin publik sipas LKD

II. Ligji në fuqi:

Neni 2 (b) i LKD

Dëshmitë:

Dëshmitë për diskriminim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (përfshirë rastet e ngacmimit, viktimizimit dhe segregimit) të bazuar në gjini, seks, moshë, gjendje martesore, gjuhë, paaftësi fizike ose mentale, orientim seksual, anim ose bindje politike, prejardhje etnike, kombësie ose përkatësi fetare, racë, pozitë sociale, pasuri, lindje ose ndonjë pozitë tjetër, në lidhje me punësimin në kuadër të të gjitha organeve publike dhe të secilit nivel.

Përkushtimi i mjetit juridik:

Sipas LKD, personi i cili pohon se ka qenë i diskriminuar drejtpërdrejtë ose tërthorazi, mund të ngrisë padi kundër diskriminimit panë organeve administrative dhe gjyqësore kompetente, dhe të cilat kanë kompetencë për çështjet konkrete të paraqitura në padi. Padia mund të bëhet lidhur me kushtet për qasjen në punësim, vetëpunësim dhe zanatë, kushtet e punës, qasjes në të gjitha llojet e udhëzimeve mbi kualifikimet në punë, trajnimet për zanatë dhe ritrajnimet (neni 4 (a), (b) dhe (c) i LKD.

Për hollësi tjera lexo Kreun IV, mos diskriminimi, A, mjeti i përgjithshëm juridik, përkushtimi i mjetit juridik.

F. Kërkesat/ankesat kundër praktikave diskriminuuese të punësimin në nivel komunal.

Ligji në fuqi:

Neni 35, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave Udhëzimet përkatëse komunale

Neni 23, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave Udhëzimet përkatëse komunale

Të parashtruara nga personat të cilët kërkojnë punësim në kuadër të administratës komunale.

Kreu 9, neni 4, paragrafi 9.4.2, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë.

Ligji mbi Procedurën Administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 47/86)

Ligji mbi Konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 4/77)

Neni 31, Ligji mbi Gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78)

Dëshmitë:

Dëshmi mbi kërkesën e parashtruar organit përkatës i cili nuk i'u është përmbajtur detyrimeve të veta, siç është fletëkërkesa apo refuzimi nga ana e organit administrativ. Standardet mbi dëshmitë siç parashihet nga nenet 159-201, Ligji mbi procedurën

administrative.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Lexo Kreun IV, mosdiskriminimi, A I, mjete i përgjithshëm juridik, përshkrimi i mjetit juridik.

Ligji në fuqi:

G. Kërkesat/ankesat nga nëpunësit civil kundër vendimit diskriminues të Këshillit Disiplinor

Urdhëresa administrative e UNMIK-ut 2003/2 mbi zbatimin e Rregullores Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë, neni 33 (1):

“Çdo organ punësimi duhet ta themelojë një komision të ankesave për të dëgjuar ankesat e nëpunësve civil kundër vendimit të komisionit diciplinor (...)”.

Dëshmitë:

Dëshmi mbi kërkesën e parashtruar organit përkatës i cili nuk i'u është përmbajtur detyrimeve të veta, siç është fletëkërkesa apo refuzimi nga ana e organit administrativ. Standardet mbi dëshmitë siç paralexoen nga nenet 159-201, Ligji mbi procedurën administrative

Përshkrimi i mjetit juridik:

Komisioni i ankesave kryen funksionet e mëposhtme: Në rastin e ankesave kundër vendimeve të komisionit disiplinor:

- Duhet të vendosë nëse ka arsye legjitime për të pranuar një ankesë kundër vendimi të komisionit disiplinor;
- Nëse ankesa është pranuar, të vendosë se a është apo nuk është e arsyeshme pasi t'i ketë shqyrtuar provat dhe t'i ketë dëgjuar palët në fjalë dhe
- Në rast se ankesa mbahet si arsyetim për dhënien e urdhrave për ofrimin e ndihmës adekuate juridike ankuesit (neni 33 (5) I UA 2003/2 UNMIK)

Komisioni i ankesave duhet sa më shpejtë që të jetë e mundur të kompletojë shqyrtimet e rastit brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të tij. (neni 33 (5) I UA 2003/2) Ministria e shërbimeve publike mund të nxjerrë udhëzime të nevojshme për të lehtësuar funksionimin e komisionit disiplinor (neni 33 (7) i UA 2003/2 UNMIK).

Vërejtje: deri më tash nuk janë lëshuar këto udhëzime

H. Kërkesat/paditë për diskriminim të përdorimit të gjuhës amtare gjatë qasjes në shërbimet publike.

Regullorja e UNMIK-ut 2001/9, Kapitulli 3-4 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje në Kosovë

Regullorja e UNMIK-ut 2000/45, neni 9.1: pjesëtarët e komuniteteve do të kenë të drejtë të komunikojnë në gjuhën e tyre me të gjitha organet komunale dhe të gjithë nëpunësit civil komunal. Rregullorja 2000/45 neni 23 (4) (a)

Ligji në fuqi:

Neni 35, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave Udhëzimet përkatëse komunale

Neni 23, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave Kreu 9, neni 4, paragrafi 9.4.2, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë.

Ligji mbi Procedurën Administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 47/86)

Ligji mbi Konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 4/77)

Neni 31, Ligji mbi Gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78)

Dëshmitë:

Dëshmi mbi kërkesën e parashtruar organit përkatës i cili nuk i'u është përmbajtur detyrimeve të veta, siç është fletëkërkesa apo refuzimi nga ana e organit administrativ. Standardet mbi dëshmitë siç paralexoen nga nenet 159-201, Ligji mbi procedurën administrative.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Lexo Kreun IV, mos diskriminimi A 1, mjete i përgjithshëm juridik, përshkrimi i mjetit juridik.

I. Kërkesat/paditë kundër diskriminimit të shkaktuar nga zyrtarët e arsimit gjatë qasjes në arsimim

Ndjekja e mësimave në shkollë është e detyrueshme për fëmijët e moshës prej 6 deri në 15 vjet (neni 1(1) i 2000/51 mbi moshën për vijimin e detyrueshëm të shkollës në Kosovë

Urdhëresa Administrative e Departamentit për Arsim dhe Shkencë, 23/2001, Kodi i Mirësjelljes. Neni 5(1)
Personeli arsimor nuk do të diskriminojë nxënësit në baza racore, të gjinisë, orientimit seksual, ngjyrës, fesë, hendikepit, përkatësisë etnike, statusit apo prejardhjes.

Ligji në fuqi:

Rregullorja 2002/19 mbi Shpalljen e Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm të miratuar nga Kuvendi i Kosovës

Neni 35, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave Udhëzimet e Departamentit për Arsim dhe Shkencë 21/2001, dhe 23/2001 Kreu 9, neni 4, paragrafi 9.4.2, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë.

Ligji mbi Procedurën Administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 47/86)

Ligji mbi Konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 4/77)

Neni 31, Ligji mbi Gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78)

Dëshmitë:

Dëshmi mbi kërkesën e parashtruar organit përkatës i cili nuk i'u është përmbajtur detyrimeve të veta, siç është fletëkërkesa apo refuzimi nga ana e organit administrativ. Standardet mbi dëshmitë siç paralexohen nga nenet 159-201, Ligji mbi procedurën administrative.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Çdo person i cili pohon se ka qenë objekt i sjelljes e cila ka rezultuar në diskriminim gjatë qasjes në arsimim mund të parashtrorë ankesë me shkrim pranë oficerit të caktuar për anëtarin përkatës të stafit (Neni 3.1 i Urdhëresës Administrative të Departamentit për Arsim dhe Shkencë 21.2001).

Në bazë të Urdhëresës Administrative të Departamentit për Arsim dhe Shkencë 21/2001, neni 2(2), në bazë të kësaj urdhërese kundër personelit arsimor mund të shqiptohen masa disiplinore mbi këto baza: pakujdesia në detyrë apo shkelja e obligimeve të parapara me kontratë, kushteve të punës, Kodit të Mirësjelljes apo rregullave lokale të nxjerra nga Departamenti për Arsim dhe Shkencë .

Nëse ankesa është e bazuar, Departamenti për Arsim dhe Shkencë mund të ndërmerr veprime administrative apo disiplinore, siç paralexoet me nenin 2(1), Urdhëresa Administrative e Departamentit për Arsim dhe Shkencë, 23/2001.

Procedura është e përshkruar në Urdhëresën Administrative, 21/2001, nenet 4(1-2). Neni 4(1) thotë se nëse parashtrorë ankesë kundër një mësimdhënësi të caktuar apo nëse dëshmitë mbi sjelljen e mësimdhënësit të cilat mund të kërkojnë marrjen e masave disiplinore kuptohen nga Drejtori i Shkollës, atëherë ai mund të ndërmerr hetime për zbardhjen e ankesës së parashtruar dhe i jep mundësi mësimdhënësit në fjalë të drejtën për përgjigje ndaj pohimeve të bëra kundër tij.

Neni 4(2) thotë se nëse, pas zhvillimit të hetimeve dhe pas dhënies së mundësisë mësimdhënësit përkatës për të dhënë përgjigje ndaj pohimeve të bëra kundër tij, drejtori i shkollës vendos se a kemi të bëjmë me sjellje të mësimdhënësit e cila kërkon marrjen e masave disiplinore, dhe duhet gjithashtu para hyrjes në fuqi të masës disiplinore, të njoftojë mësimdhënësin me shkrim mbi masën disiplinore e cila ndërmirret kundër tij.

Përpos në rastet e vërejtjes gojore, drejtori i shkollës duhet të njoftojë mësimdhënësin me shkrim se ai ka të drejtë të bëjë kërkesë me shkrim për mbajtjen e seancës dëgjuese kundër veprimit disiplinor brenda 10 ditëve nga dita e pranimit të njoftimit të tillë.

Kolegji për Shqyrtim të Ankesave do të mbajë seancën dëgjuese të ankesave, dhe brenda 7 ditëve pas mbajtjes së seancës së tillë, ai do të merr vendim i cili do t'i kumtohet me shkrim mësimdhënësit në fjalë

Neni 5(1):

Nëse ankesa parashtrorë kundër drejtorit të shkollës apo nëse ekzistojnë dëshmi për sjelljen e tij e cila mund të kërkojë marrjen e masave disiplinore të cilat i kupton SEO-ja, do të themelohet Kolegji përkatës për Shqyrtim të Ankesave me qëllim të zhvillimit të hetimeve në lidhje me këtë rast.

Nëse parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me vendimin e marrë sipas procedurave të sipërpërmendura, parashtruesi i kërkesës mund të parashtrorë ankesë

pranë gjykatës supreme (Lexo A I mjeti i përgjithshëm juridik, përkrahimi i mjetit juridik).

Një ankesë apo kërkesë shtesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm të aktvendimit mund të parashtrohet kundër aktvendimit me padi administrative (A I mjeti i përgjithshëm juridik, përkrahimi i mjetit juridik)

J. Kërkesat/paditë kundër diskriminimit sipas LKD, të shkaktuar nga zyrtarët e arsimit gjatë qasjes në arsimim

II Ligji në fuqi:

Neni 4 (g), i LKD.

Dëshmitë:

Dëshmitë për diskriminim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (përfshirë rastet e ngacmimit, viktimizimit dhe segregimit) të bazuar në gjini, seks, moshë, gjendje martesore, gjuhë, paaftësi fizike ose mentale, orientim seksual, anim ose bindje politike, prejardhje etnike, kombësie ose përkatësie fetare, racë, pozitë sociale, pasuri, lindje ose ndonjë pozitë tjetër në lëmin e arsimit.

Përkrahimi i mjetit juridik:

Sipas LKD, personi i cili pohon se ka qenë i diskriminuar drejtpërdrejtë ose tërthorazi, mund të ngrisë padi kundër diskriminimit panë organeve administrative dhe gjyqësore kompetente, dhe të cilat kanë kompetencë për çështjet konkrete të paraqitura në padi.

Për hollësi tjera lexo Kreun IV, mos diskriminimi, B, kundër diskriminimi

K. Kërkesat/ankesat kundër sanksioneve arbitrare të bëra nga mësuesit dhe personeli arsimor

Regullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/19 mbi Shpalljen e Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, neni 33.3 (b) dhe 33.4

Ligji në fuqi

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/19 mbi Shpalljen e Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, neni 33.4 "Mësuesit dhe personeli tjetër i institucioneve arsimore kanë të drejtë të kundërshtojnë në gjykatën e juridiksionit përkatës çdo vendim apo veprim të komunës ose MASHT lidhur me ta".

Ligji mbi Procedurën Administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 47/86)

Ligji mbi Konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 4/77)

Neni 31, Ligji mbi Gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78)

Dëshmitë

Dëshmi mbi kërkesën e parashtruar organit përkatës i cili nuk l'u është përmbajtur detyrimeve të veta, siç është fletëkërkesa apo refuzimi nga ana e organit administrativ. Standardet mbi dëshmitë siç paralojnë nga nenet 159-201, Ligji mbi procedurën administrative.

Përkrahimi i mjetit juridik

Në rast se vendimi është marrë nga autoritetet komunale, Lexo Kreun IV, mos diskriminimi A I, Mjeti i përgjithshëm juridik, përkrahimi i mjetit juridik.

Nëse vendimi është marrë nga MASHT, ankesa mund t'i parashtrohet Gjykatës Supreme (neni 7, i Ligjit mbi konfliktet administrative).

L. Kërkesat/paditë për diskriminim gjatë qasjes në kujdesin shëndetësor

Ligji në fuqi:

Neni 21 i Ligjit të Kosovës për shëndetësinë (LKSH)

"Të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve për kujdesin shëndetësor rregullohen me akte të posaçme normative"

Nenet 118-120 të Ligjit të Kosovës për shëndetësinë

Shënim: në kohën e publikimit të këtij katalogu, LKSH ende nuk është shpallur.

Momentalisht, është hartuar Ligji për të drejtat e pacientëve. Pasi të shpallet ky ligj, do t'i zhvillojë edhe më tutje mjetet juridike ekzistuese.

Dëshmitë:

Do të aplikohen rregullat e përgjithshme të të provuarit sipas Kodit Civil dhe Kodit të përkohshëm të procedurës penale.
Në lidhje me sanksionet administrative, zbatohen dispozitat e neneve 159-201 të Ligjit të përgjithshëm të procedurës administrative.

Përshkrimi i mjetit juridik

Sipas LKSH, mund të paraqitet vërejtja me shkrim pranë institucionit shëndetësor ose një pjesë të tij në këto raste: shkejet esenciale të etikës profesionale mjekësore; të normave të sigurisë teknike dhe aspekteve mjekësore; gabimet gjatë procesit të trajtimit dhe mos zbatimi i procedurave për nevoja të kujdesit shëndetësor; mos respektimi i parakushteve të nevojshme për ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe sjellja e pahijshme me qytetarë (neni 118.1i LKSH)

Edhe nëse përkundër vërejtjes me shkrim, institucioni shëndetësor nuk i menjanon çrregullësitë/shkeljet, insititucioni shëndetësor dhe drejtori mund t'i nënshtrohen gjobave ndëshkimore (neni 118.2 dhe 119.1 i LKH)

Nëse përkundër masave të lartpërmendura, këto probleme vazhdojnë të jenë prezente, institucionit përkatës shëndetësor do t'i vëhen masat administrative nga themeluese (neni 118.3 i LKSH).

Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për ndërprerjen e marrëdhënjes së punës si masë dicyplinore.

***Shënim:** nuk është e qartë se kush ka të drejtë të bëjë vërejtje me shkrim pranë institucionit shëndetësor. Një interpretim i mundshëm është që personat e prekur me sjelljet e përmendura mund të bëjnë vërejtje. Nuk janë dhënë afate të caktuara për përgjigje në vërejtje nga institucioni shëndetësor. Nuk është e qartë nëse ministria është ajo e cila do të nxjerrë aktet nënligjore për shpjegimin e këtyre dispozitave.*

Gjobat ndëshkuese parashikohen për institucionet shëndetësore dhe zyrtarët e tyre në rastet e shkeljeve administrative. (për përshkrim më të hollësishëm të këtyre shkeljeve lexo Kreun XXIII, nenin 119 të LKSH)

Qytetari ose organi i autorizuar mund të inicojnë procedurë civile ose penale kundër insitucionit shëndetësor ose punëtorit shëndetësor në rastet kur procedura e diagnostifikimit dhe e terapisë kryhet pa pëlqimin e pacientit në fjalë ose përfaqësuesit të autorizuar, ose në rastet e vdekjes ose paafëtimit të përhershëm që shkaktohet për shkak të gabimeve profesionale ose organizative ose dispozitat që kanë të bëjnë me shkeljen e normave për ndërpreje të shtatëzanësisë (neni 120, LKSH).

M. Kërkesat/paditë për diskriminim gjatë qasjes në kujdesin shëndetësor sipas Ligjit të Kosovës për Shëndetësi

Ligji në fuqi:

Neni 35, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave Udhëzimet përkatëse komunale
Neni 23, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave
Kreu 9, neni 4, paragrafi 9.4.2, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë.
Ligji mbi Procedurën Administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 47/86)
Ligji mbi Konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 4/77)
Neni 31, Ligji mbi Gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78)

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/10 mbi themelimin e Departamentit Administrativ të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë (parasheh bartja e pushtetit tek kujdesi shëndetësor primar, për dallim nga spitalet)].

Dëshmitë:

Dëshmi mbi kërkesën e parashtruar organit përkatës i cili nuk i'u është përmbajtur detyrimeve të veta, siç është fletëkërkesa apo refuzimi nga ana e organit administrativ. Standardet mbi dëshmitë siç paralexoen nga nenet 159-201, Ligji mbi procedurën administrative.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Lexo Kreun IV, mos diskriminimi A I, Mjeti i përgjithshëm juridik, përshkrimi i mjetit juridik.

N. Padi të kundër diskriminimit gjatë qasjes në kujdes shëndetësor sipas LKD

Ligji në fuqi:

Neni 4(e), i LKD

Dëshmitë:

Dëshmitë për diskriminim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (përfshirë rastet e ngacmimit, viktimizimit dhe segregimit) të bazuar në gjini, seks, moshë, gjendje martesore, gjuhë, paaftësi fizike ose mentale, orientim seksual, anim ose bindje politike, prejardhje etnike, kombësie ose përkatësie fetare, racë, pozitë sociale, pasuri, lindje ose ndonjë pozitë tjetër në lëmin e shëndetësisë.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Sipas LKD, personi i cili pohon se ka qenë i diskriminuar drejtpërdrejtë ose tërthorazi, mund të ngrisë padi kundër diskriminimit panë organeve administrative dhe gjyqësore kompetente, dhe të cilat kanë kompetencë për çështjet konkrete të paraqitura në padi. Për hollësi tjera lexo Kreun IV, mos diskriminimi, B, Ligji kundër diskriminimit.

O. Ankesat kundër diskriminimit lidhur me qasjen në ndihmën (mirëqenien) sociale

Ligji në fuqi:

Neni 11, i Rregullores së UNMIK-ut mbi shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për skemën e ndihmës sociale në pjesët përkatëse:

“11.1. Kërkuesi i ndihmës që mendon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë, mund t'i parashtojë ankesë (...).”

“Kërkuesi i ndihmës që nuk është i kënaqur me vendimin e organit përkatës (...)mund t'i paraqesë ankesë me shkrim Komisionit të ankesave (...)

“11.3. Kërkuesi i pakënaqur me vendimin e Komisionit mjekësor (...)ose me vendimin e Komisionit për ankesa, siç paralexoet në nenin 11 pikën 2, ka të drejtë që të parashtojë ankesë në gjyqin kompetent.

Neni 35, i Rregullores së UNMIK-ut mbi vetëqeverisjen e komunave.

Udhëzimet relevante komunale

Kreu4, neni 9.4.2, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë

Ligji i procedurës administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 47/86)

Ligji mbi kontestin administrativ (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 4/77)

Neni 31, Ligji mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

Dëshmitë:

Prova se kërkesa i është parashtruar autoritetit përkatës, siç është kërkesa apo refuzimi nga ana e organit administrativ. Standardet mbi dëshmitë janë të parashikuara në nenet 159 – 201 të Ligjit të procedurës administrative.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Kërkuesi i ndihmës që mendon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë, mund t'i parashtojë ankesë me shkrim drejtorit të organit përkatës, tek i cili ka bërë kërkesën për ndihmë sociale. Ankesat bëhen jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë pas marrjes të vendimit. Organi përkatës shqyrton ankesën dhe njofton me shkrim ankuesin jo më vonë se njëzet e një (21) ditë pas marrjes së ankesës.

Kërkuesi i ndihmës që nuk është i kënaqur me vendimin e drejtorit, mund t'i paraqesë ankesë me shkrim Komisionit të ankesave, i cili vepron nën autorizimin e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale. Ankesat dorëzohen jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë nga dita e vendimit të marrë. Komisioni i ankesave duhet ta shqyrtojë ankesën dhe ta njoftojë me shkrim parashtruesin e ankesës për vendimin e marrë jo më vonë se njëzet e një (21) ditë pas marrjes së ankesës.

Kërkuesi i pakënaqur me vendimin e Komisionit mjekësor (pas shqyrtimit të gjendjes mjekësore të anëtarit të familjes që deklaroi se është me aftësi përherë të kufizuara) ose me vendimin e Komisionit për ankesa, siç paralexoet në nenin 11 pikën 2, ka të drejtë që të parashtojë ankesë në gjyqin kompetent. Rregullorja nuk e precizon gjykatën kompetente, por si duket Dhoma Administrative e Gjykatës Supreme është

kompetente për këto çështje.

P. Ankesat kundër diskriminimit lidhur me qasjen në ndihmën (mirëqenien) sociale sipas LKD

Ligji në fuqi:

Neni 4(e), (f), dhe (i) i LKD

Dëshmitë:

Dëshmitë për diskriminim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (përfshirë rastet e ngacmimit, viktimizimit dhe segregimit) të bazuar në gjini, seks, moshë, gjendje martesore, gjuhë, paaftësi fizike ose mentale, orientim seksual, anim ose bindje politike, prejardhje etnike, kombësie ose përkatësie fetare, racë, pozitë sociale, pasuri, lindje ose ndonjë pozitë tjetër, lidhur me mbrojtjen dhe sigurinë sociale dhe ndihmën humanitare.

Përshkrimi i mjetit juridik

Sipas LKD, personi i cili pohon se ka qenë i diskriminuar drejtpërdrejtë ose tërthorazi, mund të ngrisë padi kundër diskriminimit panë organeve administrative dhe gjyqësore kompetente, dhe të cilat kanë kompetencë për çështjet konkrete të paraqitura në padi. Për hollësi tjera lexo Kreun IV, mos diskriminimi, B, Ligji kundër diskriminimit.

IV. Viktimat e krimit

A. Mjetet juridike në disponim për palën e dëmtuar

1. Viktima e krimit/pala e dëmtuar – propozimi për ndjekje penale, padia private dhe subsidiare

Ligji në fuqi:

Neni 53 i KPPPK,

“Sipas kushteve të parapara me këtë Kod, i dëmtuari në procedurë penale mund të paraqesë propozim për ndjekje penale, të veprorë si paditës privat apo si paditës subsidiar”.

Vërejtje: Shumica e veprave penale të parapara me Kodin e përkohshëm të procedurës penale të Kosovës (KPPPK) ndiqen nga nga prokurori publik kompetent i cili e bën ndjekjen penale të peresonave të akuzuar për kryerje të veprave penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare. Janë edhe disa kategori të veprave penale që ndiqen nga prokurori publik për me kërkesë të palës së dëmtuar. Gjithashtu, KPPPK parashikon edhe mundësinë e palës së dëmtuar që të inicojë padinë private dhe atë subsidiare. Nenet 6, 62, 151 të KPPPK

Dëshmitë:

Nuk nevojitet ndonjë dëshmi specifike. Vërejtje: Paditësi privat dhe pala e dëmtuar kanë të njëjtat të drejta me ato të prokurorit sa i përket qasjes (shiqimit) të dokumentacionit, procesverbalit dhe neneve të shfrytëzuar. (neni 61 i KPPPK)

Përshkrimi i mjetit juridik:

Propozimi për ndjekje penale

Për disa vepra penale të parapara me ligjin penal, prokurori publik e fillon procedurën penale vetëm me propozimin e të dëmtuarit. Për veprat penale të cilat ndiqen sipas propozimit ose padisë private, propozimi për ndjekje ose padia private duhet të paraqitet brenda tre muajsh nga dita kur personi i autorizuar ka mësuar për veprën penale dhe për kryerësin. Pas paraqitjes së propozimit të këfillë konsiderohet se ndjekja zbatohet sipas detyrës zyrtare (nenet 6, 54 (1), 55 (1) të KPPPK).

Padia subsidiare

Termi “paditës subsidiar” i referohet palës së dëmtuar e cila, në rastet kur prokurori publik çmon se nuk ka bazë për iniciimin ose vazhdimin e procedurës penale, e merr përsipër ndjekjen e këtyre veprave penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare. Nëse prokurori publik çmon se nuk ka baza për ndjekje penale, ai duhet ta njoftojë palën e dëmtuar brenda tetë ditëve për vendimin e tij dhe e udhëzon palën e dëmtuar se ai/ajo ka të drejtë ta vazhdojë procedurën si paditës subsidiar. Pala e dëmtuar ka të drejtë të ndërmerrë, respektivisht të vazhdojë ndjekjen brenda afatit prej tetë ditësh nga dita kur ka marrë njoftimin prokurori publik. Pala e dëmtuar mund të vazhdojë procedurën sipas aktakuzës fillestare apo mund të ngitë aktakuzë të re. I dëmtuari i cili nuk është njoftuar se prokurori publik nuk ka ndërmarrë ndjekjen ose që ka hequr dorë nga ndjekja, deklaratën e vet, se e zjgatë procedurën, mund ta japë para gjykatës kompetente brenda afatit prej tre muajsh nga dita kur prokurori publik e ka hudhur poshtë kallximin, respektivisht nga dita kur është nxjerrë aktvendimi mbi pezullimin e procedurës. Kur prokurori publik, e njofton të

dëmtuarin se mund të ndërmarrë ndjekjen, do t'i dërgojë edhe udhëzimin se cilat veprime mund t'i ndërmerrë pala e dëmtuar për realizimin e kësaj të drejte (nenet 62, 224, 326 të KPPPK)

Pala e dëmtuar në cilësinë e paditësit privat, i ka të njëjtat të drejta me ato të prokurorit publik, përveç atyre të cilat i takojnë prokurori publik si zyrtar publik. Pa marrë parasysh atë që u tha më lart, deri në fund të seancës kryesore prokurori publik mund t'ia merr ndjekjen penale paditësit subsidiar në çdo kohë (neni 65 KPPPK)

Padia private

Termi "paditës privat" i referohet palës së dëmtuar e cila e ndërmerr ndjekjen penale të disa veprave më pakë të rënda për të cilat sipas ligjit kërkohet padia private. Nëse me ligj parashikohet që procedura penale të inicohet me padi private atëherë padia duhet të ngritet para gjykatës kompetente brenda afatit prej tre muajsh nga dita kur personi i autorizuar ka mësuar për veprën penale dhe për kryesin (nenet 54 (1), 55 (1) të KPPPK).

Kur i dëmtuari është i mitur apo të cilin i mungon plotësisht zotësia e veprimit, përfaqësuesi ligjor i tij është i autorizuar të japë të gjitha deklaratat dhe të ndërmerrë të gjitha veprimet të cilat në bazë të këtij ligji është i autorizuar i dëmtuari. I dëmtuari i cili ka mbushur moshën 16 vjeçare është i autorizuar që të japë vetë deklaratën dhe të ndërmerr veprimet në procedurë. (nenet 56, 66 të KPPPK).

Kundër aktgjykimit të shkallës së parë, prokurori publik/i dëmtuari ka të drejtë ankese brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e dërgimit të kopjes së aktgjykimit (neni 398(1), 399 (1) të KPPPK). Ankesa e paraqitur me kohë, e shtyen ekzekutimin e aktgjykimit (neni 398(2) KPPPK). Aktgjykimin mund të kundërshtohet mbi të gjitha bazat e parapara me nenin 402 (3) KPPPK.

2. Viktima/Pala e dëmtuar, dëmtimi apo humbja e pasurisë.

Paraqitja e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale apo në atë civile (kontestimore). (Nenet 107-118, KPPPK)

Ligji në fuqi:

Neni 108 (1) i KPPPK

"Propozimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale mund ta paraqesë personi i cili është i autorizuar për ta ushtruar këtë kërkesë në kontest civil".

Dëshmitë:

Zbatohen rregullat e përgjithshme të mbledhjes së provave. Gjykata është e obliguar sipas detyrës zyrtare të mbledhë provat dhe të kryej hetimin e nevojshëm për marrjen e vendimit lidhur me kërkesën.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Në procedurë penale:

Kërkesa pasurore juridike si rrjedhojë e kryerjes së veprës penale vendoset me propozimin e personave të autorizuar në procedurën penale në qoftë se kjo nuk e zvarrit procedurën në mënyrë të konsiderueshme (neni 107). Kërkesa pasurore juridike mund të përfshijë kompensimin e dëmit, kthimin e sendit ose prishjen e një veprimi të caktuar juridik (neni 107(2) KPPPK). Në qoftë se hetimi i kërkesës pasurore juridike do të zvarriste procedurën penale në masë të konsiderueshme, gjykata kufizohet në mbledhjen e atyre të dhënave, vërtetimi i të cilave më vonë nuk do të ishte i mundur ose do të ishte dukshëm i vështirësuar (neni 111 (2) i KPPPK).

Propozimi mund të paraqitet jo më vonë se deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë. Personi i autorizuar për paraqitjen e propozimit detyrohet ta parashtrorë në mënyrë të qartë kërkesën e vet dhe të paraqesë prova (neni 109 (2,3) KPPPK).

Si gjykat kompetente e shkallës së parë, është gjykata komunale ose gjykata e qarkut. Kompetencë e gjykatës komunale është të vendosë në shkallë të parë për veprat penale për të cilat me ligj është paraparë dënim me gjobë ose dënim me burgim deri në pesë vjet po qe se për gjykimin e veprave të tilla penale nuk është kompetente gjykata e qarkut; Kompetencë e gjykatës së qarkut është të gjykojë në shkallë të parë për veprën penale të dënueshme me të paktën pesë vjet burgim ose burgim afatgjatë dhe veprën penale për të cilën me ligj është paraparë të jetë në kompetencë të gjykatës së qarkut (neni 21 KPPPK)

Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që

kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në një kontest civil. Kur gjykata merr aktgjykim me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilën akuza refuzohet apo kur me aktvendim pushohet procedura penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest civil.(neni 112 (2,3) KPPPK.

Në procedure kontestimore

Gjykatat komunale ose të qarkut e shkallës të parë janë kompetente, varësisht nga vlera e kontestit (neni 26 (6) dhe 29 (2) I Ligjit mbi gjykatat e rregullta) Gazeta Zyrtare e KSAK 21/78).

Pala e dëmtuar ka të drejtë ankese kundër aktgjykimit të shkallës së parë Brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së kopjes së aktgjykimit (neni 348 i Ligjit të procedurës kontestimore, Gazeta Zyrtare 4/77), ose të kërkojë revizionin e aktgjykimit të plotëfuqishëm të shkallës së dytë, brenda 30 ditësh nga dita e marrjes së kopjes së aktgjykimit (neni 382 i Ligjit të procedurës kontestimore)

3. Siguria e palës së dëmtuar

Masat mbrojtëse gjatë procedurës penale.
Neni 169 (1,4) i KPPPK

Ligji në fuqi:

Neni 169 (1) i KPPPK.

“i dëmtuari apo dëshmitari në cilëndo fazë të procedurës mund t'i paraqesin gjyqtarit kërkesë me shkrim për masën mbrojtëse ose urdhrin për anonimitet kur ka rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin apo anëtarët e familjeve të tyre”.

Neni 169 (4) i KPPPK

“Gjyqtari mund të urdhërojë masën mbrojtëse për të dëmtuarin ose dëshmitarin kur ai konstaton se:

- 1) Ekziston rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin ose për anëtarin e familjes së tij dhe
- 2) Masa mbrojtëse është e domosdoshme për të parandaluar rrezikun serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin ose anëtarin e familjes së tij.

Dëshmitë:

Deklarata mbi pohimet faktike (neni 2.2). Shënimet policore, deklaratat e palës së dëmtuar dhe dëshmitarëve. (neni 169 (2,3) i KPPPK.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Pala e dëmtuar mund të bëjë propozimin me shkrim para gjykatës kompetente (gjatë hetimeve para gjyqtarit në procedurë paraprake, ndërsa gjatë seancës kryesore, para kryetarit të trupit gjykues), për masën mbrojtëse apo urdhërin për anonimitet.

Masat mbrojtëse

Gjykata e lejon kërkesën nëse konstaton se ekziston rreziku serioz për palën e dëmtuar, dëshmitarin apo anëtarët e familjeve të tyre, dhe se masa mbrojtëse është e nevojshme për parandalimin e rrezikut serioz kundër personave të sipërpërmendur (neni 169 (4) i KPPPK).

Termi “Rrezik serioz” është frika e justifikueshme për rrezikim jete, shëndeti, prone të të dëmtuarit ose të dëshmitarit, të anëtarit të familjes së të dëmtuarit ose të dëshmitarit si pasojë që pritet për faktin se dëshmitari ose i dëmtuari kanë dhënë prova gjatë marrjes në pyetje apo dëshmimit në gjykatë; (168 (1) I KPPPK)

Termi “Anëtar i familjes” është bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor, gjinia e gjakut në vijë të drejtë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllau, motra ose prindi ushqyes; (168 (2) I KPPPK)

Gjykata nëse e sheh si të nevojshme, mund të urdhërojë masën mbrojtëse. Neni 170 i KPPPK përmbanë listën e pashterrëshme të masave mbrojtëse të mundshme siç janë: Lënia bosh ose shlyerja e emrave, adresave, vendit të punës, profesionit ose ndonjë të dhëne a informate tjetër që mund të përdoret për të identifikuar të dëmtuarin ose dëshmitarin; moszbulimin e ndonjë shkrese që identifikon të dëmtuarin ose dëshmitarin etj;

Urdhëri për anonimitet

Kur masat mbrojtëse të parapara në neni 170, paragrafi 1 i këtij Kodi janë të pamjaftueshme për të garantuar mbrojtjen e të dëmtuarit ose të dëshmitarit të cilët nuk janë propozuar nga mbrojtja, gjyqtari në rrethana të jashtëzakonshme mund të marrë urdhër për anonimitet me të cilin i dëmtuari ose dëshmitari mbeten anonim për të pandehurin dhe mbrojtësin (neni 172 (1)).

Para se të merret urdhër për anonimitet, gjyqtari zbaton seancë dëgjimi me dyer të mbyllura, në të cilën merren në pyetje i dëmtuari ose dëshmitari në fjalë dhe personat tjerë të nevojshëm siç është personeli policor ose ushtarak që kujdesen për rendin. Përveç këtyre personave, të pranishëm mund të jenë vetëm prokurori publik, personeli kryesor i gjykatës e i prokurorisë dhe mbrojtësi. Gjyqtari mund të jep urdhër për anonimitet vetëm kur çmon se: ekziston rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin ose anëtarin e familjes së tij nëse nuk ruhet anonimiteti i plotë i të dëmtuarit a i dëshmitarit, prandaj është e nevojshme të parandalohet rreziku i tillë; dëshmia e dëshmitarit ose e të dëmtuarit është aq e rëndësishme për çështjen sa që e bën të padrejtë detyrimin e paditësit të procedojë pa të; besueshmëria e të dëmtuarit ose e dëshmitarit është hetuar dhe është zbuluar plotësisht për gjyqtarin në seancë të mbyllur dhe nevoja për anonimitetin e të dëmtuarit ose të dëshmitarit në sigurimin e drejtësisë vlen më shumë se interesi i të pandehurit për të mësuar identitetin e të dëmtuarit a të dëshmitarit gjatë zbatimit të mbrojtjes(neni 172 (2,3)).

4. Pala e dëmtuar në kundërvajtje

Neni 27, 65, 68, 87, 94, 96, 111, 113, 122, 210-12, i Ligjit mbi kundërvajtjet (Gazeta Zyrtare KSAK, No. 23/79)

Liqi në fuqi

Neni 65:

“Procedura e kundërvajtjes fillon me kërkesën e organit të autorizuar apo personit të dëmtuar.”

Dëshmitë

Nuk kërkohet dëshmi specifike.

Vërejtje: dëshmitë në procedurën kundërvajtëse kufizohen vetëm në faktet e rëndësishme për konstatimin e së vertëtës materiale (faktike)(nenet 66, 68 (2) LK)

Përshkrimi i mjetit juridik:

Procedura kundërvajtëse

Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse para gjykatës përkatëse, mund të bëhet me shkrim ose verbalisht në procesverba, nga organet kompetente dhe pala e dëmtuar brenda një viti nga kryerja e kundërvajtjes (nenet 27(1), 96(1), 134).

Në kërkesë duhet shënuar emrin dhe adresën e personit të akuzuar si dhe vlerën e dëmit të shkaktuar.

Krahës kësaj kërkesa duhet të përmbajë përshkrimin faktik të veprës duke shënuar kohën dhe vendin e ngjarjes dhe rrethanat tjera të nevojshme për caktimin e kualifikimit ligjor të veprës dhe propozimi për mbledhjen e provave. Nëse parashtrësia nuk përmban të gjitha ato që janë të nevojshme për të vepruar lidhur me këtë, paraqitësi do të ftohet që brenda afatit të caktuar, më së voni në afatin prej 15 ditësh, ta korrigojë ose plotësojë atë (neni 135).

Termi “palë e dëmtuar” nënkupton personin të cilit i është dëmtuar prona ose integriteti personal ose kërcënuar me atë vepër (neni 94).

Pala e dëmtuar ka të drejtën e paraqitjes së kërkesës për iniciimin e procedurës, paraqitjes së provave, propozimeve dhe kërkesës për kompensim të dëmit ose kthimit të sendeve (nenet 94 (1,2)). Parashtrësia bëhen me shkrim ose verbalisht në procesverbal. Nëse parashtrësia janë të pakuptueshme dhe nuk përmbajnë elementet e nevojshme, paraqitësi do të ftohet t’i përmirësojë ato ose plotësojë brenda afatit të caktuar i cili është 15 ditë (neni 96 (3)).

Kundër vendimit të shkallës së parë mund të ngritet ankesa pranë gjykatës së lartë për kundërvajtje (neni 210(1)). Ankesa paraqitet brenda 8 ditëve nga dita e shpalljes me gojë të vendimit (neni 211). Ankesa e shtyen ekzekutimin, përveç nëse nuk parashkohet ndryshe me këtë ligj (neni 212 i LK)

Mjetetet e jashtëzakonshme juridike

Paraqitësi i kërkesës mund të kërkojë edhe përsëritjen e procedurës kundërvajtëse e cila ka përfunduar me aktvendim të plotëfuqishëm, brenda një viti nga dita kur aktvendimi është bërë i plotëfuqishëm. Për kërkesën për përsëritje vendosë e njëjta gjykatë e cila e ka pruar aktvendimin në shkallë të parë (nenet 230, 231, 232 (1) i LK).

Procedura mund të përsëritet nëse është bazuar aktvendimi në dokumentacion të rrejtshëm ose në deklaratë të rrejtshme të dëshmitarit os ekspertit, nëse është kryer vepër penale nga gjyqtari ose personat tjerë zyrtarë pjesëmarrës në procedurë, nëse personi i dënuar vetëm se ka qenë i dënuar për të njëjtat aktivitete para marrjes së aktvendimit ose nëse kanë dalë fakte të reja ose prova të cilat do të rezultojnë me vendim tjetër po qese do të kishin qenë të njohura gjatë marrjes së vendimit (neni 228 i LK)

Kërkesa pasurore juridike në procedurën kundërvajtëse

Kërkesa për dëmshpërblimin pasuror ose kthim të sendit, si rezultat i kundërvajtjes mund të paraqitet në procedurën kundërvajtëse. Kjo kërkesë mund të paraqitet më së voni deri në fund të seancës kryesore. Mbi kërkesën vendoset në procedurën kundërvajtëse, përveç nëse kjo nuk do ta zvarrisë procedurën (neni 118, 119 i LK).

Në aktvendim gjykata e cakton afatin kohor brenda të cilit personi i dënuar duhet ta shpërblejë dëmin ose ta rikthejë sendin. Ky afat nuk mund të jetë më i shkurtë se 15 ditë ose më i gjatë se 3 muaj (neni 122 i LK).

Nëse shënimet në procedurë kundërvajtëse nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për plotësimin e kërkesës, gjykata e udhëzon paraqitësin që këtë ta bëjë përmes kërkesës në kontest civil. E njëjta vlenë edhe kur procedura ndërpritet (neni 121, (1,2) i LK).

Kërkesa pasurore juridike në gjykatë civile:

Gjykatat komunale ose të qarkut e shkallës të parë janë kompetente, varësisht nga vlera e kontestit (neni 26 (6) dhe 29 (2) i Ligjit mbi gjykatat e rregullta) Gazeta Zyrtare e KSAK 21/78).

Pala e dëmtuar ka të drejtë ankese kundër aktgjykimit të shkallës së parë Brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së kopjes së aktgjykimit (neni 348 i Ligjit të procedurës kontestimore, Gazeta Zyrtare 4/77), ose të kërkojë revizionin e aktgjykimit të plotëfuqishëm të shkallës së dytë, brenda 30 ditësh nga dita e marrjes së kopjes së aktgjykimit (neni 382 i Ligjit të procedurës kontestimore)

5. Viktimat e dhunës në familje Urdhëri mbrojtës

Ligji në fuqi:

Neni 8.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/12 për mbrojtjen kundër dhunës familjare thekson: Gjykata e lëshon urdhrin për mbrojtje për të caktuar një ose më shumë prej masave të parapara në nenin 2.1, nëse vërteton se:

- (a) Ekzistojnë bazat për të besuar se i pandehuri ka kryer ose është kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje dhe
- (b) Lëshimi i urdhrin për mbrojtje është i domosdoshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur apo të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare dhe i cili duhet të mbrohet me anë të urdhrin.

Dëshmitë:

Raportet mjekësore, dëshmitarët e aktit të dhunës familjare, raportet policore etj.

Përshkrimi i mjetit juridik:

“Dhunë në familje” do të thotë një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në një lidhje familjare si këto: shkaktimi i lëndimit trupor; marrëdhënia seksuale ose keqtrajtimi seksual pa pëlqim; qitja e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen e tij apo të saj fizike, emocionale dhe ekonomike; rrëmbimi; shkaktimi i dëmeve pasurore; kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër; hyrja me dhunë në pronën e personit tjetër; largimi me dhunë i personit tjetër nga banesa e përbashkët; ndalimi i personit tjetër për të hyrë ose për të dalë nga banesa e përbashkët ose përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër (neni 1.2 i Rregullores

2003/12. "Lidhje familjare" do të thotë lidhja ndërmjet dy personave: të cilët janë të fejuar ose të martuar me njëri-tjetrin apo bashkëjetojnë me njëri-tjetrin pa qenë të martuar; të cilët përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesore ose birësimi apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit e motrat, hallat e tezeta, xhaxhallarët e dajallarët, ose kushërinjtë ose të cilët janë prindër të një fëmije të përbashkët (neni 1.1 i Rregullores 2003/12). Ekzistojnë tri lloje të ndryshme të urdhërave mbrojtës të parashikuar me këtë rregullore.

Urdhërat mbrojtës

Viktima e dhunës në familje ose përfaqësuesi i saj ligjor mund të parqesë kërkesën për urdhër mbrojtës (UM). Kërkesa parqitet me shkrim ose me gojë (neni 6.3 i Rregullores 2003/12), pranë gjykatës komunale kompetente për komunën në territorin e të cilës paraqitësi i kërkesës ka vendbanim të përhershëm ose të përkohshëm (neni 5.1) dhe gjykata e lëshon vendimi për urdhër brenda 15 ditësh (neni 7.1). Gjykata mund të udhërorjë masat për mbrojtjen e viktimës si në vijim:

- (a) T'ia ndalojë të pandehurit që mos të kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur apo personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;
 - (b) T'ia ndalojë të pandehurit që mos e trazojë, të mos e ngacmojë, të mos kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt a tërthorazi me palën e mbrojtur ose me personin me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;
 - (c) T'ia ndalojë të pandehurit që mos t'i ofrohet brenda një distance të caktuar palës së mbrojtur ose personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;
 - (d) T'ia ndalojë të pandehurit qëndrimin në vendin e punës së palës së mbrojtur ose në ndonjë vend të caktuar;
 - (e) T'ia kufizojë të pandehurit që të mos takohet me fëmijën e palës së mbrojtur sipas kushteve të cilat mund të jenë të përshtatshme;
 - (f) T'ia ndalojë të pandehurit hyrjen ose qëndrimin në banesën e përkohshme a të përhershme të palës së mbrojtur, ose në ndonjë pjesë të saj, pavarësisht nga të drejtat pronësore apo të drejtat e banimit të të pandehurit;
 - (g) Të urdhërojë ndonjë person të autorizuar që ta shoqërojë palën e mbrojtur ose të pandehurin deri në banesën e palës së mbrojtur dhe të mbikëqyrë largimin e pasurisë personale që i takon atij personi apo ndonjë personi tjetër të caktuar;
 - (h) Të urdhërojë konfiskimin e armëve (siç është përcaktuar me Rregulloren nr. 2001/7 të UNMIK-ut të datës 21 shkurt 2001 për Autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë), duke përfshirë edhe armët gjuetisë dhe ato të rekreacionit;
 - (i) T'ia urdhërojë të pandehurit që të lejojë palën e mbrojtur të shfrytëzojë banesën të cilën e përdorin së bashku i pandehuri dhe pala e mbrojtur ose ndonjë pjesë të saj;
 - (j) T'ia urdhërojë të pandehurit që të paguajë qiranë ose hipotekën e banesës së përkohshme a të përhershme të palës së mbrojtur ose të paguajë alimentacionin për palën e mbrojtur dhe për ndonjë fëmijë për të cilin i pandehuri ka obligim për ta mbajtur;
 - (k) T'ia urdhërojë palës së mbrojtur që t'i kthehet fëmija i saj;
 - (l) T'ia jep palës së mbrojtur kujdestarinë e përkohshme për fëmijën e palës së mbrojtur;
 - (m) T'ia ndalojë të pandehurit ose palës së mbrojtur shitjen e çfarëdo pasurie brenda një periudhe të përkohshme dhe të caktuar;
 - (n) T'ia mundësojë palës së mbrojtur që vetëm ajo të posedojë dhe të shfrytëzojë pasurinë e caktuar personale të palës së mbrojtur;
 - (o) T'ia urdhërojë komisarit të policisë që të pezullojë ose të tërheqë lejen për armëmbajtje të lëshuar në bazë të Rregullores nr. 2001/7 të UNMIK-ut të datës 21 shkurt 2001 për autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë ose
 - (p) Të caktojë ndonjë masë tjetër që është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur apo personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare.
- (neni 2.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/12)
- Ankesa kundër vendimit përkitazi me kërkesën e urdhrit për mbrojtje ose vendimit për vërtetimin e urdhrit për mbrojtje emergjente duhet të parashtrohet brenda tetë (8) ditëve nga dita kur është lëshuar urdhri. (neni 11)

Urdhërat për mbrojtje emergjente

Komandanti kujdestar ose ushtruesi i detyrës së komandantit të njësitit rajonal të policisë së UNMIK-ut për dhunë në familje mund të lëshojë urdhërin për mbrojtje të përkohshme emergjente jashtë orarit të punës së gjykatave (neni 13.2 i rregullores). Ky urdhër mund të kërkohet nga të njëjtin persona të cilët mund të kërkojnë urdhërin mbrojtës, por këtë ia paraqesin organeve për zbatim të ligjit (policies) (neni 13.1). Nuk ka

ndonjë afat të caktuar për komandantin regjional për dhunë në familje që të lëshojë urdhërin emergjent. Këto masa janë paraparë si zgjidhje imediate dhe e përkohshme jashtë orarit të punës së gjykatave prandaj edhe pritet vendim i menjëhershëm. Vetëm masat nga neni 2.1 (a) deri në (c) të rregullores mund të shqiptohen përmes urdhërit emergjent (neni 13.2). Kohëzgjatja e urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente, skadon në fund të ditës së ardhshme gjatë të cilës gjykata punon(neni 13.3 (b)). Komandanti regjional për dhunë në familje për të lëshuar urdhërin emergjent duhet të konstatojë të njëjtat kushte që ekzistojnë edhe për urdhërin mbrojtës të pashikuara si më lart (neni 13.2 I Rregullores së UNMIK-ut 2003/12)

B. Mjetet juridike speciale për viktimat e trafikimit

Ligji në fuqi:

Nuk ka dispozita konkrete.

1. Ndhim për viktimat e trafikimit

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/4, mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë

Dëshmitë:

Rregullorja nuk i specifikon. Koordinator për ndihmë të viktimës, bështetet në deklaratën e viktimës, të dhënave policore (nëse ka), dhe të dhënave tjera që mund t'i ketë në posedim.

Rregullat e mbeldhjes së provave në fuqi sipas KPPPK.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Deri më tani ende nuk është hartuar skema e koordinatorit për ndihmë të viktimave, të cilën e obligon rregullorja.

Nuk është paraparë procedura ankimore në rast se refuzohet asistenca.

2. Viktimat e trafikimit – kërkesa për shpërblimin e dëmit/kthimit të sendit

Neni 6(3) i Rregullores 2001/4

Ligji në fuqi:

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/4, neni 6.3

“Një fond dëmshpërblimi për viktimat e trafikimit do të krijohet me urdhëresë administrative dhe do të ketë autorizime të pranojë mjete financiare, *inter alia*, edhe nga konfiskimi i pasurisë konform neni 6.1”

Dëshmitë:

Nuk janë specifikuar me rregullore.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Deri më tani, nuk është krijuar fondi për kompensim të viktimave të trafikimit.

6. Të drejtat e viktimës (palës së dëmtuar) në përgjithësi

Autoritetet kompetente që e kryejnë procedurën penale gjatë secilës fazë të

Ligji në fuqi:

Nuk ka dispozita specifike

Përshkrimi i mjetit juridik:

KPPPK nuk parashikon procedurë ankimore në rastet e mos përfilljes nga ana e

procedurës do t'i marrin autoriteteve kompetente.
parasyshë nevojat e palës së dëmtuar, veçanërisht të fëmijëve, (...) dhe viktimave të dhunës së bazuar në gjini ose dhunës seksuale

Neni 78 i KPPPK

VI. Çështjet pronësore juridike

A. Çështjet e përgjithshme pronësore

Kjo pjesë përshkruan mjetet juridike të cilat kanë të bëjnë me shkeljet e përgjithshme të të drejtave pronësore, të zbatueshme në pronën banesore dhe jo-banesore/komerciale. Për kategoritë specifike të pronave, referencë janë pjesët përkatëse të këtij dokumenti.

1. Heqja e pabazë e të drejtave pronësore

Parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me privimin nga prona.

Lexo pjesët tjera për mjetet juridike për kategoritë specifike të pronësisë.

Ligji në fuqi:

Nenet 37, 70-81, Ligji mbi marrëdhëniet themelore pronësore juridike (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 6/80)

Nenet 52, 56, 106, 185, 348, 350-57, 360, 382, 383, 388, Ligji mbi procedurën kontestimore (Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596),

Nenet 29, 31, Ligji mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

Lexo gjithashtu, Ligjin mbi procedurën jokontestimore (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 42/86) nëse është e zbatueshme.

Dëshmitë:

Lista poseduese si dhe dokumentacioni tjetër që dëshmon të drejtën pronësore-juridike të personit dhe se prona është *de facto* nën zotërimin e palës së paditur (neni 37(2), Ligji mbi marrëdhëniet themelore pronësore juridike).

Neni 106(3), I LPK: "...pala duhet që në parastresë t'i theksojë faktet në të cilat e bazon kërkesën, si dhe provat, kur kjo është e nevojshme." Nuk ka udhëzime tjera në ligj.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Ekzistojnë dy mjete juridike për paditësin: vetëndihma dhe mbrojtja gjyqësore në procedurë kontestimore (civile).

1. Vetëndihma lejohet nëse ekziston irreziku i drejtpërdrejtë dhe kur kjo është e domosdoshme dhe proporcionale për rrethanat e rastit (neni 76 i LMTHPJ-ke).
2. Mbrojtja gjyqësore ekziston në procedurën kontestimore në formë të:
 - *Mbrojtja gjyqësore nga trazimi* (neni 77, i LMTHPJ-ke), e cila mund të kërkohe brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e njoftimit për pengimin, e më së largu brenda afatit prej një viti nga dita e pengimit të bërë; ose
 - *Mbrojtja gjyqësore e posedimit në bazë të të së drejtës së posedimit* (neni 81, i LMTHPJ-ke). Ky mjet juridik nuk parashkruhet (neni 37 – 2 i i LMTHPJ-ke), përveç nëse me këtë ligj parashikohet ndryshe.

Për të filluar procedurën me mjete juridike sipas LPK-re:

- a. Ankesa duhet të paraqitet në formën e shkruar para gjykatës kompetente të shkallës së parë duke theksuar, çështjet parimore, faktet dhe bazat mbi të cilat mbështetet ankesa (neni 56, 106, 185, i LPK-re). Ju lutem, të keni parasyshë se disa prej ankesave hyjnë në kuadër të procedurës jokontestimore.
- b. Nëse palët nuk pajtohen me vendimin gjyqësor të shkallës së parë, ankesa mund të paraqitet brenda 15 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, përveç nëse me këtë ligj parashikohet ndryshe. Ankesa duhet t'i paraqitet gjykatës së shkallës së parë. Lexo nenin 343-357 për kushtet e ankesës.
- c. Pas pranimit dhe vendosjes së gjykatës së shkallës së dytë mbi ankesën, palët mund të kërkojnë revizionin e këtij vendimi nga Gjykata Supreme, brenda afatit prej 30 ditësh nga pranimi i aktgjykimit dhe të njëjtën t'ia paraqesë gjykatës së shkallës së parë (nenet 360, 382, 383, 388, të LPK-re). Lexo nenin 383, të LPK-re mbi revizionin.

a) Ndërprerja e pabazuar e hipotekës

Ligji në fuqi:
Gjithashtu lexo::

Nenin 18, 23, të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/21, mbi shpalljen e ligjit mbi hipotekën, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Dëshmitë:

Provat se parashtruesi i kërkesës i ka përbushur kushtet e përcaktuara me hipotekë nga debitori hipotekues (neni 23.1 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2002/21 apo se tenderi apo shitja nuk është realizuar sipas ligjit në fuqi (neni 23.1 (b) i Rregullores 2002/21.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike janë të mundshme përmes procedurës kontestimore. Lexo A1, Privimi i padrejtë i të drejtave pronësore, Përshkrimi i mjeteve juridike (nga teksti më lartë).

Sipas nenit 23.2, të Rregullores së UNMIK-ut 2002/21, parashtruesi i kërkesës duhet të aplikojë para gjykatës brenda 30 ditëve nga data e kontratës për shitblerje e lidhur sipas nenit 21 të rregullores.

2. Pengimi i pabazë i të drejtave pronësore

Parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me pengimin, lexo në vijim në pjesët tjerat të tekstit, mjetet juridike që kanë të bëjnë me kategoritë specifike të pronësisë

Ligji në fuqi:

Nenet 42, 70-81, të LMTHPJ-ke (Gazeta Zyrtare RSFJ, No. 6/80)
Nenet 52, 56, 106, 185, 348, 350-57, 360, 382, 383, 388, të LPK-re (Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596),

Lexo gjithashtu LPJK-re (Gazeta Zyrtare KSAK, No. 42/86)

Nenet 29, 31, të Ligjit mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, No. 21/78)

Kreu XXIII, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, aty ku është i zbatueshëm Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale

Ligjin mbi kundërvajtjet (Gazeta Zyrtare e KSAK 23/79)

(lexo Kreun V, viktimat e krimit A 2, A4, viktimat e kundërvajtjeve, ligjin në fuqi)

Pyjet dhe toka pyjore

Neni 28.2, 28.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/6 për shpalljen në fuqi të ligjit për pyjet të miratuar nga Kuvendi i Kosovës

Dëshmitë:

Lista poseduese si dhe dokumentet tjera provuese mbi të drejtat pronësore të titullarit dhe se pengim posedimi ka ndodhur.

Neni 106(3), i LPK-re: "...pala duhet që në parastresë t'i theksojë faktet në të cilat e bazon kërkesën, si dhe provat, kur kjo është e nevojshme." Nuk ka udhëzime tjera në ligj.

Lexo Kreun V, viktimat e krimit A 2, viktimat e krimit/palët e dëmtuara; prona e dëmtuar ose e humbur dhe A4 viktimat e kundërvajtjeve, dëshmitë, atëherë kur është e zbatueshme.

Përshkrimi i mjeteve juridike:

Mjetet juridike janë të mundshme përmes procedurës kontestimore. Lexo Kreun VI, Çështjet pronësore, A1 Privimi i padrejtë i të drejtave pronësore, Përshkrimi i mjeteve juridike (nga teksti më lartë).

Krahas kësaj, neni 42(2), i LMTHPJ-ke, parashikon të drejtën e pronarit që të kërkojë

shpërblimin e dëmit pëmres procedurës kontestimore (neni 52 i LPK-re)

Nëse kualifikimi është për vepër penale, atëherë mund të inicohet procedura penale ose kundërvajtëse

Kur pengim i të drejtave pronësore është rezultat i kundërvajtjes atëherë mund të inicohet procedura penale ose kundërvajtëse. Lexo Kreun V, viktimat e krimit A 2, viktimat e krimit/palët e dëmtuara; prona e dëmtuar ose e humbur dhe A4 viktimat e kundërvajtjeve.

a) Përmes okupimit të kundërligjshëm/pengim posedimit

Shënim: Mundësia e ankesës (mjetit juridik) kundër okupimit joligjor, skadon atëherë kur të plotësohen kushtet për fitimin e pronës me parashkrim fitues. Përfshinë dispozita specifike për "pronën shoqërore të privatizuar"

Krahas kësaj, kontestet mbi pengim posedimin e përjashtojnë të drejtën e posedimit, pakujesinë dhe dëmet.

Ligji në fuqi:

Posedimi me mirëbesim/përvetësimi(okupimi) joligjor.

Nenet 28-30, 32, 46, të LMTHPJ-ke

Neni 4 i Rregullores 2003/13 mbi transformimin e të drejtës për shfrytëzim të pronës shoqërore

Neni 259 i Kodit Penal të Kosovës

Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale

Ligjin mbi kundërvajtjet (Gazeta Zyrtare e KSAK 23/79)

Pengim posedimi:

Nenet 348-445, të LPK-re

Kontestet mbi kufinj të (megjat):

Nenet 161-171, të LPJK-re

Dëshmitë:

Neni 106(3), i LPK-re: "...pala duhet që në parashtrësë t'i theksojë faktet në të cilat e bazon kërkesën, si dhe provat, kur kjo është e nevojshme." Nuk ka udhëzime tjera në ligj.

Okupimi joligjor: Duhet të ofrohen prova se nuk janë plotësuar kushtet për fitimin e pronës përmes parashkrimit fitues (p.sh, në kundërshtim me nenet 28-30, 32, 46, të LMTHPJ). Në procedurë penale ju lutemi të siguroni prova ashtu siç kërkohet me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/26.

Kontestet e kufinjëve (megjave): duhet të ofrohen shënimet që kanë të bëjnë me parcelat pronarëve dhe shfrytëzuesve fqinjë të tokave nga librat publik të regjistrimit të tokës (kadastrit) (neni 163(2), i LPJK-re)

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike janë të mundshme përmes procedurës kontestimore. Lexo Kreun VI, Çështjet pronësore, A1 Privimi i pabazë i të drejtave pronësore, Përshkrimi i mjeteve juridike (nga teksti më lartë). Mirëpo, mund të zbatohen afatet kohore të veçanta.

Okupimi joligjor: Mjeti juridik duhet të kërkohet para se të transformohet okupimi joligjor në fitim të pronës përmes parashkrimit fitues (neni 28-30, 32,46, i LMTHPJ-ke.

Pengim posedimi: Padia duhet të ngritet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita kur bartësi i të drejtës është njoftuar për pengimin dhe penguesit, dhe jo më largë se një vitë prej ndodhjes së pengimit.

b) Përmes dëmtimit të sendit

Kjo i referohet dëmit ndaj sendit të paluajtshëm që mund të kualifikohet si vepër penale.

Ligji në fuqi:

Nenet 271, 291 (1,3,5) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK)

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale

Nenet 118-122, të Ligjit mbi Kundërvajtjet (Gazeta Zyrtare KSAK, 23/79)

Dëshmitë:

Sigurimi i provave sipas Pjesës II të Rregullores 2003/26 mbi KPPPK a.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Inicimi i procedurës penale ose kundërvajtëse

Lexo Kreun V, viktimat e krimit A 2, viktimat e krimit/palët e dëmtuara; prona e dëmtuar ose e humbur dhe A4 viktimat e kundërvajtjeve, përshkrimi i mjetit juridik.

c. Përmes ndërtimit pa leje (parimet e përgjithshme)

Lexo Pjesën C për mjetet juridike specifike për ndërtimet

Liqi në fuqi:

Gjithashtu lexo:

Nenet 24-26, 42(2), 70-81, të LMTHPJ (Gazeta Zyrtare RSFJ 6/80)

Pjesë relevante të Rregullres 2003/30 mbi planifikimin hapsinor (ligji i miratuar nga Kuvendi i Kosovës)

Neni 294, i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale

Ligji mbi Kundërvajtjet (Gazeta Zyrtare KSAK, 23/79)

Dëshmitë:

Lexo Kreun VI, Çështjet pronësore A1 (a) Heqja e pabazë e të drejtave pronësore, Dëshmitë

Për këtë shkelje duhet të provohet në mënyrë specifike në mes tjerash:

- se personi që ndërton a ka qenë i vetëdijshëm se e drejta pronësore i takon dikujt tjetër
- se bartësi i të drejtës pronësore ishte i vetëdijshëm se dikush tjetër po ndërton në pronën e tij
- se a është më i vlefshëm objekti i ndërtimit se sa vet toka

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike janë të mundshme përmes procedurës kontestimore. Lexo A1 Privimi i pabazë i të drejtave pronësore, Përshkrimi i mjeteve juridike (nga teksti më lartë).

Afatet e caktuara brenda të cilave mund të shfrytëzohet mjeti juridik për kategoritë e ndërtimeve pa leje janë paraparë në nenin 23(2), 24(2), 25(5) dhe 26(2).

Kur ndërtimi i paautorizuar përbën vepër penale mund të iniciohet procedura penale ose kundërvajtëse. Lexo Kreun V, viktimat e krimit A 2, viktimat e krimit/palët e dëmtuara; prona e dëmtuar ose e humbur dhe A4 viktimat e kundërvajtjeve, përshkrimi i mjetit juridik

d. Përmes aplikimit të pabazë të procedurës së servitutit

Liqi në fuqi

Nenet 49-60 të LMTHPJ

Dëshmitë:

Lexo Kreun VI, Çështjet pronësore E1 (a) Heqja e pabazë e të drejtave pronësore, Dëshmitë

Përveç kësaj shkeljeje, duhet të provohet se servituti nuk i plotëson kushtet e specifike të përcaktuara në nenet 50-53, 58, të LMTHPJ-ke

.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike janë të mundshme përmes procedurës kontestimore. Lexo A1 Privimi i pabazë i të drejtave pronësore, Përshkrimi i mjeteve juridike (nga teksti më lartë).

C. Regjistrimi i patundshmërive / Kadastri

Kjo pjesë përshkruan mjetet juridike që kanë të bëjnë me shkeljet që burojnë nga regjistrimi, kategorizimi dhe matja e tokës. Këto elemente ndikojnë në natyrën dhe pasojat e të drejtave pronësore juridike.

Kjo fushë e legjislacionit pronësor ende është në rrjedhë e sipër për shkak të revidimeve të vazhdueshme në këtë kornizë ligjore si dhe për shkak të pengesave praktike në realizimin e saj.

1. Refuzimi i pabazë i regjistrimit të të drejtave pronësore, përfshirë edhe të drejtën hipotekare

Që të drejtat pronësoro-juridike mbi patundshmëritë të jenë të efektshme, këto të drejta duhet të regjistrohen në mënyrë të duhur. Bartja e pronësisë është e plotë vetëm pasi të regjistrohet (neni 3 dhe 7 i Rregullores 2002/22 mbi themelimin e regjistrimit për të drejtat në pronën e palujtshme.

Njëherë pasi të themelohet institucioni për regjistrim (kadastrin), të gjitha shitblerjet e patundshm. duhet të regjistrohen për t'u konsideruar të plotëfuqishme (neni 7, i Rregullores 2002/22)

Ligji në fuqi:

Neni 4-6, i Rregullores 2002/22së UNMIK-ut për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi themelimin e regjistrimit për të drejtat në pronën e palujtshme.
Neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/27 për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për ndryshimet dhe amandamentet ndaj ligjit 2002/5 mbi themelimin e regjistrimit për të drejtat në pronën e palujtshme
Neni 7-8 i Rregullores 2002/21 mbi shpalljen e ligjit mbi hipotekat (ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës)
Ligji për procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, No. 47/86)
Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, No. 4/77)
Neni 31, Ligjit mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, No. 21/78)

Dëshmitë:

Dokumentacioni i plotë dhe valid, siç është kontrata e vërtetuar mbi shitblerjen, që paditësi ka të drejtë në patundshmëri (neni 3.4 i Rreg 2002/22). Mënyrat e të provuarit janë të parapara me nenet 159 – 201 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative (LPPA)

Përshkrimi i mjetit juridik:

Ekzistojnë dy mjete juridike për paditësin (parashtruesin e kërkesës): kërkesa për rishqyrtimin e vendimit dhe kërkesa për ndryshime në regjistër.

Kërkesa për rishqyrtimin e vendimit të Zyrës kadastrale komunale (ZKK):

- a) Parashtruesi i kërkesës mundet që brenda tridhjet (30) ditësh, nga dita që është informuar me shkrim nga ZKK-ja për refuzimin e regjistrimit të të drejtës së pronës së palujtshme, të kërkojë nga ZKK-ja rishqyrtimin e vendimit (neni 4.1, i Rregullores së UNMIK-ut 2002/22). ZKK-ja do të marrë vendim se a do të regjistrojë ose jo të drejtën e pronës së palujtshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për rishqyrtim.
- b) Nëse ZKK nuk e ndryshon aktvendimin refuzues, kërkesa për rishqyrtim të këtij aktvendimi mund t'i paraqitet Agjencionit Kosovar të Kadastrit (AKK), brenda 30 ditësh nga pranimi i vendimit refuzues me shkrim. Nuk është paraparë afati për përgjigje nga AKK.
- c) Pas vendimit të AKK, ankesa mund të paraqitet edhe para Gjykatës Supreme, kundër aktvendimit të organeve komunale (neni 31 i Ligjit mbi gjykatat e rregullta). Afati për fillimin e procedurës administrative është 30 ditë nga ekzekutimi i aktvendimit, apo 60 ditë nëse pala nuk e ka pranuar të njëjtin (neni 23 i Ligjit mbi konfliktin administrativ).
- d) Kërkesa për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor mund të parashtrohet kundër vendimit të nxjerrë në procedurën e konfliktit administrativ (neni 19-20, 45-50, I Ligjit mbi konfliktin administrativ (LKA)

Kërkesa për ndryshimin në regjistër

- a. Nëse dëshirohet të kontestohet regjistrimi i të drejtës në patundshmëri, kërkesa mund

- t'i parashtrohet ZKK për të plotësuar regjistrin me vërejtjet protestuese ndaj regjistrin duke u bazuar në mosekzistimin e bazës juridike apo në shkeljet e të drejtave pronësore të parashtruesit të kërkesës (neni 5.1, i Rregullores së UNMIK 2002/22).
- b. Të njëjtat kushte dhe procedura për regjistrimin e të drejtave, nevojiten edhe për kërkesën për ndryshim (neni 5.3, i Rregullores së UNMIK-ut 2002/22)
 - c. Për t'u futur në regjistër, gjykata kompetente apo DÇPB-re apo organi tjetër kompetent duhet të nxjerrë vendimin përkatës (neni 5.4, i Rregullores së UNMIK-ut 2002/22)

2. Refuzimi i pabazë i rigjistrimit të ndryshimeve në kadastër

Kadastri dallon nga regjistri i të drejtave në pronë të palujtshme. Kryesisht në kadastër shënohen të dhënat teknike që kanë të bëjnë me patundshmërinë. Gjithashtu kontrollohet administrativisht nga AKK. nenet 8-11 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/4 për shpalljen e ligjit për kadastrin, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës

Ligji në fuqi:

Nenet 19-20 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/4 për shpalljen e ligjit për kadastrin, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës.
Ligji për procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, No. 47/86)
Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, No. 4/77)
Neni 31, Ligjit mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, No. 21/78)

Dëshmitë:

Dokumentacioni i plotë dhe valid, përfshirë edhe provat mbi të drejtën pronësore dhe shënimet tjera dhe të dhënat (neni 9-13, të Rregullores së UNMIK-ut 2004/4). Mënyrat e të provuarit janë të parapara me nenet 159 – 201 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative (LPPA).

Përshkrimi i mjetit juridik:

- a) Parashtruesi i kërkesës mundet që brenda tridhjet (30) ditësh, nga dita që është informuar me shkrim nga ZKK-ja për refuzimin e regjistrimit të të drejtës së pronës së palujtshme, të kërkojë nga ZKK-ja rishqyrtimin e vendimit (neni 4.1, i Rregullores së UNMIK-ut 2002/22). ZKK-ja do të marrë vendim se a do të regjistrojë ose jo të drejtën e pronës së palujtshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për rishqyrtim.
- b) Nëse ZKK nuk e ndryshon aktvendimin refuzues, kërkesa për rishqyrtim të këtij aktvendimi mund t'i paraqitet Agjencionit Kosovar të Kadastrit (AKK), brenda 30 ditësh nga pranimi i vendimit refuzues me shkrim. Nuk është paraparë afati për përgjigje nga AKK.
- c) Pas vendimi të AKK, ankesa mund të paraqitet edhe para Gjykatës Supreme, kundër aktvendimit të organeve komunale (neni 31 i Ligjit mbi gjykatat e rregullta). Afati për fillimin e procedurës administrative është 30 ditë nga ekzekutimi i aktvendimit, apo 60 ditë nëse pala nuk e ka pranuar të njëjtin (neni 23 i Ligjit mbi konfliktin administrativ).
- d) Kërkesa për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor mund të parashtrohet kundër vendimit të nxjerrë në procedurën e konfliktit administrativ (neni 19-20, 45-50, i Ligjit mbi konfliktin administrativ (LKA)

3. Mohimi i pabazë i qasjes në shënimet kadastrale/të dhënat e regjistrit.

Kadastrri dhe regjistri janë dokumente publike. Neni 3 i Rregullores së UNMIK-ut 2002/22, për themelimin e regjistrit dhe Rregullorja 2004/4 për ligjin për kadastrin të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

Organet krahinore apo komunale nuk i lëshojnë shënimet kadastrale apo ato mbi matjet siç janë: kopjet e planeve, përshkrimet, shembujt e kushteve etj.

Mohimi i lëshimit të këtyre dokumenteve mund të ndikojë në të drejtat pronësore kur këto dokumente nevojiten për tjetërisimin apo shfrytëzimin tjetër të pronës për të cilën punë nevojiten këto dokumente.

Ligji në fuqi:

Neni 3-7, i Rregullores 2002/22 të UNMIK-ut për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për themelimin e regjistrit për të drejtat në pronën e palujtshme, të ndryshuar me Rregulloren të UNMIK-ut 2003/27 për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për ndryshimet dhe amendamentet ndaj ligjit 2002/5 mbi themelimin e regjistrit për të drejtat në pronën e palujtshme.

Nenet 22 dhe 30 të Rregullores 2004/4 për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për Kadastër.

Kreu 4, neni 9.4.2, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë

Ligji për procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, No. 47/86)

Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, No. 4/77)

Neni 31, Ligjit mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, No. 21/78)

Dëshmitë:

Prova se kërkesa është bërë para organit përkatës me të cilin nuk pajtohet, sikur që janë letër-kërkesat apo refuzimi nga organi administrativ. Mënyrat e të provuarit janë të parapara me nenet 159 – 201 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative (LPPA).

Përshkrimi i mjetit juridik:

Sipas Rregullores 2002/22 dhe 2004/4, Zyrtat Komunale Kadastrale janë nën mbikqyrjen administrative dhe autoritetin e AKK dhe jo nën pushtetin komunal kështu që nuk zbatohen udhëzimet komunale e as statutet e tyre por as neni 35 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/45/

Për mohimin e padrejtë të qasjes në shënimet kadastrale duket se mund të zbatohet neni 30 i Rregullores 2004/4 edhe pse nuk është e qartë se si mund ta përdorin palët këtë dispozitë. Kjo dispozitë e autorizon inspektorin e AKK të mbikqyrë dhe implementojë ligjin, përfshirë edhe nenin 22 i cili garanton qasjen për të gjithë në këto shenime dhe rekomandon masat e mëtutjeshme por edhe ato korrigjuese. AKK pastaj mund të urdhërojë implementimin e këtyre rekomandimeve. Ankesa kundër urdhërësës së AKK mund t'i bëhet Ministrisë së Shërbimeve Publike brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së vendimit. Mjete tjera specifike nuk janë përkufizuar, por mund të zbatohen mjetet juridike të përgjithshme të parapara me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative.

- a. Në këtë rast, ankesa duhet t'i parashtrohet ZKK e cila ia kalon atë AKK si shkallë e dytë (neni 238 i LPPA). AKK jepë përgjigje brenda dy muajve nga data e dorëzimit (neni 246 i LPPA).
- b. Ankesa kundër vendimit të ZKK mund të paraqitet para Gjykatës Supreme (neni 20.3, Rregullorja 2004/4 dhe neni 31 i Ligjit mbi gjykatat e rregullta). Afati për fillimin e konfliktit administrativ me padi, është 30 ditë nga dërgimit të vendimit palës, dhe 60 ditë nga dita e dërgimit të aktvendimit dhe pala nuk e ka pranuar këtë të fundit (neni 23-24, LKA)
- c. Gjithashtu, mund të kërkohet rishqyrtimi i jashtëzakonshëm i vendimit gjyqësor, kundër aktvendimit mbi konfliktin administrativ (neni 19-20, 45-50, LKA). Kërkesa i dërgohet gjykatës kompetente brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të vendimit kundër të cilit pala paraqet kërkesën.

Gjithashtu lexo, kreun IV, mosdiskriminimi, neni 1, mjet i përgjithshëm juridik, ligji në fuqi dhe përshkrimi i mjeteve juridike.

4. Matja dhe klasifikimi (kategorizimi) i gabuar i tokës

Matjet dhe klasifikimet bëhen për parcelat e reja dhe të transferuara dhe për rindërtimin e informacioneve (nenet 14,29 të Rregullres 2004/4 për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për Kadastër Shfrytëzuesi i tokës nuk pajtohet me

Ligji në fuqi:

Neni 21, i Rregullores 2004/4 për shpalljen e ligjit për Kadastër, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Ligji për procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, No. 47/86)

Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, No. 4/77)

Neni 31, Ligjit mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, No. 21/78)

Rindërtimi i informacioneve

Neni 29(4)-(6), i Rregullores 2004/4 për shpalljen e ligjit për Kadastër, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës

Të dhënat ekzistuese

Nenet 32(3), i Rregullores 2004/4 për shpalljen e ligjit për Kadastër, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës

rezultatet e matjes dhe kategorizimit të bërë nga organet përkatëse.

Dëshmitë:

Nevojitet kundërshtimi me shkrim ndaj të dhënave të paraqitura, me theks të veçantë në arsyet për kundërshtim si dhe provat e duhura, siç janë, analizat e dheut, matjet alternative (neni 56 (1), të LMKT). Mënyrat e të provuarit paralexoen në nenet prej 159 – 201 të LPPA

Përshkrimi i mjetit juridik:

Në përgjithësi

Nuk ka mjete specifike për kundërshtimin e matjeve në përgjithësi, përveç dispozitës së përgjithshme që përmirësimi i informacioneve të cilat dukshëm janë të gabueshme mund të bëhet menjëherë nëse është e qartë se këto mund të shkojnë në dëm të bartësit të të drejtës. Nëse kjo mund të shkojë në dëm të bartësit të të drejtës atëherë këtij të fundit i jepet mundësia e dëgjimit po qe se është i njoftur.

Nuk është e qartë se kush mund t'i drejtohet ZKK për të inicuar një përmirësim të tillë, por duket se kjo i mundësohet bartësit të të drejtës pronësore. Për bartësin e të drejtës pronësore i cili është i prekur me këtë përmirësim, nuk është e qartë me atë se çfarë nënkuptohet me “dëgjim” por ankuesi mund t'i referohet Ligjit për procedurë administrative. Lexo Kreun VI çështjet pronësore, B3, mohimi i padrejtë i të qasjes në informatat e regjistrit/kadastrit, përshkrimi i mjetit juridik si më lart.

N.B. sipas standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, nevojiten përpjekje të arsyeshme për përmirësimin e të drejtave pronësore të prekura.

Rindërtimi i informacioneve

- a. Komisioni do të bëjë një shpallje publike. Kjo shpallje do të shfaqet gjatë gjashtëdhjetë (60) ditëve. Gjatë kësaj periudhe është e mundur të kontestohet rezultati. Nëse nuk ka konteste, AKK-ja do të vendosë që zona kadastrale është e rindërtuar.
- b. Nëse ka konteste kundër disa pjesëve të hartës, komisioni do të ftojë palët e interesuara në një seancë dëgjimi verbal. Nëse nuk arrihet marrëveshja gjatë seancës, komisioni do të propozojë një zgjidhje. AKK-ja atëherë do të vendosë nëse zona kadastrale është e rindërtuar.
- c. Nëse bartësi I të drejtës pronësore nuk e ka nënshkruar marrëveshjen, ankes mund të ngritet para Gjykatës Supreme kundër vendimit të AKK (neni 29.6 I Rregullres 2004/4) dhe neni 31 të Ligjit për gjykatat e rregullta. Afati për konfliktin administrativ është 30 ditë nga dorëzimi I vendimit palës, dhe 60 ditë nga dita e dërgimit të aktvendimit dhe pala nuk e ka pranuar këtë të fundit (neni 23-24, LKA)
- d. Gjithashtu, mund të kërkohet rishqyrtimi i jashtëzakonshëm i vendimit gjyqësor, kundër aktvendimit mbi konfliktin administrativ (neni 19-20, 45-50, LKA). Në çdo rast, i dërgohet gjykatës kompetente brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të aktvendimit të kontestuar (neni 46 i LKA).

Të dhënat ekzistuese

- a. Kërkesa për shqyrtimin e të dhënave të reja bazuar në shënimet ekzistuese kadastrale mund t'i paraqitet AKK. Nuk është paraparë afati brenda të cilit AKK duhet të vendosë por duhet të jetë brenda dy muajve nga dita e dërgimit (neni 246 i LPPA).
- b. Kundër vendimit të Agjensisë lejohet ankesa në Ministrinë e Shërbimeve Publike, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të tij. Ankesa ushtrohet përmes Agjensisë.
- c. Kundër vendimit të AKK mund të ngritet ankesa pranë Gjykatës Supreme (neni 20.3, I Rregullores 2002/4 dhe neni 31 të Ligjit për gjykatat e rregullta). Afati për konfliktin administrativ është 30 ditë nga dorëzimi I vendimit palës, dhe 60 ditë nga dita e dërgimit të aktvendimit dhe pala nuk e ka pranuar këtë të fundit (neni 23-24, LKA).
- d. Gjithashtu, mund të kërkohet rishqyrtimi i jashtëzakonshëm i vendimit gjyqësor, kundër aktvendimit mbi konfliktin administrativ (neni 19-20, 45-50, LKA). Në çdo rast, i dërgohet gjykatës kompetente brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të aktvendimit të kontestuar (neni 46 i LKA).

5. Dëmi i shkaktuar për shkak të matjes gjeodezike

Ligji në fuqi:

Neni 27, i Rregullores 2004/4 për shpalljen e ligjit për Kadastër, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës

Ligji për procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, No. 47/86)

Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, No. 4/77)
Neni 31, Ligjit mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, No. 21/78)

Dëshmitë:

Nevojitet, prova (dëshmia) se dëmi është shkaktuar, dhe kjo si rezultat i matjes së kryer nga organi përkatës. Paditësi mund të paraqesë fotografitë e tokës në fjalë, dëshmitë e dëshmitarëve dhe kërresën e parashtruar organeve përkatëse për të shkuar në vendin e ngjarjes. Paditësi duhet të sigurojë dokumente të cilat konstatojnë vlerën në të holla të dëmit të shkaktuar. Mënyrat e të provuarit paralexoen në nenet 159-201, të LPPA.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Nëse është bërë ndonjë dëmtim nga masat e përmendura në këtë nen dhe pala e dëmtuar kërkon të kompensojë dëmin, pala duhet të paraqesë ankesën për këtë para përfundimin apo anulimit të procedurës kadastrale (neni 27 i Rregullores 2004/4).

Mjeti juridik realizohet përmes procedurës administrative e cila zbatohet për aktet administrative. Lexo Kreun VI. nenin B.2, mohimi i pabazë i qasjes në shënimet kadastrale, dhe përshkrimin e mjetit juridik më lartë.

Padia për dëmshpërblim duhet të ngritet para organit/organizatës e cila e ka shkaktuar dëmin e pohuar (neni 28(4), i LMKT; neni 5, 49-52, i LPPA)

6. Caktimi i pabazë i gjobës (lartësisë së saj)

Kryesisht për gjobat vijuese: për mos respektimin e dispozitës për të lehtësuar matjet, mirëmbajtjen apo kadastrin e tokave; mos njoftimin e organeve komunale për ndryshimet në tokë apo objekteve mbi tokë dhe mos vënjen e shenjave të dukshme me rastin e ndryshimeve. Lexo nenet 31.1 dhe 31.2 të Rregullres së UNMIK-ut 2004/4

Ligji në fuqi:

Neni 31, i Rregullores 2004/4 për shpalljen e ligjit për Kadastër, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Ligji për procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, No. 47/86)

Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, No. 4/77)

Neni 31, Ligjit mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, No. 21/78)

Dëshmitë:

Mënyrat e të provuarit paralexoen në nenet prej 159 – 201 të LPPA.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjeti juridik realizohet në procedurën administrative. Lexo Kreun VI, B.3, mohimi i pabazë i qasjes në shënimet kadastrale, dhe përshkrimin e mjetit juridik më lartë.

Dështimi i organeve komunale për të njoftuar titullarët e pronës për ndryshimet në shënimet kadastrale

Sipas neni 21 të Rregullores 2004/4, ZKK është e obliguar t'i njoftojë shfrytëzuesit e

Ligji në fuqi:

Neni 21, i Rregullores 2004/4 për shpalljen e ligjit për Kadastër, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës

Ligji për procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, No. 47/86)

Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, No. 4/77)

Neni 31, Ligjit mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, No. 21/78)

Dëshmitë:

Duhet siguruar prova se se ndryshimet janë bërë pa njoftim. Mënyrat e të provuarit

tokave për ndryshimet e bëra dhe sipas nevojës të organizojë dëgjim për ta.

paralexoen në nenet prej 159 – 201 të LPPA

Përshkrimi i mjetit juridik

Nuk ka mjete specifike për kundërshtimin e matjeve në përgjithësi, përveç dispozitës së përgjithshme që përmirësimi i informacioneve të cilat dukshëm janë të gabueshme mund të bëhet menjëherë nëse është e qartë se këto mund të shkojnë në dëm të bartësit të të drejtës. Nëse kjo mund të shkojë në dëm të bartësit të të drejtës atëherë këtij të fundit i jepet mundësia e dëgjimit po qe së është i njoftur.

Nuk është e qartë se kush mund t'i drejtohet ZKK për të inicuar një përmirësim të tillë, por duket se kjo i mundësohet bartësit të të drejtës pronësore. Për bartësin e të drejtës pronësore i cili është i prekur me këtë përmirësim, nuk është e qartë me atë se çfarë nënkuptohet me “dëgjim” por ankuesi mund t'i referohet Ligjit për procedurë administrative. Lexo Kreun VI çështjet pronësore, B3, mohimi i padrejtë i të qasjes në informatat e regjistrit/kadastrit, përshkrimi i mjetit juridik si më lart.

N.B. sipas standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, nevojiten përpjekje të arsyeshme për përmirësimin e të drejtave pronësore të prekura.

D. Bartja e pronës dhe eksproprijimi (shpronësimi)

Kjo pjesë përshkruan mjetet juridike kundër bartjes së pronësisë.

Bartjet e pasurisë në pronësi shoqërore janë të përjashtuara pasi që Agjencioni i ri i Kosovës i Mirëbesimit, ende nuk i ka sqaruar çështjet e mbetura juridike në këtë fushë.

1. Heqja e pabazë e të drejtave pronësore përmes bartjes joligjore të pronës së paluajtshme.

Duke përfshirë bartjen procedurën trashëgimore dhe bartjen e pronës shoqërore.

Duke përfshirë bartjen e kryer nga pala e tretë pa bazë juridike.

Liqi në fuqi:

Pjesë të caktuara të Ligjit mbi marrëdhëniet detyrimore (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 29/1978, 39/1985, 45/1989, 31/1993)
Nenet 37, 70-81, LMTHPJ (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 6/80)
Nenet 52, 56, 106, 185, 348, 350-57, 360, 382, 383, 388, Ligji mbi procedurën kontestimore (Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596),
Ligji mbi shitblerjen e patundshmërive (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 43/81-3050)

Dëshmitë:

Dëshmia se bartja është bërë sipas ligjit dhe mund të përfshijë listën poseduese dhe dokumentet tjera të cilat provojnë të drejtat pronësore të parashtresit të kërkesës.

Neni 106(3), Ligji: "...pala duhet që në parashtresë t'i theksojë faktet në të cilat e bazon kërkesën, si dhe provat, kur kjo është e nevojshme." Nuk ka udhëzime tjera në ligj..

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike në kuadër të procedurës civile. Lexo A.1, Heqja e pabazë e të drejtave pronësore, Përshkrimi i mjetit juridik.

a) Për shkak të mosrespektimit të të drejtës së privilegjuar (përparësisë së blerjes)

Sipas Ligjit mbi shitblerjen e patundshmërive, me rastin e tjetërsimit (bartjes) së të drejtës pronësore të tokës bujqësore, ndërtimore, banesës dhe lokalit afarist, së pari duhet t'i ofrohet titullarëve të privilegjuar (me përparësi të blerjes) neni 19-22, i LSHP).

Liqi në fuqi::

Gjithashtu:
Nenet 19-22, 26-26a, të Ligjit mbi shitblerjen e patundshmërive (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 45/81, 29/86)

Dëshmitë:

Sigurimi i dëshmisë se oferta i është bërë pronarit të privilegjuar në pajtim me nenin 19-22, të LSHP.

Lexo A.1, heqja e pabazë e të drejtave pronësore, dëshmitë.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike, realizohen përmes kontestit gjyqësor. Lexo pjesën A.1, heqja e pabazë e të drejtave pronësore, dëshmitë.

Në veçanti, blerësi i privilegjuar, me padi mund të kërkojë anulimin e kontratës në mënyrë që prona t'i shitet atij nën kushtet e njëjta të kontratës, brenda një viti nga dita kur blerësi ka kuptuar për shitjen e patundshmërisë, apo brenda tre vitesh nga dita e lidhjes së kontratës. Ose nëse kontrata nuk është lidhur në pajtim me Ligjin në fjalë dhe këtë e posedon blerësi, atëherë procedura sipas mjetit juridik duhet të fillojë brenda një viti prej kur ka kuptuar mbi shitblerjen neni 26, 26a).

Shënim: Mundësia e aplikimit të këtij mjeti juridik mbetet e paqartë. Struktura e tanishme e UNMIK-ut nuk i ka mbajtur shumë prej strukturave ekonomike dhe komunale të themeluara nga regjimet e kaluara të sistemit komunist të cilave u referohet ky ligj. Krahas kësaj, gjasat janë të mëdha se shumë prej këtyre procedurave ose janë shfuqizuar përmes ligjeve për privatizim të miratuara gjatë regjimit të vitit 1990, apo thjeshtë janë vënë në pikëpyetje nga paraktika.

2. Heqja e pabazë e të drejtave pronësore përmes vendimit të pabazë mbi trashëgiminë

Liqi në fuqi::

Neni 19-20, 26, 94-137, i Ligjit mbi procedurën jokontestimore (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 42/86)
Nenet 37, 70-81, LMTHPJ (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 6/80)
Nenet 56, 106, 185, 348, 350-57, 360, 382, 383, 388, LPK (Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596)
Neni 7, i LSHP (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 43/81-3050)

Dëshmitë:

Sigurimi i dëshmimeve se trashëgimia nuk është bërë sipas ligjit (nenet e cituara më lartë të LPJK)

Neni 106(3), i LPK: "...pala duhet që në parashtrësë t'i theksojë faktet në të cilat e bazon kërkesën, si dhe provat, kur kjo është e nevojshme." Nuk ka udhëzime tjera në ligj.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Procedura me mjetet juridike realizohet në procedurën kontestimore, pranë gjykatës civile. Lexo A.1, heqja e pabazë e të drejtave pronësore, dëshmitë.

3. Ekspropriimi – heqja e pabazë e të drejtave pronësore

Ligji në fuqi:

Neni 2-3d, 22-24, i Ligjit mbi ekspropriimin (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78, 46/86)
Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 4/77)
Neni 31, Ligji mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

a) Bazuar në "përcaktimin e pabazë të interesit të përgjithshëm"

Dëshmitë:

Duhet të sigurohet dëshmia se ekspropriimi nuk është në interes të përgjithshëm dhe nuk është i nevojshëm për ndërtimin e objekteve të interesit të përgjithshëm (neni 2 i Ligjit mbi ekspropriimin LE). Neni 27 i LKA parashikon mënyrën e të provuarit.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike realizohen në procedurën e administrative (neni 3d i LE).

- d. ankesa mund të paraqitet edhe para Gjyqit Suprem, kundër aktvendimit të organeve komunale (neni 31 i Ligjit mbi gjykatat e rregullta). Afati për fillimin e procedurës administrative është 30 ditë nga ekzekutimi i aktvendimit, apo 60 ditë nëse pala nuk e ka pranuar të njëjtin (neni 23 i Ligjit mbi konfliktin administrativ).
- e. Kërkesa për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor mund të parashtrohet kundër vendimit të nxjerrë në procedurën e konfliktit administrativ (neni 19-20, 45-50, i Ligjit mbi konfliktin administrativ (LKA). Kërkesa i dërgohet gjykatës kompetente brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të vendimit kundër të cilit pala paraqet kërkesën.

Ankesa nuk e pezullon procedurën e ekspropriimit.

Mirëpo, nëse nuk aprovohet "përcaktimi i interesit të përgjithshëm" atëherë si pasojë edhe "vendimi mbi ekspropriimin" refuzohet (neni 3d, i LE).

b) Në bazë të "vendimit" të pabazë për lejimin e punëve përgatitore.

Ligji në fuqi:

Neni 7-10, i LE (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78, 46/86)
Section 35, UNMIK Regulation 2000/45, On Self-government of Municipalities
Udhëzimet e caktuara komunale
Ligji i procedurës së përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 47/86)
Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 4/77)
Neni 31, Ligji mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

Dëshmitë:

Prova se vendimi nuk ka bazë juridike. Mënyrat e të provuarit paralexoen në nenet prej 159 – 201 të LPPA

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike realizohen në procedurën aktit administrativ pranë organeve komunale. Lexo pjesën B2, Qasja e pabazuar në shënimet kadastrale, Përshkrimi i mjetit juridik si më lartë.

c) Bazuar në "vendimin" e pabazë mbi ekspropriimin "nga organi komunal kompetent".

Ligji në fuqi:

Neni 15-17, i LE (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78, 46/86)
Neni 35, Rreg. UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave
Udhëzimet e caktuara komunale
Ligji i procedurës së përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 47/86)
Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 4/77)

Ju lutem vëreni

gjithashtu: Mirëpo,
nëse nuk aprovohet
“përcaktimi i interesit të
përgjithshëm” atëherë
si pasojë edhe
“vendimi mbi
ekspropriimin”
refuzohet (neni 3d, i
LE).

Neni 31, Ligji mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

Dëshmitë:

Prova se vendimi nuk ka bazë juridike. Mënyrat e të provuarit paralexoen në nenet prej 159 – 201 të LPPA.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike realizohen në procedurën aktit administrativ pranë organeve komunale. Lexo pjesën B2, mohimi i pabazuar i qasjes në shënimet kadastrale, Përshkrimi i mjetit juridik si më lartë.

Ju lutemi për vëmendje: LE thekson se mjete juridik duhet t'i paraqitet “organit të shkallës së dytë për çështjet pronësore juridike” (neni 17 i LE). Neni 35 i Rreg. UNMIK-ut 2000/45 zhvleftëson secilën dispozitë ligjore e cila është në kundërshtim me të (kreu 12 i Rreg në fjalë). Prandaj, përderisa ende nuk dihet qartazi se kush është organi i shkallës së dytë, apo organi qendror, padia/kërkesa duhet t'i paraqitet kryeshefit ekzekutiv, siç paralexoen në pjesën B.2.

Gjithashtu: nëse nuk aprovohet “përcaktimi i interesit të përgjithshëm” atëherë si pasojë edhe “vendimi mbi ekspropriimin” refuzohet (neni 3d, i LE).

d) Bazuar në mospërbushjen e kushteve për marrjen e “vendimit për ekspropriim” apo vendimi do të shkelet të drejtat pronësore.

Ligji në fuqi:

Neni 21 i ndryshuar, 57, i LE (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78, 46/86)

Anulimi i ekspropriimit:

Neni 35, Rreg. UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave
Udhëzimet e caktuara komunale

Ligji i procedurës së përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 47/86)

Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 4/77)

Neni 31, Ligji mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

Relevante për kontestet pronësore juridike:

Nenet 37, 70-81, të LMTHPJ (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 6/80)

Nenet 52, 56, 106, 185, 348, 350-57, 360, 382, 383, 388, LPK (Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596),

Dëshmitë:

Nevojiten prova materiale mbi atë se shfrytëzuesi i pronës së ekspropriuar nuk i ka plotësuar kushtet sipas marrëveshjes, se janë shkelur të drejtat e personit prona e të cilit ekspropriohehet. Mënyrat e të provuarit paralexoen në nenet prej 159 – 201 të LPPA
Neni 106(3), i LPK: “...pala duhet që në parashtresë t'i theksojë faktet në të cilat e bazon kërkesën, si dhe provat, kur kjo është e nevojshme.” Nuk ka udhëzime tjera në ligj

Përshkrimi i mjetit juridik:

Ligji i parasheh dy mjete juridike. Së pari shfrytëzuesi i ekspropriimit mund të kërkojë anulimin e “vendimit” mbi ekspropriimin përmes (psh, hjekë dorë nga propozimi për ekspropriim dhe anulon vendimin) procedurës administrative. Së dyti, pronari i mëparshëm mund të kërkojë lirim nga të drejtat e shkelura pronësore nga shfrytëzuesi i ekspropriimit (psh, përgjegjësia për kontestin pronësor bie në shfrytëzuesin e ekspropriimit dhe jo në organin e autorizimit të tij) neni 21 i LE.

Anulimi i ekspropriimit:

Mjete juridik përmes procedurës administrative. Paraqitja e ankesës para organit administrativ të shkallës së parë i cili e ka nxjerrë “vendimin” (neni 21(8), Ligji mbi ekspropriimin). Lexo pjesën B.2, mohimi i pabazë i qasjes në shënimet kadastrale, Përshkrimi i mjetit juridik si më lartë.

Afatet kohore:

- Nëse shfrytëzuesi i ekspropriimit nuk i ka ndërmarrë punët përgatitore, afati i paraqitjes së kërkesës është tre vjet nga data kur “vendimi” ka marrë formën e prerë (neni 21(4)(6), LE).
- Nëse pronari i tokës së ekspropriuar dhe shfrytëzuesi i ekspropriimit kërkojnë anulimin, apo nëse të drejtat e pronarit të tokës janë shkelur, atëherë kërkesa duhet të paraqitet brenda pesë vjetëve nga data kur “vendimi” ka marrë formën e prerë (neni 21(5), LE)

Në lidhje me pengimin në të drejtat pronësore:

Mjeti juridik realizohet në procedurën kontestimore (neni 21(8), LE). Lexo pjesën A.1, Mohimi i pabazë i të drejtave pronësore juridike, Përshkrimi i mjetit juridik.

e) Bazuar në aplikimin e gabuar të procedurës së veçantë për gjendjet emergjente dhe fatkeqësive tjera elementare

Ligji në fuqi:

Neni 22-27, Ligji mbi ekspropriimin (LE) (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78, 46/86)
Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 4/77)
Neni 31, i Ligjit mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

Dëshmitë:

Provat se::

- a. Prona nuk gjindet në regjionin ku aplikohet procedura e veçantë e caktuar nga organet qendrore të Kosovës; (neni 22-23, LE)
- b. Vendimi nuk është arsyetuar nga domosdoshmëria për të eliminuar pasojat e shkaktuara nga fatkeqësitë të cilat kanë shpjer në procedurën e veçantë (neni 22, LE)

Standardet e të provuarit parashikohen me nenin 27, të Ligjit mbi konfliktet administrative.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike realizohen përmes procedurës administrative (neni 3d, 24, 27, LE). Lexo nën C. 3(a), Ekspropriimi — Mohimi i pabazë i të drejtave pronësore juridike, Përshkrimi i mjetit juridik.

Sipas nenit 24(2) dhe 27(3), të LE, ankesa nuk e pengon ekzekutimin e vendimit.

4. Ekspropriimi — Pengimi i pabazë i të drejtave pronësore juridike

a) gjatë fillimit të punëve përgatitore (të zakonshme për emergjenca)

Ligji në fuqi::

Nenet 7-11, Ligji mbi ekspropriimin (LE) (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78, 46/86)
Neni 35, i Rregullores së UNMIK-ut 2000/45, mbi vetqeverisje e komunave Udhëzimet relevante të komunave
Ligji i procedurës së përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 47/86)
Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 4/77)
Neni 31, Ligji mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

Dëshmitë:

Sigurimi i dokumentacionit provues se:

- a. Puna është e domosdoshme për qëllimet e përcaktuara (neni 7, 9, LE);
- b. Puna përgatitore përfshinë ndërtimtarinë apo punët tjera të ngjajshme (neni 9(3))

Standardet e të provuarit paralexohen në nenet 159-201, të LPA.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike realizohen në procedurën aktit administrativ. Lexo pjesën B2, mohimi i pabazuar i qasjes në shënimet kadastrale, Përshkrimi i mjetit juridik si më lartë

5. Ekspropriimi – çështjet e kompensimit

a) Vendim i gabuar apo mospajtim mbi “përcaktimin e kompensimit” për pengim apo heqje të të drejtave pasurore- juridike

Ligji në fuqi:

Neni 28-48, 51-54 i Ligjit mbi ekspropriimin (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78, 46/86)
Neni 19,21, 138-146, Ligji mbi procedurën jokontestimore (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 42/86)
Nenet 56, 106, 185, 348, 350-57, 360, 382, 383, 388, Ligji i procedurës kontestimore
(Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596)
Neni 26, 29, i Ligjit mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

Dëshmitë:

Sigurimi i dokumentacionit provues mbi vlerën e pronës(pasurisë), apo dëshmi tjera të cilat nga gjykat konsiderohen si të domosdoshme për të përcaktuar dëmshpërblimin (kompensimin), përfshirë këtu edhe thirrjen e ekspertëve (neni 142, i LE). Kriteret për shumën e kompensimit i përcakton neni 28-48, i LE.

Përshkrimi i mjetit juridik:

- Nëse marrëveshja për kompensim nuk mund të arrihet brenda tre muajsh nga dita kur “vendimi mbi ekspropriimin” fiton formën e prerë, organi komunal përgjegjës për marrëdhëniet pronësore juridike duhet t’ia dorëzojë të gjitha aktet – dosjet, gjykatës komunale kompetente për të përcaktuar kompensimin. Gjithashtu edhe shfrytëzuesi i ekspropriimit dhe pronari i tokës mund të aplikojnë drejtpërdrejtë para gjykatës kompetente, nëse organi komunal nuk vepron (neni 52, i LE). Mjeti juridik realizohte në procedurën jokontestimore (neni 138, LPJK).
- Ankesa kundër vendimit të shkallës së parë e pezullon vendimin, përveç nëse me ligj nuk parashikohet ndryshe, dhe duhet të paraqitet brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të vendimit. Nëse gjykata e shkallës së parë (komunale) nuk e ndryshon apo anulon vendimin e vet sipas ankesës, atëherë do t’ia dorëzojë ankesën gjykatës së shkallës së dytë (gjykatës së qarkut, neni 29, i LGJR). (Neni 19-21, LPJK)
- Rishqyrtimi (si mjet i jashtëzakonshëm juridik) i vendimit të shkallës së dytë mund të inicohet pranë Gjyqit Suprem, brenda 30 ditëve nga dorëzimi i vendimit (neni 382 – 3, i LPK-re). Rishqyrtimi nuk e ndalon ekzekutimin e aktgjykimit të plotëfuqishëm të shkallës së dytë.

Ju lutemi për vërejtje: nëse avokati publik vlerëson se palët kanë lidhur marrëveshjen mbi shpërblimin në dëm të bashkësisë shoqërore, ia paraqet padinë gjykatës kompetente brenda afatit prej 15 ditëve nga pranimi i marrëveshjes mbi shpërblimin e dëmit ose brenda gjashtë muajsh nga lidhja e marrëveshjes. Padia e ndalon pagesën e shpërblimit (neni 51 i LE). Gjithashtu, avokati publik, mund të paraqet padi kundër vendimit gjyqësor i nxjerrë në procedurën e caktimit të kompensimit dhe për të njëjtat arsye dhe në kuadër të afateve të njëjta si më lartë (neni 53 i LE). Është e paqartë nëse edhe më tej zbatohen këto dispozita.

b) Mos realizimi i shpërblimit sipas “kompensimit të vlerësuar/përcaktuar”.

Ligji në fuqi:

Neni 55, i Ligjit mbi Ekspropriimin (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78, 46/86)
Lexo pjesën C. 3(d), Ekspropriimi—heqja e pabazë e të drejtave pronësore në bazë të mos përmbushjes së kushteve, ligji në fuqi.

Dëshmitë:

Sigurimi i dëshmisë se shpërblimi nuk është dhënë brenda 15 ditëve nga pranimi i vendimit të plotëfuqishëm mbi kompensimin. Lexo pjesën C. 3(d), Ekspropriimi—heqja e pabazë e të drejtave pronësore në bazë të mos përmbushjes së kushteve, ligji në fuqi.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, C. 3(d), Ekspropriimi—heqja e pabazë e të drejtave pronësore në bazë të mos përmbushjes së kushteve, përshkrimi i mjetit juridik.

E. Mbrojtja e ambientit

Kjo pjesë i përmend

mjetet e përgjithshme që kanë të bëjnë me ndërhyrjen në të drjetat pronësore që burojnë nga masat mbrojtëse të ambientit.

1. Ndërhyrja e padrejtë ose cenimi i të drejtave pronësore përmes ngarkesës së tepruar ose kritike ambientale

Nëse autoritetit publik ka shkaktuar ngarkesë të tepruar ose kritike ambientale ose kjo ka ndodhë mbi pronën e titullarit të pronës, ky autoritet publik konsiderohet përgjegjës për ngarkesë ambientale. Ky dëm ambiental mund t'ua cenojë bartësve të të drejtave pronësore gëzimin e plotë të tyre nëse këto ngarkesa i parandalojnë ata në shfrytëzimin dhe disponimin e lirë të pronës së tyre.

2. Ndërhyrja e padrejtë ose cenimi i të drejtave pronësore përmes masave mbrojtëse mjedisore

Ky mjet është i zbatueshëm nëse masat mbrojtëse të mjedisit të cilat i cenojnë ose i privojnë titullarët e pronave në gëzimin e plotë të të drejtave të tyre pronësore, të jenë të arsyeshme dhe proporcionale me nevojat për arritjen e mbrojtjes mjedisore efektive.

Ligji në fuqi:

Rregullrja e UNMIK-ut 2003/9 për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për mbrojtjen e mjedisit.

Ligji i procedurës së përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 47/86)

Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 4/77)

Neni 29 dhe 31, Ligji mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

Kreu XXIV, i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës

Ligji për kundërvajtjet (Gazeta Zyrtare KSAK, nr.23/79)

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A1, mohimi i padrejtë i të drejtave pronësore, ligji në fuqi

Dëshmitë:

Sigurimi i dokumentacionit provues për neglizhencën, aktet e paramenduara, apo shkeljet nga ana e një personi, ndërmarrjeje apo autoriteti publik që kanë sjellë një dëm tepër të madh apo kritik mjedisor (neni 19.1 i Rregullores 2003/9). Për procedurën administrative, lexo rregullat e provimit nga nenet 159-201, të LPPA. Për procedurë gjyqësore, lexo nenin 106 (3), të LPK-re.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjete administrative dhe juridike janë në disponim (neni 5(1) i Rregullores 2003/9. Një person, ndërmarrje apo autoritet publik që ka shkaktuar një dëm tepër të madh apo kritik mjedisor, do të jetë përgjegjës për kompezimin e kostos për zvogëlimin apo minimizimin e një dëmi të tillë(neni 5(g) i Rregullores 2003/9).

Mjetet administrative mund të vlerësohen përmes punës së inspektorëve mjedisor të cilët lëshojnë vendime, i njoftojnë akterët relevant, dhe ndihmojnë në iniciimin e veprimeve tjera përfshirë edhe vlerësimin e denimeve (neni 47 i Rregullres 2003/9). Kur vërtetohet se një ndërhyrje e tillë ka ndodhur, nga autoriteti publik kërkohet që të ndërmerr masa të arsyeshme për ta kthyer zonën në kushte të sigurta ose, nëse aktivitetet janë në vazhdim e sipër, të ndërmerr masa të arsyeshme për sigurimin se këto aktivitete janë në harmoni me ligjin.

Mjetet gjyqësore juridike mund të kërkohen në procedurë civile dhe penale. Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A1, mohimi i padrejtë i të drejtave pronësore, përshkrimi i mjetit juridik për procedurë civile. Për proceurë penale, lexo Kreun V, viktimat e krimit, A2, viktimat e krimit/pala e dëmtuar, prona e dëmtuar ose humbur dhe A4 viktimat e kundërvajtjeve.

Ligji në fuqi:

Rregullrja e UNMIK-ut 2003/9 për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për mbrojtjen e mjedisit.

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A1, mohimi i padrejtë i të drejtave pronësore, ligji në fuqi.

Dëshmitë:

Provat se masat mbrojtëse të mjedisit të cilat i cenojnë të drjetat pronësore janë të paarsyeshme dhe në disproporcion me nevojat për mbrojtje mjedisore. Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A1, mohimi i padrejtë i të drejtave pronësore, përshkrimi i mjetit juridik.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Shkelje e padrejtë e të drejtave pronësore përmes masave mbrojtëse të mjedisit

Mjeti juridik mund të realizohet në procedurë civile. Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A1, mohimi i padrejtë i të drejtave pronësore, përshkrimi i mjetit juridik.

Masat mbrojtëse rehabilituese që shkelin të drjetat pronësore

Nëse pronari ka bërë shkelje të standardeve për mbrojtjen e mjedisit dhe nga ai kërkohet që ministrit t'ia paraqesë planin me masat e nënvizuara rehabilituese, por nuk pajtohet me modifikimet e planit që i ka bërë ministri, ai ka të drejtë ta kundërshtojë atë pranë gjykatës

civile (neni 19 (3), i Rregullores së UNMIK-ut 2003/9). Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A1, mohimi i padrejtë i të drejtave pronësore, përshkrimi i mjetit juridik.

3. Cenimi i padrejtë i të drejtave pronësore përmes vendimit të inspektorëve të mjedisit

Ligji në fuqi:

Neni 3, 42-47, Rregullorja e UNMIK-ut 2003/9 për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për mbrojtjen e mjedisit.

Rregullorja 2000/45 për vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, udhëzimet komunale

Ligji i procedurës së përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 47/86)

Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 4/77)

Neni 31, Ligji mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

Dëshmitë

Sigurimi i provave se vendimi është i paarsyseshëm, i pabazë ose arbitrarisht. Për procedurën administrative, lexo rregullat e provimit nga nenet 159-201, të LPPA

Përshkrimi i mjetit juridik:

Vendimi i inspektorit komunal të mjedisit

- a. Ankesa kundër vendimit të inspektorit komunal të mjedisit mund të ngritet pranë kryeshefit ekzekutiv (neni 3, 47(2), Rregullorja e UNMIK-ut 2003/9 dhe neni 35(1), Rregullorja 2000/45). Edhe komunat mund të kenë procedura specifike: barra bie mbi paraqitësin e ankesës të hulumtojë. Nga KE kërkohet që të përgjigjet në afatin prej një muaji (neni 35(1-2) i Rregullres 2000/45).
- b. Nëse pala mbetet e pakënaqur me vendimin, atëherë ankesën mund ta ngritë pranë Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor (neni 47 (3) i Rregullores 2003/9 dhe neni 35(3), Rregullorja 2000/45). Ministria duhet të jepë përgjigjeje në afat prej një muaji neni 35(4), Rregullorja 2000/45).
- c. Ankesa kundër vendimit ministror mund të ngritet pranë Gjykatës Supreme (neni 46(4) i Rreg 2003/9 dhe neni 31 i Ligjit për gjykatat e rregullta). Afati për kofliktin administrativ është 30 ditë nga dorëzimi i vendimit palës, dhe 60 ditë nga dita e dërgimit të aktvendimit dhe pala nuk e ka pranuar këtë të fundit (neni 23-24, LKA)
- d. Gjithashtu, mund të kërkohet rishqyrtimi i jashtëzakonshëm i vendimit gjyqësor, kundër aktvendimit mbi konfliktin administrativ (neni 19-20, 45-50, LKA). Në çdo rast, i dërgohet gjykatës kompetente brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të aktvendimit të kontestuar (neni 46 i LKA).

Vendimi i inspektorit mjedisor në nivel qendror

Mjeti juridik mund të realizohet përmes procedurës së përshkruar më lart, por duke filluar nga pika "b", me ankesë pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor.

F. Refuzimi i pabazë i pëlqimit mjedisor

Pëlqimi mjedisor është i nevojshëm kur kërkohet vlerësimi i ndikimit në mjedis për planifikimin e ndërtimit të objektit. Është autorizim i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor me të cilin lejohet ndërtimin në një pronë atëherë kur vlerësimi i ndikimit në mjedis është pozitiv për ndërtimin e planifikuar (neni 2, 20-1, i Rregullores 2003/9).

Ligji në fuqi:

Neni 20-1, Rregullorja e UNMIK-ut 2003/9 për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për mbrojtjen e mjedisit.

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A1, mohimi i padrejtë i të drejtave pronësore, ligji në fuqi.

Dëshmitë:

Prova se refuzimi i kërkesës për aprovim mjedisor ka qenë arbitrar dhe kapriçios, i bërë me qëllime të caktuara, ose që nuk është bazuar në fakte shkencore apo standarde mjedisore në fuqi (neni 21.4 i Rregullores 2003/9), ose prova se pëlqimi nuk ka qenë i nevojshëm për shkak se nuk ka qenë i nevojshëm as vlerësimi i ndikimit në mjedis (neni 20, i Rregullores 2003/9).

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjeti juridik mund të realizohet përmes gjykatave civile (neni 21.4 i Rregullores 2003/9).

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A1, mohimi i padrejtë i të drejtave pronësore, përshkrimi i mjetit juridik.

Për hollësi lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis, lexo nenin 20 të rregullores.

5. Refuzimi i lejes së veprimtarisë – lejes ekologjike

Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis, nuk mund të behët pa miratimin e lejes ekologjike nga Ministria. (neni 2, 22, i Rregullores 2003/9).

Liqi në fuqi:

Neni 22, Rregullrja e UNMIK-ut 2003/9 për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për mbrojtjen e mjedisit.

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A1, mohimi i padrejtë i të drejtave pronësore, ligji në fuqi.

Dëshmitë

Provat se refuzimi është i pabazë dhe se objektet nuk shkaktojnë ndotje ose rrezikim të mjedisit. Prova se, lejea për ekologjike nuk ka qenë e nevojshme nga se nuk ka qenë i nevojshëm as vlerësimi i ndikimit në mjedis (neni 20 i Rregullores 2003/9).

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjeti juridik mund të realizohet përmes gjykatave civile (neni 5 (i) i Rregullores 2003/9).

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A1, mohimi i padrejtë i të drejtave pronësore, përshkrimi i mjetit juridik.

6. Refuzimi i autorizimit mjedisor

Liqi në fuqi:

Neni 23, Rregullrja e UNMIK-ut 2003/9 për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për mbrojtjen e mjedisit

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A1, mohimi i padrejtë i të drejtave pronësore, ligji në fuqi.

Dëshmitë

Provat se refuzimi është i pabazë. Prova se, autorizimi mjedisor nuk ka qenë i nevojshëm nga se nuk ka qenë i nevojshëm as vlerësimi i ndikimit në mjedis (neni 20 i Rregullores 2003/9).

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjeti juridik mund të realizohet përmes gjykatave civile (neni 5 (i) i Rregullores 2003/9).

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A1, mohimi i padrejtë i të drejtave pronësore, përshkrimi i mjetit juridik.

G. Planifikimi hapsinor

Kjo pjesë i thekson mjetet e përgjithshme juridike për çështjet e hartimit dhe implementimit të planeve hapsinore.

1. Cenimi ose privimi nga të drejtat pronësore përmes vendimeve për aprovimin e planeve hapsinore komunale.

Janë tre plane komunale hapsinore – planet komunale për zhvillim; planet për zhvillim urbanistik dhe planet urbanistike rregullative.

Liqi në fuqi:

Rregullrja e UNMIK-ut 2003/30 për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për planifikim hapsinor.

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A1, mohimi i padrejtë i të drejtave pronësore, ligji në fuqi

Dëshmitë

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A1, mohimi i padrejtë i të drejtave pronësore, dëshmitë

Përshkrimi i mjetit juridik:

Planet hapsinore aprovohen nga kuvendet komunale dhe për këtë arsye i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor. Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A1, mohimi i padrejtë i të drejtave pronësore, përshkrimi i mjetit juridik.

Vërejtje: Rregullorja e UNMIK-ut 2003/30 i jepë Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit

Hapsinor, përgjegjësitë për rishqyrtim, përcjellje dhe harmonizim të proceseve komunale të planifikimit dhe të sigurojë përshatshmërinë me procedurat planifikuese (neni 5). Por, nuk është e qartë nëse ministria mund të ofrojë shërim për shkeljet e të drejtave pronësore dhe të ndërlidhura.

D. Ndërtimi mbi tokë

Kjo pjesë i përshkruan mjetet juridike për ndërtimin që ka të bëjë me pronën banesore dhe afariste. Për mjetet juridike për kategoritë specifike të pronës, ju lutemi të lexoni pjesët përkatëse të këtij teksti.

1. Ndërtimi i paautorizuar nga personi fizik apo juridik e cili nuk është bartës i të drejtës pronësore juridike (parimet e përgjithshme)

Ligji në fuqi::

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A. 2(b), ndërhyrja në të drejtat pronësore përmes ndërtimit të paautorizuar, ligji në fuqi.

Dëshmitë:

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore A. 2(b), ndërhyrja në të drejtat pronësore përmes ndërtimit të paautorizuar, dëshmitë.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore A. 2(b), ndërhyrja në të drejtat pronësore përmes ndërtimit të paautorizuar, Përshkrimi i mjetit juridik

2. Refuzimi i pabazë i lejes për ndërtim apo legalizim të (objektit) të ndërtimit (parimet e përgjithshme)

Ligji në fuqi::

Neni 4, 6, i Rreg. UNMIK-ut 2000/53, mbi ndërtimet në Kosovë
Pjesë relevante të Rregullores së UNMIK-ut 2003/30 për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, për planifikim hapsinor.
Neni 35, i Rreg. UNMIK-ut 2000/45, mbi vetqeverisjen e komunave
Udhëzimet relevante të komunave
Kreu 4, neni 9.4.2, i Rreg. UNMIK-ut 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për IPV-es në Kosovë.
Ligji i procedurës së përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 47/86)
Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 4/77)
Neni 31, Ligji mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)
Ligjet tjera në fuqi janë ato mbi planifikimin dhe zhvillimin urbanistik, Ligji mbi ndërtimin e ndërtesave dhe shndërrimin e lokaleve të përbashkëta në banesa (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 14/88).
Gjithashtu lexo Kreun VI, çështjet pronësore pjesën F.2, të ligjit në fuqi mbi pronën jo-banesore.

Dëshmitë:

Provat se janë plotësuar kushtet për marrjen e lejes:

- a. Sigurimi i të gjitha dokumenteve të kërkuara dhe në afatin e paraparë, apo arsyetimi nëse nuk ofrohen;
- b. Në pajtim me të gjitha kërkesat substanciale siç janë, plani urbanistik, siguria teknike

dhe kërkesat ambientale si dhe kërkesat tjerat të përcaktuara me udhëzimet relevante komunale.

Standardet e të provuarit, të parapara me nenet 159-201 të LPPA.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Shumë prej mjeteve juridike janë të parapara në udhëzimet komunale. Mirëpo së paku, mjetet juridike realizohet përmes procedurës administrative përmes aktit komunal administrativ. Lexo Kreun VI, çështjet pronësore B.3, mohimi i shënimeve kadastrale, përshkrimi i mjetit juridik si më lartë.

Procedura sipas mjetit juridik nuk e pezullon ekzekutimin e sanksionit (Rreg. UNMIK –ut 2000/53, neni 6(3))

3. Refuzimi i lejes urbanistike

Sipas Rregullores 2003/30 leja urbanistike jepet për ndërtimin në ngastrën përkatëse. Leja e ndërtimit jepet për specifikacionet teknike të ndërtimit të objektit.

Ligji në fuqi:

Nenet 24, 26, 27 të Rregullores së UNMIK-ut nr 2003/30, për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, për planifikim urban.

Ligji i procedurës së përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 47/86)

Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 4/77)

Neni 31, Ligji mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

Dëshmitë:

Provat se janë plotësuar kushtet për marrjen e lejes:

- a. Sigurimi i të gjitha dokumenteve të kërkuara dhe në afatin e paraparë, apo arsyetimi nëse nuk ofrohen;
- b. Në pajtim me të gjitha kërkesat substanciale siç janë, plani urbanistik, siguria teknike dhe kërkesat ambientale si dhe kërkesat tjerat të përcaktuara me udhëzimet relevante komunale.

Përshkrimi i mjetit juridik:

a. Aplikuesi mund të ankohet kundër vendimit të Ministrisë për refuzim të kërkesës për leje urbanistike mbrenda 15 ditëve nga pranimi i vendimit (neni 27.3 i Rregullores 2003/30), ose nëse nuk është marrë vendimi brenda një muaji nga dita e paraqitjes së kërkesës (neni 218 i LPPA). Ministria shqyrton ankesën dhe nxjerr vendim për aplikuesin brenda 30 ditësh, nga dita që është bërë ankesa(neni 27.3 i Rregullores 2003/30).

b. Ankesa kundër vendimit të organeve komunale mund të ngritet pranë Gjykatës Supreme (neni 31 i Ligjit për gjykatat e rregullta). Afati për fillimin e kofliktit administrativ është 30 ditë nga dorëzimi i vendimit palës, dhe 60 ditë nga dita e dërgimit të aktvendimit dhe pala nuk e ka pranuar këtë të fundit (neni 24, LKA)

c. Gjithashtu, mund të kërkohet rishqyrtimi i jashtëzakonshëm i vendimit gjyqësor, kundër aktvendimit mbi konfliktin administrativ (neni 19-20, 45-50, LKA). Në çdo rast, i dërgohet gjykatës kompetente brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të aktvendimit të kontestuar (neni 46 i LKA).

4. Zbatimi i gabuar i sanksioneve (përshirë edhe rrënimin) për shkeljet e kushteve të lejuara në lejen e ndërtimit

Ligji në fuqi:

Neni 5, i Rreg. UNMIK-ut 2000/53, mbi ndërtimet në Kosovë
Gjithashtu edhe ligji në fuqi i përmendur më sipër.

Dëshmitë:

Provat mbi atë se sanksioni është i kundërligjshëm apo i pa arsyetuar, psh, se nuk janë shkelur kushtet e dhëna në lejen për ndërtim. Standardet e të provuarit, të parapara me nenet 159-201 të LPPA

Përshkrimi i mjetit juridik:

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore D.2, refuzimi i lejes për ndërtim, përshkrimi i mjetit juridik.

5. Përcaktimi i gabueshëm i rrezikut për shëndetin publik, mbrojtjen apo sigurinë,

Ligji në fuqi:

Neni 7, i Rreg. UNMIK-ut 2000/53, mbi ndërtimet në Kosovë
Gjithashtu edhe ligji në fuqi i përmendur më sipër.

**dhe veprimeve që
rrezikojnë të drejtat
pronësore**

Dëshmitë:

Provat mbi atë se sanksioni është i kundërligjshëm apo i pa arsyetuar, psh, se nuk janë shkelur kushtet e dhëna në lejen për ndërtim. Standardet e të provuarit, të parapara me nenet 159-201 të LPPA.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjeti juridik realizohet përmes procedurës administrative e cila aplikohet për aktin administrativ komunal. Lexo Kreun VI, çështjet pronësore B.2, mohimi i shënimeve kadastrale, përshkrimi i mjetit juridik si më lartë.

**G, Çështjet pronësore
banesore**

Kjo pjesë i referohet pronës banesore, ndërsa për kategoritë tjera, ju lutemi t'i referoheni pjesëve tjera si më lartë.

Ju lutemi të keni parasyshë se mjetet juridike të cilat janë në kundërshtim apo të cilat nuk janë të zbatueshme nga aspekti i rregulloreve të UNMIK-ut nr. 1999/23 dhe 2000/60, nuk janë të përfshira në këtë pjesë. Përdesia nuk përcaktohet ndryshe nga Komisioni për kërkesa pronësore dhe banesore, mjetet juridike të parapara me këto rregullore mbesin nën kompetencë ekskluzive të këtij komisioni.

Krahas kësaj, mjetet juridike që i përkasin ndihmës për rindërtimin e shtëpive, nuk janë përfshirë në këtë pjesë për shkak të natyrës gjysmë ligjore të tyre për këtë kohë.

**1. Privimi nga e drejta
banesore (përfshirë**

edhe të drejtën e shfrytëzimit)

a. Prej 23 mars 1989 deri në 24 mars 1999, si rezultat i legjislacionit diskriminues.

Gjithashtu e njohur edhe si "kategoria A" e kërkesave pranë KKPB-së

Liqi në fuqi:

Neni 1.2(a), 2.5, 2.7 i Rreg. UNMIK-ut 1999/23, mbi themelimin e Drejtorisë dhe Komisionit për shqyrtimin e kërkesave të çështjeve (më tutje në tekst "Drejtoria" dhe "Komisioni")

Nenet 2.2, 3, 4, 7-10, 14, 19-22, 25, të Rreg. UNMIK-ut 2000/60, mbi kërkesat pronësore dhe banesore dhe rregullat e procedurës dhe të provave të drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore dhe komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore.

Dëshmitë:

Parashtresat me shkrim, përfshirë formularin e kërkesës, dokumentacioni (nenet 8.1-2, 19.1-3, të Rreg. UNMIK-ut 2000/60). Duhet të prezentohen dokumentet origjinale apo të vërtetuara. Në kuadër të dëshmimeve hyjnë edhe: dëshmitë gjyqësore, kadastrale, të organeve komunale, ndërmarrjes publike banesore dhe bartësit e të drejtës së alokimit të pronës. "Drejtoria" dhe "Komisioni" e kanë një pamflet tjetër i cili tregon për llojet e pranueshme të dëshmimeve.

Neni 21.1, i Rreg. UNMIK-ut 2000/60

"Komisioni nuk është i varur nga rregullat për prova të aplikuara në gjyqet vendore në Kosovë. Komisioni mund ta marrë parasysh çdo provë të besueshme, të cilën e konsideron të rëndësishme për lëndën, duke përfshirë këtu provatë e paraqitura nga Drejtoria lidhur me besueshmërinë e cilitdo dokument apo protokoll publik."

Përshkrimi i mjetit juridik:

Vërejtje: ky mjet juridik nuk është i mundur për aplikantët e rinjë për shkak se afati kohor për paraqitjen e kërkesave ka skaduar më 1 korrik 2003.

- Paraqitja e kërkesës pranë "Komision-it" përmes zyrës përkatëse të "Drejtorisë" para afatit të 1 qershorit 2003. (Afati është shtyre gjer në nëntor 2002). Kërkesa duhet të dorëzohet nga personi fizik i kategorisë përkatëse, anëtari i familjes apo përfaqësuesi i autorizuar ligjor. [Gjatë paraqitjes së kërkesës, duhet të prezentohen të gjitha dokumentet, dhe me atë rast intervistën do ta zhvillojë zyrtari për regjistrimin e kërkesave].
- Të gjitha palët e interesuara dhe të identifikura në kërkesë, do të njoftohen dhe do të kenë 14 ditë në disponim për të treguar nëse dojnë të marrin pjesë në këtë proces. Nëse i përgjigjen njoftimit, atëherë palës përgjegjëse do t'i jepet afati prej 30 ditësh për t'ju përgjigjur kërkesës. Paraqitësi i kërkesës apo palët tjera relevante i kanë 30 ditë në disponim për t'ju përgjigjur secilës çështjeje të ngritur në përgjigje. Afatet mund të zgjaten apo caktohen sipas bindjes së lirë të "Drejtorisë".
- Nëse nuk refuzohet me shkrim nga ana e "Drejtorisë", për shkak se kërkesa dukshëm qëndron jashtë jurisdikcionit të "Komisionit", atëherë "Drejtoria" to të mundohet të zgjidhë në mënyrë miqësore kërkesat (neni 10.1). Nëse nuk mund të bëjë një gjë të tillë, atëherë "Drejtoria" do t'ia referojë kërkesën "Komisionit" (neni 10.4) [Pas refuzimit të kërkesës nga "Drejtoria" mund të paraqitet ankesa pranë "Komisionit" (neni10.4)]
- Nëse pala nuk pajtohet me vendimin e "Komisionit", ajo ka në disponim 30 ditë pas njoftimit mbi vendimin, që të paraqesë kërkesën për rishqyrtim (neni 25). Kërkesa i dorëzohet "Drejtorisë" (neni 14.1). Nuk lejohet mundësi tjetër e ankesës (neni 2.7, i Rreg të UNMIK-ut 1999/23).

Vërejtje: "Komisioni" mbanë kompetencën ekskluzive ndaj kërkesave të tilla dhe deri në atë kohë kur të njëjtën ia kthen gjykatave të rregulta (neni 2.5, i Rreg. të UNMIK-ut 1999/23)

b. Prej 23 marsit 1989 deri me 13 tetor 1999, për ata të cilët kanë lidhur kontrata joformale të shitblerjes

Liqi në fuqi:

Neni 1.2(b), 2.5, 2.7 i Rreg. UNMIK-ut 1999/23, mbi themelimin e "Drejtorisë" dhe "Komisionit")

Neni 2.3-4, 3, 7-11, 14,19-22, 25 i Rreg. UNMIK-ut 2000/60 mbi kërkesat pronësore dhe

së patundshmërisë dhe sipas vullnetit të lirë të tyre, por që si të tilla ishin të paligjshme sipas ligjeve ekzistuese të asaj kohe.

Gjithashtu të njohura si “Kategoria B” e kërkesave.

banesore dhe rregullat e procedurës dhe të provave të drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore dhe komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore

Dëshmitë:

Lexo nën E. 1(a), Privimi nga e drejta banesore (përfshirë edhe të drejtën e shfrytëzimit), pjesa mbi dëshmitë.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore E. 1(a), Privimi nga e drejta banesore (përfshirë edhe të drejtën e shfrytëzimit), përshkrimi i mjetit juridik.

Krahas mjetit juridike të përshkruar më lartë, “kategoria B” e kërkesave mund të gëzojë edhe një opcion tjetër, nëse kërkesa është e pakontestueshme dhe “drejtoria” pajtohet se ka dëshmi të mjaftueshme se paraqitësi i kërkesës e ka fituar të drejtën pronësore në mënyrë të drejtë përmes transakcionit joformal (neni 11, i Rreg. UNMIK-ut 2000/60). Nëse “drejtoria” është e knaqur, ajo mund të lëshojë urdhërin për regjistrimin e transakcionit (kontratës) joformal në librat (regjistrat) e duhur publik..

Një urdhër i tillë, megjithatë nuk është obligativ mbi të drejtat pronësore dhe nuk e paragjykon të drejtën e personave të tjerë për të paraqitur kërkesa tjera pranë “Drejtorisë” sipas nenit 1.2, të Rreg. UNMIK-ut 1999/23. Mirëpo, kërkesa e tillë mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga njoftimi për urdhërin e Drejtorisë dhe më së largu deri në një vit nga data e lëshimit të urdhërit.

Vërejtje: “Komisioni” mbanë kompetencën ekskluzive ndaj kërkesave të tilla dhe deri në atë kukhë kur të njëjtën ia kthen gjykatave të rregulta (neni 2.5, i Rreg. të UNMIK-ut 1999/23)

c. Përmes refuzimit nga “Drejtoria” apo “Komisioni” të kërkesës për rishqyrtim.

Ligji në fuqi:

Neni 1.2, 2.5, 2.7 i Rreg. UNMIK-ut 1999/23, mbi themelimin e “Drejtorisë” dhe “Komisionit”)

Neni 2, 3, 5-10, 14, 25 i Rreg. UNMIK-ut 2000/60, mbi kërkesat pronësore dhe banesore dhe rregullat e procedurës dhe të provave të drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore dhe komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore

Dëshmitë:

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore E. 1(a), Privimi nga e drejta banesore (përfshirë edhe të drejtën e shfrytëzimit), pjesa mbi dëshmitë.

Rishqyrtimi i vendimit të “Komisionit” [apo “Drejtorisë”] duhet të zhvillohet mbi bazën e (a) mos shqyrtimit të dëshmisë së rëndësishme ligjore gjatë vendosjes mbi lëndën (kërkesën) dhe (b) e ekzistimit të gabimit material gjatë zbatimit të Rreg. UNMIK-ut 2000/60.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike – varësisht nga lloji i refuzimit (të kërkesës):

- a. *Refuzimi i kërkesës nga “Drejtoria”:* Nëse “Drejtoria” e refuzon kërkesën, duke konstatuar se dukshëm bie jashtë jurisdikcionit të “komisionit” (neni 10.3, i Rreg. UNMIK-ut 2000/60), atëherë paraqitësi i kërkesës mund të kërkojë rishqyrtimin dhe këtë t’ia paraqesë “komisionit” përmes “drejtorisë” (neni 10.4). Neni 10 nuk përmend ndonjë afat kohor për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim, por duket se zbatohet afati kohor sipas nenit 14.1 e që është 30 ditë nga data e njoftimit të “drejtorisë” mbi refuzimin e vendimit. Vendimi mbi rishqyrtimin është i formës së prerë dhe është obligativ. (neni 2.7, i Rreg. UNMIK-ut 1999/23).
- b. *Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim:* nuk paralexohet mundësia e ankesës (neni 25.2, i Rreg. UNMIK-ut 2000/60; neni 2.7, i Rreg. UNMIK-ut 1999/23)

Ligji në fuqi:

Neni 1.2, 2.5, 2.7 i Rreg. UNMIK-ut 1999/23, i Rreg. UNMIK-ut 1999/23, mbi themelimin e “Drejtorisë” dhe “Komisionit”)

d. Në veçanti të drejtën e shfrytëzimit të banesave në pronësi shoqërore të një subjekti tjetër nga ai i “komisionit”.

Section 2.2, 3, 5-11, 14,19-22, 25 i Rreg. UNMIK-ut 2000/60 mbi kërkesat pronësore dhe banesore dhe rregullat e procedurës dhe të provave të drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore dhe komisionit për kërkesa pronësore dhe

Përderisa ligji tjetër në fuqi, siç është Ligji mbi marrëdhëniet banesore, disponon me dispozita që kanë të bëjnë me këtë shkelje, mjeti juridik për këtë shkelje bie nën "komision" (neni 5,6, i Rreg-UNMIK-ut 2000/60). Kjo nuk e ndalon gjykatën kompetente që të vendosë mbi çështjet substanciale, vetëm për zbatimin e vetëm mjetit juridik.

e. Në veçanti të të drejtës banesore pas shkurorëzimit.

banesore

Dëshmitë:

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore E. 1(a), Privimi nga e drejta banesore (përfshirë edhe të drejtën e shfrytëzimit), pjesa mbi dëshmitë.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Paraqitja e kërkesës pranë "komisionit" përmes "drejtorisë". Sipas nenit 6, të Rreg. UNMIK-ut 2000/60, asnjë e drejtë banimi në banesë shoqërore nuk mund të përfundojë pa, ose pajtimin e bartësit të të drejtës për banim, ose "Drejtorisë", ose pa urdhërin e "komisionit". Nuk janë të përcaktuara procedurat dhe afatet kohore.

Sipas nenit 5, personi i cili e ka blerë banesën nga bartësi i të drejtës për ndarje, në pajtim me ligjin mbi banesat, pas datës 23 mars 1989, nuk mund t'ia bartë banesën personit tjetër përveç nëse bartja është pjesë e një zgjidhjeje miqësore në pajtim me këtë rregullorë.

Ligji në fuqi:

Neni 16 dhe 16(a), i ligjit mbi marrëdhëniet banesore (Gazeta Zyrtare KSAK, 11/83, 29/86, 42/86)

Nenet 37, 70-81, i ligjit mbi marrëdhëniet bazë pronësore juridike (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 6/80)

Nenet 56, 106, 185, 348, 350-57, 360, 382, 383, 388, të ligjit mbi procedurën kontestimore (Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596)

Nenet 154-160, ligjit mbi procedurën jokontestimore (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 42/86)

Neni 26, 29, 31, ligji mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

Shënim: nenet 5-6, të Rreg. UNMIK-ut 2000/60 nuk duket se janë të zbatueshme, përveç me rastin e ekzekutimit të ndërprerjes.

Dëshmitë:

Sigurimi i provave se:

- Njëri nga ish-bashkëshortët e ka shkëmbyer banesën, pa pëlqimin e tjetrit, (neni 16(2)); ose
- Ish-bashkëshortët, nuk kanë arritur të pajtohen se kush do të largohet, dhe në cilën banesë në rast të shkëmbimit të dy njësive banesore (neni 16(2)); ose
- Ish-bashkëshortit i cili e ka liruar banesën, nuk i u është dhënë kompenzimi adekuat (neni 16a(2)); ose
- Nuk janë marrë si duhet parasyshtë rrethanat, gjatë vendosjes se cilit nga bashkëshortët do t'i mbetet e drejta e banimit (neni 16(4)); ose
- Ish-bashkëshorti të cilit ju ka ndërprerë e drejtën e banimit, ende nuk e ka liruar banesën (neni 16a(2)).

Përshkrimi i mjetit juridik:

Nëse nuk arrihet marrëveshja, atëherë mjeti juridik mund të kërkohet përmes procedurës jokontestimore. Lexo Kreun VI, çështjet pronësore C. 5(a), Ekspropriimi – çështjet e kompenzimit, përshkrimi i mjetit juridik.

Sipas nenit 5-6, i Rreg. UNMIK-ut 2000/60, duket se që kjo drejtë të përfundon si duhet, duhet këtë pajtimin ose të bartit të të drejtës për banim, të "drejtorisë, apo sipas urdhërit të "komisionit".

f. Në veçanti e drejta e banimit, pas vdekjes së bartësit të kësaj të drejte.

Ligji në fuqi:

Nenet 17-8, të ligjit mbi marrëdhëniet banesore (Gazeta Zyrtare KSAK, 11/83, 29/86, 42/86) [LHR]

Neni 19-20, 26, 94-137, ligjit mbi procedurën jokontestimore (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 42/86)

Nenet 37, 70-81, i ligjit mbi marrëdhëniet bazë pronësore juridike (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 6/80)

Nenet 56, 106, 185, 348, 350-57, 360, 382, 383, 388, të ligjit mbi procedurën kontestimore

(Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596)

Neni 26, 29, 31, ligji mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

Shënim: nenet 5-6, të Rreg. UNMIK-ut 2000/60 nuk duket se janë të zbatueshme, përveç kur bartësi i të drejtës për banim e përfundon këtë të drejtë.

Dëshmitë:

Nëse bartësi i të drejtës për banim mendon të përfundojë, paraqitësi i kërkesës duhet të provojë se:

- a. Bartësi i të drejtës banesore, i cili është anëtarë i familjes, të obligohet me kushtet e përcaktuara nga neni 17(2), i LMB-re;
- b. Përndryshe ai/ajo nuk i ka zgjidhur nevojat banesore (neni 17(3), i LMB-re);
- c. Ai/ajo e ka njoftuar bartësin e të drejtës për ndarje të banesës brenda 30 ditëve se atij/saj i u është ndarë e drejta e shfrytëzimit të banesës (neni 18(5), i LMB-re); ose,
- d. Bartësi i të drejtës për ndarje të banesës nuk e ka paraqitur kërkesën për anulimin e të drejtës para organit kompetent brenda 3 muajsh nga dita e njoftimit mbi vdekjen e bartësit të të drejtës për banim, jo më largë se 3 vjet pas vdekjes (neni 18(3), i LMB-re).

-ose-

Nëse është i involvuar në kontesitën trashëgimor, paraqitësi duhet të provojë se ai/ajo është trashëgimtar ligjor i bartësit të të drejtës së banimit dhe se kjo e drejtë nuk është dashur të anulohet. Lexo Kreun VI, çështjet pronësore nën A.1(a), privimi i të drejtave pronësore, dëshmitë.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Nëse nuk mund të arrihet marrëveshja, atëherë mjeti juridik mund të realizohet përmes procedurës jokontestimore. Procedura jokontestimore mund të bartet edhe në procedurën kontestimore sipas (nenit 125, të LPJK). Lexo Kreun VI, çështjet pronësore nën C. 5(a), Ekspropriimi—çështjet e kompenzimit, përshkrimi i mjetit juridik.

Sipas nenit 5-6, i Rreg. UNMIK-ut 2000/60, duket se që kjo drejtë të përfundon si duhet, duhet këtë pajtimin ose të bartësit të të drejtës për banim, të "drejtorisë, apo sipas urdhërit të "komisionit

g. Në veçanti të drejtës banesore të bazuar në dhënjen me qira të banesës në pronësi shoqërore

Qirat mbi banesat në pronësi shoqërore lejohen me nenin 6.(c), të Rreg-UNMIK-ut 2000/60.

Ligji në fuqi:

Nenet 74-78, të ligjit mbi marrëdhëniet banesore (Gazeta Zyrtare KSAK, No. 11/83, 29/86, 42/86) duket se mund të zbatohen.

Pjesë të caktuara të Ligjit mbi marrëdhëniet detyrimore (Gazeta Zyrtare RSFJ, Nr. 29/1978, 39/1985, 45/1989, 31/1993)

Nenet 37, 70-81, ligjit mbi marrëdhëniet bazë pronësore juridike (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 6/80)

Nenet 56, 106, 185, 348, 350-57, 360, 382, 383, 388, të ligjit mbi procedurën kontestimore (Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596)

Neni 26, 29, 31, , ligji mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, No. 21/78)

Dëshmitë:

Neni 74-77, ligjit mbi marrëdhëniet banesore, kriteret për të kundërtën. Lexo pjesën A.1(a), privimi i të drejtave pronësore, dëshmitë.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike parashikohen në nenet 75-77, të LMB-re, dhe gjithashtu përmes procedurës civile (neni 78, LMB-re). Lexo Kreun VI, çështjet pronësore nën A.1, Lexo pjesën A.1(a), privimi i të drejtave pronësore, përshkrimi i mjetit juridik.

h. Për shkak të mos regjistrimit të shitblerjes në Zonat e caktuara gjeografike (ZCGj)

Siç është vendosur me Rreg. UNMIK-ut 2001/17 dhe aprovuar

Ligji në fuqi:

Neni 3, 6-7, i Rreg. UNMIK-ut 2001/17, MBI REGJISTRIMIN E KONTRATAVE PËR SHITBLERJEN E PATUNDSHMËRIVE NË ZONAT E VEÇANTA GJEOGRAFIKE TË KOSOVËS

Dëshmitë:

Kërkesa për shqyrtim duhet të mbështetet edhe me disa dëshmi tjera, apo njoftime mbi rrethanat të cilat justifikojnë se vendimi i mëparshëm është vlerësuar gabimisht apo nuk

nga administratori komunal.

* Gjykata kompetente në rajonin ku gjendet prona banesore do t'i verifikojë vetëm ato kontrata të shitblerjes së shitblerjes së patundshmërive, në pajtim me ligjin në fuqi, atëherë kur të jetë suguruar dëshmia se Administratori komunal i ka regjistruar ato në pajtim me nenin 2.7. (neni 4, i Rreg. UNMIK-ut 2001/17).

ekzistojnë më (neni 6.1).

Arsyset e lejueshme për refuzim përcaktohen me nenin 3, dhe të cilat përfshijnë ato kur shitblerja është realizuar nën shtrëngim, çmimi i shitjes është joreal, mjetet e pagesës janë të dyshimta, ose kur shitblerja do të ndikonte negativisht në sigurinë e pronarve tjerë nga pakica, apo kur ka për qëllim ndryshimin sistematik të balancit etnik në atë zonë.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjeti juridik realizohet sipas nenit 6-7, të Rreg. UNMIK-ut 2001/17.

- a. Paraqitja e kërkesës me shkrim pranë administratorit komunal për të rishqyrtuar vendimin e tij të nxjerrë sipas nenit 3. Kërkesa duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita e refuzimit (jo njoftimit mbi refuzimin). Brenda 30 ditëve nga pranimi i kërkesës për rishqyrtim, administratori komunal duhet të nxjerrë vendimin përfundimtarë.
- b. Nëse paraqitësi i kërkesës, nuk pajtohet me vendimin e nxjerrë, mund të ngritë ankesë kundër vendimit para trupit gjykues (tre-anëtarësh) të caktuar nga PSSP për revidimin gjyqësor (përfshirë këtu edhe pajtueshmërinë me kërkesat formale). Ankesa duhet të bëhet me shkrim dhe brenda 60 ditëve nga data kur vendimi refuzues mbi regjistrimin e shtitblerjes, ka marrë formën e prerë. Nuk ka mundësi tjera të ankesës.

Shënim: Rregullorja nuk siguron hollësi të mjaftueshme lidhur me procedurën e rishqyrtimit dhe asaj të ankimit, psh, kujt duhet t'i paraqitet ankesa kundër vendimit të formës së prerë. Kjo çështje momentalisht është duke u diskutuar në instancat qendrore për t'ju dhënë komunave njoftime më precize mbi procedurat.

i. Pas 24 marsit 1999 (ose 13 tetorit 1999 për kontratat joformale), për ankesat kundër privimit të të drejtave të cilat nuk gjinden në kuadër të kategorive të sipërpërmendura

Liqji në fuqi:

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A.1, për ligjin në fuqi që ka të bëjë me pengim posedimin dhe okupimin joligjor të pasurisë. Për banesat shoqërore të kësaj kategorie, sigurohuni që e drejta pronësore të jetë fituar pas 13 tetorit 1999, nuk bie qartazi nën nenin 6, të Rreg. UNMIK-ut 2000/60/

Dëshmitë:

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore E. 1(a), privimi i të drejtave pronësore.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjeti juridik realizohet në procedurë kontestimore. Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A.1, privimi i të drejtave pronësore, përshkrimi i mjetit juridik si më lart.

2. Ndërhyrja në të drejtat pronësore banesore (përfshirë të drejtën e banimit)

a. Fituar para 24 marsit 1999 dhe kur bartësi i të drejtës pronësore nuk posedon me pronën dhe nuk e ka tjetërsuar pronën me shprehjen e

Liqji në fuqi:

Neni 1.2(c), 2.5, 2.7 i Rreg. UNMIK-ut 1999/23, mbi themelimin e "Drejtorisë" dhe "Komisionit"

Neni 2.5-6, 3, 4, 7-10, 14, 19-22, 23, 25, i Rreg. UNMIK-ut 2000/60 mbi kërkesat pronësore dhe banesore dhe rregullat e procedurës dhe të provave të drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore dhe komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore

**lirë të vullnetit.
[okupimi/uzurpimi i
kundërligjshëm]**

Gjithashtu e njohur si
“kategoria C” e
kërkesave.

Dëshmitë:

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore nën E. 1(a), privimi i të drejtave pronësore, pjesa mbi dëshmitë

Përshkrimi i mjetit juridik:

Ky mjet juridik nuk është i mundur për aplikantët e rinjë për shkak se afati kohor për paraqitjen e kërkesave ka skaduar më 1 korrik 2003.

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore nën E. 1(a), privimi i të drejtave pronësore-banesore, përshkrimi i mjetit juridik.

Krahas mjeteve juridike të përmendura më lartë, secila kërkesë e “kategorisë C”, e pakontestuar mund të merret në shqyrtim sipas procedurës së shkurtë (neni 23, i Rreg. UNMIK-ut 2000/60). Nëse “komisioni” konstaton se ka dëshmi të cilat tregojnë se paraqitësi i kërkesës ka pasur në posedim të pakontestueshëm pronën para 24 marsit 1999, atëherë mund të nxjerrë vendimin mbi rikthimin e pronës në posedim.

Vërejtje: “Komisioni” mbanë kompetencën ekskluzive ndaj kërkesave të tilla dhe deri në atë kohë kur të njëjtën ia kthen gjykatave të rregulta (neni 2.5, i Rreg. të UNMIK-ut 1999/23). Gjithashtu sipas nenit 1.1 të Rregullores 1999/23 dhe nenit 12.2(e) të Rregullores 2000/60, “Drejtoria” mund ta vendosë pronën nën administrimin e vet në bazë të kërkesës së pronarit apo bartësit të të drejtës pronësore, me qëllim që t’i plotësojë nevojat banesore për personat e zhvendosur dhe refugjatët. Nuk është mjet juridik ndaj pengesave në të drejtat pronësore. Gjatë administrimit, e drejta e posedimit e pronarit suspendohet (neni 12.3 i Rregullores 2000/60).

b) Fituar pas 24 marsit 1999 dhe kur bartësit e të drejtës pronësore nuk e kanë pronën në posedim dhe nuk ka tjetërsuar pronën me shprehjen e lirë të vullnetit.

Gjithashtu e njohur si okupim i kundërligjshëm i pronës banesore.

Liqi në fuqi::

Lexo A.2(c) dhe (d) për ligjin në fuqi lidhur me pengim posedimin dhe okupimin e kundërligjshëm të pronës. Për banesat shoqërore të kësaj kategorie, sigurohuni që e drejta pronësore të jetë fituar pas 13 tetorit 1999, nuk bie qartazi nën nenin 6, të Rreg. UNMIK-ut 2000/60/.

Dëshmitë:

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore A.2(c) dhe (d) për ligjin në fuqi lidhur me pengim posedimin dhe okupimin e kundërligjshëm të pronës.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjeti juridik realizohet në procedurë kontestimore. Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A.1, privimi i të drejtave pronësore, përshkrimi i mjetit juridik si më lart.

c) Përmes vendimit administrativ të “Drejtorisë” për dëbim, apo dhënjen e lejës së përkohshme për strehim.

Liqi në fuqi::

Neni 1, 2.7, i Rreg. UNMIK-ut 1999/23 mbi themelimin e “Drejtorisë” dhe “Komisionit”)

Neni 14.2, i Rreg. UNMIK-ut 2000/60 mbi kërkesat pronësore dhe banesore dhe rregullat e procedurës dhe të provave të drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore dhe komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore.

Kreu 1-3, i direktivës 2000/1, për ekzekutimin e skemës për ndarjen e banesave.

“Çdo person i interesuar, i cili nuk është palë në kërkesë e që mund të ofrojë arsye të fortë pse nuk ka marrë pjesë si palë në kërkesë, mund të kërkojë rishqyrtimin e vendimit të Komisionit 30 ditë mbasi të ketë mësuar për vendimin e Komisionit, por jo më vonë se një (1) vit nga data e vendimit të Komisionit.”

Dëshmitë:

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore nën E. 1(a), privimi i të drejtave pronësore, pjesa mbi dëshmitë.

Kërkesat dhe rishqyrtimi i vendimit administrativ të “Drejtorisë” duhet të bazohet në nën (a)dëshmitë relevante ligjore, që nuk janë marrë në shqyrtim paraprakisht, apo (b) sipas bazës së gabimit material gjatë zbatimit të mandatit të “drejtorisë”.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike parashikohen me urdhërin e “Drejtorisë” nr. 2000/1:

- a. Kërkesa duhet të paraqitet në zyren e “drejtorisë” e cila ka marrë vendim, brenda 30 ditësh nga njoftimi mbi vendimin. Zbatimi i vendimit pezullohet pas pranimit të kërkesës përveç kur “drejtorja” vendosë ndryshe.
- b. Nëse zyra e “drejtorisë” nuk e ndryshon vendimin e vet, atëherë kërkesa duhet t’i përcillet selisë së “drejtorisë”, për t’u rishqyrtuar.
- c. “Drejtorja” mund të rishqyrtojë vendimin e vet në çdo kohë.

d) Përmes vendimit të “komisionit” sipas të cilit bartësi i të drejtës është palë e tretë.

Liqi në fuqi:

Neni 1, 2.7, i Rreg. UNMIK-ut 1999/23 mbi themelimin e “Drejtorisë” dhe “Komisionit”)

Neni 14.2, i Rreg. UNMIK-ut 2000/60 mbi kërkesat pronësore dhe banesore dhe rregullat e procedurës dhe të provave të drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore dhe komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore.

Kreu 1-3, i direktivës 2000/1, për ekzekutimin e skemës për ndarjen e banesave.

“Çdo person i interesuar, i cili nuk është palë në kërkesë e që mund të ofrojë arsye të fortë pse nuk ka marrë pjesë si palë në kërkesë, mund të kërkojë rishqyrtimin e vendimit të Komisionit 30 ditë mbasi të ketë mësuar për vendimin e Komisionit, por jo më vonë se një (1) vit nga data e vendimit të Komisionit.”

Dëshmitë:

Personi paraqet provat që e arsyetojnë mos prezencën e tij.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim të vendimit të “komisionit” përmes “drejtorisë” brenda 30 ditëve nga dita kur është mësuar për vendimin “komisionit”. Kërkesa duhet të parashtrohet brenda një vite prej ditës së lëshimit të vendimit (neni 14.2, i Rregullores 2000/60. Nëse kërkesa refuzohet nuk lejohet më ankesa (neni 2.7. i Rregullores 1999/23).

e. Përmes dëmit të shkaktuar gjatë qëndrimit nën administrim të “drejtorisë”.

Liqi në fuqi:

Neni 12.8, i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, për kërkesat pronësore dhe banesore dhe rregullat e procedurës dhe të provave të drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore dhe komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore.

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore A.2 për ligjin në fuqi për pengimin në realizimin e të drejtave pronësore.

Dëshmitë:

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore A.2, pengimi në realizimin e të drejtave pronësore, Dëshmitë.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike **nuk mund** përmes “drejtorisë”. Sipas nenit 12.8, të Rreg. UNMIK-ut

2000/60, "Drejtoria" nuk mbanë përgjegjësi për dëmet apo humbjen e pronës. Mjetet juridike në këtë rast duhet të realizohen nga dëmtuesi, përmes procedurës civile apo penale në fuqi.

f. Përmes dëmit në pronën e palujtshme banesore, konfliktit mbi megjat, pengim posedimit dhe çshtjeve tjera jashtë kompetencës së "Drejtorisë"/"Komisionit".

Ligji në fuqi:

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore A 2, për ligjin në fuqi që ka të bëjë me pengim posedimin dhe okupimin joligjor të pasurisë. Për banesat shoqërore të kësaj kategorie, sigurohuni që e drejta pronësore të jetë fituar pas 13 tetorit 1999, nuk bie qartazi nën nenin 6, të Rreg. UNMIK-ut 2000/60/

Dëshmitë:

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A2, pengimi në realizimin e të drejtave pronësore, dëshmitë.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike - përmes procedurës kontestimore. Lexo nën A.1, pengimi në realizimin e të drejtave pronësore, përshkrimi i mjetit juridik si më lartë.

3. Zbatimi i gjobës dhe kontestet lidhur me pagesën e qirasë të banesave shoqërore.

Ligji në fuqi:

Neni 27, 40, 62,83-4, të ligjit mbi marrëdhëniet banesore (Gazeta Zyrtare KSAK 11/83, 29/86, 42/86).

Pjesë të caktuara të Ligjit mbi marrëdhëniet detyimore (Gazeta Zyrtare RSFJ, No. 29/1978, 39/1985, 45/1989, 31/1993)

Nenet 37, 70-81, ligjit mbi marrëdhëniet bazë pronësore juridike (Gazeta Zyrtare RSFJ, No. 6/80)

Nenet 56, 106, 185, 348, 350-57, 360, 382, 383, 388, ligjit të procedurës kontestimore (Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596)

Neni 26, 29, 31, ligji mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

Neni 27(3): "Gjykata kompetente do të vendosë mbi kontestet të cilat kanë të bëjnë me pagesën e qirasë dhe pagesave tjera të shfrytëzimit hapësirave të përbashkëta të ndërtesës."

Kontestet lidhur me pagesat për shfrytëzimin e përbashkët të pronës.

Neni 147-153, i LPJK-re, dhe gjithashtu lexo nën A.1 për dispozitat në fuqi në lidhje me pengimin e relaizimit të të drejtave pronësore.

Kontestet lidhur me aplikimin e pagesave nga organet komunale.

Neni 35, i Rreg. UNMIK-ut 2000/45, mbi vetqeverisjen e komunave Udhëzimet relevante komunale

Ligji i procedurës së përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ?, nr. 47/86)

Ligji mbi konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 4/77)

Neni 31, Ligjit mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

Dëshmitë:

Dokumentacioni provues se:

Pagesat e qirasë: Neni 27, 40, 62, LMB-re. Gjithashtu lexo A.2, pengimi në realizimin e të drejtave pronësore, Dëshmitë

Lidhur me pagesat për shfrytëzim të përbashkët të pronës: shënimet e nevojshme për caktimin e subjektit (Neni 148, LPJK-re)

Pagesat: Neni 83-4, LMB-re. Standardet e të provuarit të parashikuara në nenet 159-201, të LPPA-ve.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Kontestet lidhur me pagesat e qirasë: Mjetet juridike - përmes procedurës kontestimore. Lexo nën A.1, pengimi në realizimin e të drejtave pronësore, përshkrimi i mjetit juridik si më lartë.

Kontestet lidhur me pagesat për shfrytëzim të përbashkët të pronës: Lexo nën C.5(a), Ekspropriimi – çështjet e kompensimit, përshkrimi i mjetit juridik.

Pagesat komunale: Mjeti juridik – në procedurë administrative që zbatohet për aktin komunal administrativ. Lexo pjesën nën B.2, mos lejimi i qasjes në shënimet kadastrale, përshkrimi i mjetit juridik si më lartë.

H. Prona jo-banesore/afariste

Kjo pjesë përshkruan mjetet juridike që janë specifike për pronën jo-banesore/afariste.

Lexo pjesën nën D për çështjet e ndërtimit, dhe pjesën nën G për mjetet juridike që janë specifike për pronën jo-banesore në pronësi shoqërore.

1. Procedura e kundërligjshme ankandit publik, tenderit.

Liqji në fuqi:

Neni 54, i Ligjit mbi ndërtimin e objekteve investive (Gazeta Zyrtare, KSAK, 5/86)

Neni. 54(6): "...në qoftëse pjesëmarrësi në ankandin publik konsideron se është shkelur procedura ose zgjedhja nuk është bërë sipas kushteve të dhëna në shpalljen për ankandin publik, ka të drejtë kundërshtimi organit të caktuar me aktin e përgjithshëm vetëqeverisës të investimit, i cili ka për detyrë të shqyrtojë kundërshtimin dhe për këtë ta informojë paraqitësin e kundërshtimit".

Dëshmitë:

Sigurimi i dëshmisë se është shkelur procedura e caktuar me LNOI-ve:

- (a) Nuk është organizuar ankandi për t'ia ceduar organizatës përgjegjëse kryerjen e punëve ndërtimore, (neni 65-2), përkundër faktit se nuk janë plotësuar kushtet neni 60.
- (b) Nuk është shpallur si duhet ankandi (neni 54(1), neni 56)
- (c) Nuk është caktuar oferta më e volitshme brenda 30 ditësh nga dita e hapjes së ankandit (neni 58(5)).
- (d) Ndërtimi i objektit nuk i është ndarë ofruesit më të volitshëm (neni 54(2), neni 58(4)) apo ofertës së rregullt (neni 58(1))
- (e) Organizata e zgjedhur për kryerjen e punëve nuk është organizatë e punës së bashkuar e regjistruar për veprimtari të tillë (neni 7(2))
- (f) Kushtet e pjesëmarrjes në ankand janë diskriminuese (neni 54(4), 55)
- (g) Pjesëmarrësit nuk janë njoftuar me kohë për dështimin e tyre (neni 54(5))
- (h) Investuesi nuk i ka sqaruar arsyet e përzgjedhjes para pjesëmarrësve (neni 54(5), 58(5))
- (i) Ankandi nuk është dashur të shpallet i pasuksesshëm nëse disa nga ofertat i kanë plotësuar kushtet (neni 59)
- (j) Pjesëmarrësit nuk janë njoftuar se ankandi nuk ka qenë i suksesshëm brenda 15 ditëve nga dita e hapjes së tij. (neni 59(3))

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike janë të paqarta. Neni 54(6) thekson se investuesi përcakton organin para të cilit duhet kërkuar mjetin juridik. Nuk është gjetur dispozita e cila tregon se cilat janë organet e mundshme.

Mirëpo, duket e arsyeshme që të supozohet se ankesa mund të paraqitet në procedurën kontestimore. Lexo nën A.1, privimi nga e drejta pronësore, përshkrimi i mjetit juridik si më lartë. Nëse ankandi paraqitet nga organi administrativ, atëherë do të zbatohet procedura administrative. Lexo nën B.2, mohimi i qasjes në shënimet kadastrale, përshkrimi i mjetit juridik si më lartë.

2. Mosdhënja e lejës për ndërtim të objektit investiv

Lexo Kreun VI, çështjet pronësore nën F.2 – parimet e përgjithshme

Ligji në fuqi:

Neni 7, 13, 41, 42, 46, 48, Ligjit mbi ndërtimin e objekteve investive (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 5/86)

Gjithashtu lexo pjesën nën D.2, Mosdhënja e lejës për ndërtim të objektit investiv, Ligji në fuqi.

Dëshmitë:

Sigurimi i dokumentacionit provues se:

- a) Vendimi është marrë nga organi kompetent (neni 41)
- b) Të gjitha kushtet janë plotësuar (neni 46 (1), 7(1))
- c) Vendimi nuk është pruar brenda afatit kohor prej 5 ditëve nga diat e paraqitjes së kërkesës (neni 42(1))
- d) Dokumentacioni teknik i kërkuar është nxerrur jashtë vendit por që i përgjigjet dispozitave vendëse, është i përkthyer dhe i kontrolluar (neni 48)
- e) Ndërtimi i objektit investiv është i paraparë me planin zhvillimor afatmesëm (neni 13(1))
- f) Ndërtimi i objektit investiv nuk është i paraparë në planin e sipërpërmendur por është i domosdoshëm për shkak se objekti i tanishëm është shkatërruar (neni 13(2)).

Standardet tjera dëshmuese parashikohen me nenet 159-201, të LPPA-ve.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike – përmes procedurës administrative. Lexo nën B.3, mohimi i qasjes në shënimet kadastrale, përshkrimi i mjeteve juridike si më lartë.

3. Mosdhënja e lejës për shfrytëzim të objektit investiv

Leja e shfrytëzimit është vërtetim se ndërtimi i objektit i plotëson kushtet teknike për përdorim. Është leje e veçantë dhe lëshohet pas dhënjes së lejes për ndërtim.

Ligji në fuqi:

Neni 81, 82, 83, 87, Ligjit mbi ndërtimin e objekteve investive (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 5/86)

Neni 35, i Rreg. UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave

Udhëzimet e caktuara komunale

LPPA-ve (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 47/86)

LKA-ve (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 4/77)

Neni 31, LGjR-ta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

Dëshmitë:

Sigurimi i dokumentacionit provues se:

- a) Janë përmbushur kushtet dhe se kontrolli teknik përfundon se objekti është i përshtatshëm për shfrytëzim (neni 82)
- b) Kontrolli teknik ka filluar pas skadimit të 15 ditëve nga dita e kërkesës (neni 82)
- c) Organi administrativ nuk e ka lëshuar lejën për shfrytëzim brenda 15 ditëve nga pranimi i konkluzioneve mbi kontrollën teknike (neni 83(1));
- d) Janë hequr objektet e përshtatura për punët preliminare dhe përgatitore (neni 83(2)).

Standardet tjera të provave, parashikohen në nenet 159-201, LPPA.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Procedura sipas mjeteve juridike realizohet në procedurën administrative. Por, është e paqartë se cili është tani për tani, organi krahinor administrativ para të cilit duhet të ngritet ankesa. Lexo nën B.3, mohimi i qasjes në shënimet kadastrale, përshkrimi i mjetit juridik si më lartë.

4. Urdhëri për ndërprerjen e ndërtimit/shfrytëzimit dhe rrënimin të objektit investiv.

Liqi në fuqi:

Neni 10, 42, 43, 81, 83, 84, 87, Ligjit mbi ndërtimin e objekteve investive (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 5/86)

Neni 35 and kaptina 12 , e Rreg. UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave LPPA-ve (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 47/86)

LKA-ve (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 4/77)

Neni 31, LGjR-ta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

Dëshmitë:

Dokumentacioni provues se:

- Nuk ekziston rreziku mbi stabilitetin e pamjaftueshëm apo për jetë, shëndet, komunikacion apo objektet fqinje (neni 81);
- Investuesi i ka larguar objektet e përshatura për punëst preliminarë dhe përgatitore neni 83(2);
- Investuesi i ka plotësuar kushtet e caktuara në lejen e objektit dhe në dispozitat tjera (neni 83(2)); si dhe kushtet tjera të përcaktuara në nenet 10, 42, 43, 87.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjeti juridik realizohet përmes ankesës administrative. Por, është e paqartë se cili është tani për tani, organi krahinor administrativ para të cilit duhet të ngritet ankesa. Lexo nën B.2, mohimi i qasjes në shënimet kadastrale, përshkrimi i mjetit juridik si më lartë.

Ju lutemi për vëmendje: Neni 84 i Ligjit mbi ndërtimin e objekteve investive e udhëzon paraqitësin e ankesës që ta ngritë ankesën pranë organit qendror të administratës krahinore kompetente për çështjet e ndërtimit. Mirëpo, nëse urdhëri është lëshuar nga organi komunal, atëherë, neni 35 i Rreg. UNMIK-ut 2000/45 shfuqizon çdo dispozitë të secilit ligj e cila është në kundërshtim me të (kaptina 12, e Rreg. UNMIK-ut 2000/45). Prandaj nëse urdhëri është nxjerrë në instancën komunale, duhet të respektohet procedura ankimore në procedurë administrative para organit komunal dhe jo neni 84. Mbetet e paqartë se cili është organi qendror administrativ i krahinës, apo organi i instancës më të lartë.

5. Zbatimi i gabueshëm i gjobës(pagesave???)

Liqi në fuqi:

Neni 88-99, Ligjit mbi ndërtimin e objekteve investive (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 5/86)

Neni 35 and kaptina 12 , e Rreg. UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave LPPA-ve (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 47/86)

LKA-ve (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr. 4/77)

Neni 31, LGjR-ta (Gazeta Zyrtare KSAK, nr. 21/78)

Dëshmitë:

Dokumentacioni provues se baza mbi caktimin e pagesave nuk ekziston (lexo nenet 88-99 Standardet tjera të provave, parashikohen në nenet 159-201, LPPA.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjeti juridik realizohet në procedurën administrative pranë organit komunal apo sipas aktit tjetër administrativ. Lexo pjesën nën B.2, mohimi i qasjes në shënimet kadastrale, përshkrimi i mjetit juridik si më lartë.

**I. Prona jo-banesore.
Pronë e cila kontrollohet nga ndërmarrjet publike apo shoqërore**

Kjo pjesë përshkruan mjetet juridike që janë specifike për pronën jo-banesore e cila bie nën kompetencë të Rreg. UNMIK-ut 2002/12 and

2002/13. Ju lutemi t'i referoheni pjesëve të sipërme për çështjet tjera siç janë: lejet etj.

1. Vendimi i Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit i cili ndikon në të drejtat pronësore apo të drejtat tjera.

Kufizim:

Sipas nenit 10.5, i Rreg. UNMIK-ut 2002/13, nuk lejohet mjete juridik pranë Dhomës së veçantë për anulimin e transakcionit apo prishjen e kontratës (përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore) dhe që hyn në kuadër të Rreg. UNMIK-ut 2002/12.

Liqi në fuqi:

Neni 9.3, 18, 24.2-3, 30, i Rreg. UNMIK-ut 2002/12, mbi themelimin e Agjencisë së Mirëbesimit të Kosovës (AMK)

Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13, mbi themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me AMK-në.

Titulli IV i Urdhërit Administrativ të UNMIK-ut 2002/13 për zbatimin e Rregullores 2002/13 për themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me AMK-në.

Dëshmitë:

Gjatë aplikimit para PSSP-së, duhet siguruar dëshmi se vendimi apo veprimi nuk janë në pajtim me Rezolutën e KB-ve 1244 (1999), Rreg. UNMIK-ut 2002/12, ose udhëzimeve dhe rregulloreve përkatëse, ligjit në fuqi në Kosovë, apo politikat dhe procedurat e AMK-së, (neni 24.3, i Rreg. UNMIK-ut 2002/12).

Me rastin e aplikimit para Dhomës së Veçantë, rregullat dhe procedurat specifike sipas nenit 7, të Rreg. UNMIK-ut 2002/13, përcaktojnë kërkesat e të provuarit (neni 8, i Rreg. UNMIK-ut 2002/13). Shënim: rregullat e procedurës ende nuk kanë hyrë në fuqi.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Dy mjete juridike janë vënë në dispozicion:

(1) PSSP mund të shfuqizojë ose modifikojë çfarëdo vendimi të Bordit ose të menaxhmentit nëse konsideron se vendimi i tillë nuk është në pajtim me nenin 24.2 dhe.

(2) Padia gjyqësore para Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që ndërlidhen me AMK-ës (neni 30, i Rreg. UNMIK-ut 2002/12; neni 4, i Rreg. UNMIK-ut 2002/13).

- Kërkuesi i pagesës mund të bëjë kërkesë për kundërshtimin e një vendimi ose një veprimi të Agjencisë brenda nëntë (9) ditësh dhe më së voni nga: (a) data kur një kërkues i tillë ka ditur ose pas përpjekjeve të arsyeshme është dashur të dijë për vendimin a veprimin e Agjencisë dhe (b) data kur Dhoma e veçantë njofton publikisht se është në gjendje t'i pranojë kërkesat. (neni 6.1, i Rreg. UNMIK-ut 2002/13). Mirëpo, dhoma e veçantë nuk mund të pranojë kërkesat përveç nëse paraqitësi i kërkesës nuk jepë prova së paku 60 ditë para njoftimit të kryesuesit të bordit të AKMsë për qëllimin e ngritjes së kërkesës (neni 30.2, i Rreg. UNMIK-ut 2002/12 dhe neni 6.2-3, i Rreg. UNMIK-ut 2002/13).
- Vendimi merret brenda dy muajsh nga përfundimi i procedurës, lëshohet me shkrim, dhe palëve iu komunikohet brenda 30 ditëve nga dita e miratimit (neni 9, i Rreg. UNMIK-ut 2002/13).
- Vendimi i Dhomës së Veçantë është i plotëfuqishëm dhe obligativ (neni 9/7, i Rreg. UNMIK-ut 2002/13). Nuk lejohet ankesa.
- Nëse Dhoma e Veçantë i bartë kërkesat ose pjesë të kërkesave tek gjykatat tjera sipas nenit 4.2, të Rreg. UNMIK-ut 2002/13, atëherë vendimi i marrë sipas ankesës mund prap të atakohet me ankesë vetëm para Dhomës së Veçantë, përveç nëse Dhoma e Veçantë cakton ndryshe (neni 4.3, i Rreg. UNMIK-ut 2002/13).
- Ankimi depozitohet në Dhomën e Posaçme brenda dy muajve prej datës kur u dorëzohet palëve vendimi. Njoftimi me shkrim për ankimin i dorëzohet gjykatës kundër vendimit të së cilës është bërë ankimi dhe palëve që marrin pjesë në procedim kundër vendimit të së cilës bëhet ankimi.
- Dhoma e Posaçme: (a) Mund të lërë në fuqi ose mund ta anulojë tërësisht a pjesërisht vendimin e gjykatës kundër vendimit të së cilës bëhet ankimi; (b) Mund ta ndryshojë ndonjë urdhër të gjykatës kundër vendimit të së cilës bëhet ankimi; ose (c) Mund të urdhërojë rigjykimin e çështjes, tërësisht ose pjesërisht, në gjykatën e njëjtë, në ndonjë gjykatë tjetër në Kosovë ose në Dhomën e Posaçme neni 62 I UA 2003/13.
-

Ju lutemi të keni parasyshtë: Kundërpaditë mund të ngriten nga AMK-ja brenda afateve të caktuara me ligjin në fuqi ("ligjin në fuqi" i referohet rregullave të procedurës të cilat ende nuk kanë hyrë në fuqi). Neni 30/2, i Rreg. UNMIK-ut 2002/12 nuk zbatohet. (neni 6.3, i Rreg. UNMIK-ut 2002/13).

a) Largimi nga lista i punëtorëve që kanë të drejtë në pjesë të të ardhurave që fitohen nga privatizimi (shitja)

Liçji në fuqi:

Neni 10 i Rregullores 2003/13, PËR TRANSFORMIMIN E SË DREJTËS PËR PËRDORIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME SHOQËRORE

Titulli V i Urdhërit Administrativ të UNMIK-ut 2002/13 për zbatimin e Rregullores 2002/13 për themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me AMK-në

Dëshmitë:

Kushtet e të provuarit sipas neneve 19, 20, 22.1-22.6, 23, 32, 33, dhe 45-48, të UA të UNMIK-ut nr 2003/13 (lexo nenin 64.1 të UA 2003/13. Krahas kësaj, nëse me kërkesë dyshohet në diskriminim se është arsye e përjashtimit, dokumentacioni provues duhet t'i bashkangjitet kërkesës (neni 10.6 (b), i Rregullores 2003/13).

Përshkrimi i mjetit juridik:

Ankesa e personit mund të ngritet pranë dhomës së veçantë të Gjykatës Supreme brenda 20 ditëve ps publikimit në media të listës së punëtorëve legjitim. Dhoma e veçantë duhet të merr vendim brenda 40 ditëve nga data e dorëzimit të ankesës në zyren e regjistrimit (neni 10.6 (a), të Rreg. 2003/13 dhe nenit 64 të UA-ve të UNMIK-ut nr. 2003/13.

Shënim: i gjithë fitimi për punëtor ndahet brenda 60 ditëve nga publikimi i fundit i listës së punëtorëve legjitim (neni 10.6(c) i UA, 2003/13.

2. Privimi I padrejtë apo ndërhyrja në realizimin e të drejtave pronësore dhe të drejtave tjera nga ndonjë ndërmarrje e cila gjendet nën autoritetin e AKM-së, mirëpo jo nëpërmjet të vendimit apo veprimit të AKM-së.

Sipas Rreg. UNMIK-ut 2002/12, AMK-ja ka kompetencë administrative ndaj të gjitha ndërmarrjeve publike dhe shoqërore në Kosovës, por përgjegjësia e AMK-së dhe këtyre ndërmarrjeve mbetet e ndarë (neni 18, i Rreg. UNMIK-ut 2002/12). Por, AMK, në çdo kohë mund të paraqet njoftim me shkrim para gjykatës kompetente për të vepruar si përfaqësues ligjor për ndërmarrjen në fjalë (neni 29.3).

Liçji në fuqi:

Neni 7.3, 18.2, 28, 29, 30, i Rreg. UNMIK-ut 2002/12, mbi themelimin e Agjencisë së Mirëbesimit të Kosovës (AMK)

Titulli II i Urdhërit Administrativ të UNMIK-ut 2002/13 për zbatimin e Rregullores 2002/13 për themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me AMK-në

Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13, mbi themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me AMK-në

Dëshmitë:

Me rastin e paraqitjes para gjykatës kompetente, tjetër nga ajo e Dhomës së Veçantë, zbatohet procedura e provave në zbatim për atë gjykatë. Lexo A.2, Pengimi në të drejtat pronësore, dëshmitë.

Me rastin e aplikimit para Dhomës së Veçantë, rregullat dhe procedurat specifike sipas nenit 7, të Rreg. UNMIK-ut 2002/13, përcaktojnë kërkesat e të provuarit (neni 8, i Rreg. UNMIK-ut 2002/13). Shënim: rregullat e procedurës ende nuk kanë hyrë në fuqi.

Përshkrimi i mjetit juridik:

- a. Paraqitja e njoftimit me shkrim mbi qëllimin e ngritjes së padisë para AMK, duke theksuar emrin e paraqitësit, emrin e ndërmarrjes apo korporatës, bazat e ankesës dhe ndihma e kërkuar. Asnjë procedurë ligjore nuk mund të fillojë pa ofrimin e provave se kjo është kryer më parë (neni 29.1, i Rreg. UNMIK-ut 2002/12).
- b. Mjeti juridik mund të realizohet para gjykatës civile (procedurë kontestimore). Lexo E.1 (a), privimi i të drejtave pronësore, përshkrimi i mjetit juridik.
- c. Sipas nenit 4.5, të Rreg. UNMIK-ut 2002/13, AMK-ja mundet në çdo kohë, fillimit të administrimit të ndërmarrjes apo korporatës, të kërkojë nga Dhoma e Veçantë të tërheqë çdo padi të pazgjidhur në ndonjë gjykatë në Kosovës dhe vet ta gjykojë. Nëse AMK-ja e ndërmerr këtë veprim, ju lutemi të i referoheni pjesës në G.1, Vendimet e AMK-së, përshkrimi i mjetit juridik në procedurën para Dhomës së Veçantë.

3. Zbatimi i padrejtë i gjobave nga AKM-ja mbi ndërmarrjet, punëtorët e saj dhe personat tjerë me funksione menaxhese dhe mbikëqyrëse

Ligji në fuqi:

Neni 27, Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12, mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit

Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13, mbi themelimin e Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme mbi çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit
Urdhëri Administrativ i UNMIK-ut 2002/13 për zbatimin e Rregullores 2002/13 për themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me AMK-në

Dëshmitë

Nuk paralexoet ndonjë kërkesë mbi dëshmitë. Lexo nenin 27.1, Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 përcakton arsyetimet që duhet dhënë në lidhje me shumën e gjobës së shqiptuar.

Kur parashtrohet kërkesë pranë Odës së Veçantë, ekzistojnë rregulla të posaçme të lëshuara në bazë të nenit 7, Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13, të cilat parashohin kërkesat mbi dëshmitë (Neni 8, Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13). Vëreni se rregullat e procedurës nuk janë nxjerrë ende.

Përshkrimi i mjetit juridik:

- a. Tridhjetë (30) ditë pas dorëzimit të gjobës, pranuesi mund të bëjë ankesë me shkrim kryesuesit të Bordit të AKM-së (neni 27.2, Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12)
- b. Nëse AKM-ja vërteton gjobën, atëherë ankesa mund t'i parashtrahet Odës së Veçantë. Lexo G.1, Vendimi apo veprimi i padrejtë i AKM-së, Përshkrimi I mjeteve juridike për procedurën e nisur pranë Odës së Veçantë.

J. Pyjet

Kjo pjesë bën fjalë për mjetet juridike në dispozicion për shkeljet e mundshme të rënda.

1. Privimi i padrejtë apo pengimi padrejtë në realizimin e të drejtave pronësore nëpërmjet të caktimit të kufijve ndërmjet pyjeve.

Ligji mbi Pyjet, (Gazeta Zyrtare e KSAK-ut Nr. 10/87). Organi i posaçëm i caktuar nga komuna për caktimin e kufijve ndërmjet pyjeve (Neni 70) merr vendim me të cilin shkelen të drejtat pronësore.

Ligji në fuqi:

Neni 4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/6, për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për pyjet e Kosovës

Ligji i procedurës administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, 47/86)

Nenet 37, 70-81, Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësores-Juridike (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 6/80)

Nenet 52, 56, 106, 185, 348, 350-57, 360, 382, 383, 388, Ligji i Procedurës Civile (Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596),

Neni 29, 31, Ligji mbi Gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78)

(Neni 161, Ligji mbi Procedurën jokontestimore nuk duket se zbatohet në këtë drejtim)

Dëshmitë

Standardet e të provuarit, të parapara me nenet 159-201 të LPPA. Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A.1, pengimi i të drejtave pronësore, dëshmitë për mjetet juridike përmes procedurës kontestimore.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Në rast të një kontesti mbi atë se një pronë përfshinë apo nuk përfshinë pyje dhe toka pyjore;

(a) Organi administrativ komunal që merret me çështjet e pronësisë mund të vendosë mbi shtrirjen e kufijëve të pyjeve dhe tokave pyjore përbrenda komunave. Organi duhet ta lëshojë vendimin brenda një muaji (neni 218 i LPPA)

(b) Pala e dëmtuar mund të kërkojë nga Gjykata Komunale të rishqyrtojë një vendim të tillë (neni 4.2 i Rregullores 2003/6). Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A.1, pengimi i të drejtave pronësore, përshkrimi i mjetit juridik si më lart.

a) përmes refuzimit ose shfrytëzimit të padrejtë

Ligji në fuqi:

Neni 6 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/6, për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i

të servituteve ose shfrytëzimit të përkohshëm të tokës afër pyjeve.

Kjo pjesë ka të bëjë me shfrytëzimin e përkohshëm të tokës që është e ngjitur me pyjet, për deponim ose transport të materialeve të produkteve pyjore.

Kosovës për pyjet e Kosovës

Neni 35 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave Ligji i procedurës administrative (Gazeta Zyrtare RSFJ, 47/86)

Nenet 37, 70-81, Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësoro-Juridike (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 6/80)

Nenet 52, 56, 106, 185, 348, 350-57, 360, 382, 383, 388, Ligji i Procedurës Civile (Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596),

Nenet 29, 31, Ligji mbi Gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78)

(Neni 161, Ligji mbi Procedurën jokontestimore nuk duket se zbatohet në këtë drejtim)

Dëshmitë

Standardet e të provuarit, të parapara me nenet 159-201 të LPPA. Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A.1, pengimi i të drejtave pronësore, dëshmitë për mjetet juridike përmes procedurës kontestimore.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike realizohen përmes proceursë administrative dhe në kur është fjala te kompensimi atëherë përmes procedurës kontestimore.

a. Organi administrativ komunal që merret me çështjet pronësore mund të zgjedhë kontestet në lidhje me servitudet sipas këtij neni (neni 6.3 i Rregullores 2003/6). Nuk është paraparë afati për ankesë. Organi duhet ta lëshojë vendimin brenda një muaji (neni 218 i LPPA).

b. Vendimi i organit komunal mund të kundërshtohet me ankesë në procedurë administrative sipas Rregullores 2000/45 (neni 6.4 i Rregullores 2003/6). Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, C.3, ekspropriimi, përshkrimi i mjetit juridik si më lart.

c. Ankesa kundër vendimit për vlerën e kompensimit duhet të paraqitet brenda një muaji pas marrjes së vendimit nga gjykata komunale me të cilin caktohet toka nën servitut.). Lexo Kreun VI, çështjet pronësore, A.1, pengimi i të drejtave pronësore, përshkrimi i mjetit juridik si më lart.

2. Vendimi i padrejtë i inspektorit të pyjeve e cila pengon realizimin e të drejtave pronësore

Ligji në fuqi:

Rregullorja e UNMIK-ut 2003/6, për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për pyjet e Kosovës

Ligji mbi Procedurën Administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 47/86)

Ligji mbi Konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 4/77)

Neni 31, Ligji mbi Gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78)

Dëshmitë

Dokumentet e rëndësishme për kërkesën. Standardet mbi dëshmitë të parapara me nenin 232, Ligji mbi Procedurën Administrative.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjetet juridike sigurohen nëpërmjet të procedurave administrative në këtë rast. Sidoqoftë, është e paqartë se cili organ duhet t'i paraqitet ankesa. Sipas neni 102, "Organi krahinor i administratës kompetente për punët e pylltarisë kujdeset mbi organizimin, përparimin dhe kryerjen e drejtë të inspektimit pyjor në territorin e Krahinës, duke bërë me dije se shërbimi i inspektimit pyjor bie nën pushtetin qendror. Ankesa duhet t'i paraqitet organit administrativ krahinor.

- a. Kundërshtimi duhet të paraqitet pranë organit të shkallës së parë (është e paqartë se cili është ky organ për momentin) brenda 15 ditëve nga dita kur është dorëzuar aktvendimi. Organi i shkallës së parë mund të pranojë ankesën dhe t'ja përcjell organit të shkallës së dytë, ta ndryshojë aktvendimin në bazë të ankesës së paraqitur, apo ta refuzojë ankesën (Nenet 234-6, Ligji mbi Procedurën Administrative). Aktvendimi mbi ankesën duhet të merret brenda (2) muajve (Neni 247, Ligji mbi Procedurën Administrative). Vendimi është i plotëfuqishëm.
- b. If the Parashtruesi i kërkesës dnuk pajtohet me vendimin mbi ankesën, atëherë ai mund të paraqes ankesë pranë Gjykatës Supreme. (Neni 31, Ligji mbi Gjykatat e rregullta). Afati për iniciimin e padisë administrative është 30 ditë nga dita e dorëzimit të aktit administrativ apo 60 ditë nga dita e dorëzimit të tij nëse pala nuk e ka pranuar atë (Neni 23, Ligji mbi Konfliktet administrative).
- c. Një ankesë apo kërkesë shtesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm të aktvendimit mund të paraqitet me padi administrative (Neni 19-20, 45-50, Ligji mbi Konfliktet administrative) ose duhet t'i paraqitet gjykatës kompetente brenda 30 ditëve nga dita

e dorëzimit të aktvendimit të kundërshtuar (Neni 46, Ligji mbi Konfliktet administrative)

Në bazë të Nenit 70-1, të Ligji mbi Pyjet, procedura duhet të inicohet brenda 30 ditësh nga dita kur afati për shqyrtim publik ka skaduar.

3. Pengimi i të drejtës për shfrytëzim të resurseve pyjore

Kjo është një dispozitë e përgjithshme e cila mundëson shqyrtimin juridik të ndërhyrjeve në shfrytëzimin e resurseve pyjore për shkak të mosveprimit të autoriteve përgjegjëse sipas mandatit të dhënë nga Rregullorja 2003/6

K. Tatimi në pronë

Kjo pjesë jepë një pasqyre të mjeteve juridike në lidhje me tatimin në pronë të përcaktuar me Rregulloren 2003/29

1. Vlerësimi i padrejtë i pronës ose fatura e gabuar për pagesën e tatimit

Ligji në fuqi:

Neni 28.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/6, për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për pyjet e Kosovës
Ligji i procedurës konestimore (Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596),
Nenet 29, 31, të Ligji mbi Gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78)

Dëshmitë:

Dokumentet e rëndësishme për kërkesën. Standardet mbi dëshmitë të parapara me nenin 232, Ligji mbi Procedurën Administrative.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Kërkesa i bëhet gjykatës (nuk është saktësuar shkalla) për lëshimin e urdhërit që kërkon nga organet përgjegjëse qeveritare që t'i përmbushin detyrat e veta.

Ligji në fuqi:

Neni 21, i Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë
Ligji mbi Procedurën Administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 47/86)
Ligji mbi Konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 4/77)
Ligji i procedurës konestimore (Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596),
Nenet 29, 31, të Ligji mbi Gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78)

Dëshmitë:

Standardet mbi dëshmitë të parapara me nenin 232, Ligji mbi Procedurën Administrative dhe nenin 106(3) të procedurës kontestimore.

Përshkrimi i mjetit juridik:

- a. Kërkesa me shkrim i bëhet bordit komunal për ankesat për ta shqyrtuar brenda 30 ditësh nga pranimi i faturës së tatimit. Bordi komunal e njofton tatimpaguesin brenda 60 ditësh nga pranimi i kërkesës. Deri në marrjen e vendimit komuna nuk i zbaton rregullat e vjeljes së dhunshme të tatimeve (neni 21 i Rregullores 2003/29).
- b. Nëse tatimpaguesi është i paknaqur me vendimin, atëherë ai mund të ankohet pranë Gjykatës Supreme (neni 21.7 i Rregullores 2003/29 dhe neni 31, i Ligjit për Gjykatat e Rregullta). Afati për kofliktin administrativ është 30 ditë nga dorëzimi i vendimit palës, dhe 60 ditë nga dita e dërgimit të aktvendimit dhe pala nuk e ka pranuar këtë të fundit (neni 23-24, LKA)
- c. Gjithashtu, mund të kërkohet rishqyrtimi i jashtëzakonshëm i vendimit gjyqësor, kundër aktvendimit mbi konfliktin administrativ (neni 19-20, 45-50, LKA). Në çdo rast, i dërgohet gjykatës kompetente brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të aktvendimit të kontestuar (neni 46 i LKA).

2. Aplikimi i padrejtë i pengmarrjes për tatim

Ligji në fuqi:

Neni 10, 16 dhe 21 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë
Neni 35 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave
Ligji mbi Procedurën Administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 47/86)
Ligji mbi Konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 4/77)
Neni 31, Ligji mbi Gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78)
Ligji i procedurës konestimore (Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596),

Dëshmitë:

Standardet mbi dëshmitë të parapara me nenin 232, Ligji mbi Procedurën Administrative dhe nenin 106(3) të procedurës kontestimore.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjeti juridik realizohet përmes ankesës së paraqitur në "komunë" (neni 16.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/29) në procedurë administrative. Mirëpo është e paqartë nëse si organ komunal do të ishte bordi komunal për ankesa për shkak se mandati i tij është i kufizuar me ligj, gjegjësisht të shqyrtojë faturën e tatimit dhe jo të caktojë denime siç është rasti me pengmarrjen (neni 10.2 dhe 21.1 i Rregullores 2003/29). Si alternativë mund të zbatohet procedura administrative siç nënvizohet në Kreun VI, çështjet pronësore, C.3, (b), ekspropriimi – pengimi i të drejtave pronësore bazuar në "vendimin e padrejtë" për lejimin e punëve përgatitore, përshkrimi i mjetit juridik. Deri më tani autoritetet e dhura nuk e kanë mundësuar këtë.

3. aplikimi i padrejtë i denimeve ose gjobave, tjera nga servituti dhe pengju.

Sanksionet dhe denimet të cilat i shqipton komuna kur vonohet pagesa e tatimit janë, konfiskimi i pasurisë, marrja e të drejtës për ankesë kundër faturës tatimore dhe gjobat dhe kamatat. Këto i zbaton Drejtoria e Financave dhe Ekonomisë (nenet 17-20 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/29).

Ligji në fuqi:

Neni 10, i Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë

Neni 35 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave

Ligji mbi Procedurën Administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 47/86)

Ligji mbi Konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 4/77)

Neni 31, Ligji mbi Gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78)

Ligji i procedurës kontestimore (Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596),

Dëshmitë:

Standardet mbi dëshmitë të parapara me nenin 232, Ligji mbi Procedurën Administrative dhe nenin 106(3) të procedurës kontestimore.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjeti juridik është i paqartë. Komuna është përgjegjëse për ankesat administrative ndaj vendimeve sikurse është janë këto (neni 10 i Rregullores së UNMIK-ut). është e paqartë nëse si organ komunal do të ishte bordi komunal për ankesa për shkak se mandati i tij është i kufizuar me ligj, gjegjësisht të shqyrtojë faturën e tatimit dhe jo të caktojë denime siç është rasti me pengmarrjen (neni 10.2 dhe 21.1 i Rregullores 2003/29). Si alternativë mund të zbatohet procedura administrative siç nënvizohet në Kreun VI, çështjet pronësore, C.3, (b), ekspropriimi.

4. Zbatimi i gabueshëm i konfiskimit të pronës personale

Këtë e zbatojnë inspektorët komunal atëherë kur tatimpaguesi nuk e ka paguar tatimin edhe pas njoftimit të fundit (neni 17 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë.

Ligji në fuqi:

Neni 10, 17 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë

Neni 4.1 dhe 7, i Rregullores së UNMIK-ut 2000/20, për procedurat dhe administratën tatimore

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave

Ligji mbi Procedurën Administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 47/86)

Ligji mbi Konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 4/77)

Neni 31, Ligji mbi Gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78)

Ligji i procedurës kontestimore (Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596),

Dëshmitë:

Standardet mbi dëshmitë të parapara me nenin 232, Ligji mbi Procedurën Administrative dhe nenin 106(3) të procedurës kontestimore.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjeti juridik është i paqartë. Komuna është përgjegjëse për ankesat administrative ndaj vendimeve sikurse është janë këto (neni 10 i Rregullores së UNMIK-ut). është e paqartë nëse si organ komunal do të ishte bordi komunal për ankesa për shkak se mandati i tij është i kufizuar me ligj, gjegjësisht të shqyrtojë faturën e tatimit dhe jo të caktojë denime siç është rasti me pengmarrjen (neni 10.2 dhe 21.1 i Rregullores 2003/29). Nëse jo, atëherë procedura administrative për ankesë duhet të zbatohet sikur në Kreun VI, çështjet pronësore, C3 (b) ekspropriimi – pengimi i të drejtave pronësore të bazuar në vendimin e

padrejtë për lejin e punëve përgatitore, përshkrimi i mjetit juridik. Rregullat dhe procedurat e nënvizuara me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/20 e komplikojnë edhe më tej çështjen kur është fjala te zbatimi i tarifave (neni 17.5 Rregullorja 2003/29) dhe është e paqartë nëse mekanizmat për ankim sipas Rregullores 2000/20 a bijnë nën nenin 7 ose ende duhet të shpallet në fuqi Urdhëresa Administrative për caktimin e taksave (tarifave). Deri më tani autoritetet përkatëse nuk janë sqaruar për këtë çështje.

6. Refuzimi për shtyerjen e pagimit të tatimit mbi pronën

Shtyerja e pagesës së tatimit lejohet atëherë kur kjo pagesë do të shkaktonte vështirësi të tepruara për tatimpaguesin (neni 15, i Rregullores së UNMIK-ut 2003/29

Ligji në fuqi:

Neni 10, 15 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45, mbi vetëqeverisjen e komunave

Ligji mbi Procedurën Administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 47/86)

Ligji mbi Konfliktet administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 4/77)

Neni 29 - 31, Ligji mbi Gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78)

Ligji i procedurës konestimore (Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596),

Dëshmitë:

Sigurimi provave për vështirësi të tepruara dhe që i përbushë kriteret procedurale të parapara me udhëzimet relevante administrative (neni 15, i Rregullores së UNMIK-ut 2003/29). Standardet mbi dëshmitë të parapara me nenin 232, Ligji mbi Procedurën Administrative dhe nenin 106(3) të procedurës kontestimore.

Përshkrimi i mjetit juridik:

Mjeti juridik është i paqartë. Komuna është përgjegjëse për ankesat administrative ndaj vendimeve sikurse është janë këto (neni 10 i Rregullores së UNMIK-ut). është e paqartë nëse si organ komunal do të ishte bordi komunal për ankesa për shkak se mandati i tij është i kufizuar me ligj, gjegjësisht të shqyrtojë faturën e tatimit dhe jo të caktojë denime siç është rasti me pengmarrjen (neni 10.2 dhe 21.1 i Rregullores 2003/29). Krahas kësaj, udhëzimet administrative që i përcaktojnë rregullat e shtyerjes së pagesave të taksave ende nuk janë nxjerrë ashtu siç kërkohet nga neni 17.1 të Rregullres së UNMIK-ut 2003/29 dhe nuk është e qartë nëse do të caktohet ndonjë procedurë tjetër e ankesës.

Në përgjithësi, procedura administrative për ankesë duhet të zbatohet sikur në Kreun VI, çështjet pronësore, C3 (b) ekspropriimi – pengimi i të drejtave pronësore të bazuar në vendimin e padrejtë për lejin e punëve përgatitore, përshkrimi i mjetit juridik. Deri më tani autoritetet përkatëse nuk janë sqaruar për këtë çështje